

**INFORMATA PËR
MIGRANTËT
DHE MIGRANTET
MBI SHKOLLIMIN
NË ZVICËR**

**ÇKA PAS
SHKOLLËS?**

Fletëpalosje për tema të rëndësishme arsimore



FLETËPALOSJA NË INTERNET

Shënimi në kutinë e mësipërme në këtë doracak do të thotë se ju mund të gjeni **informata shtesë për një temë në gjuhën tuaj në internet.**

Në portalin zviceran për këshillime profesionale, të ofruar nga kantonet, ju mund të gjeni fletëpalosje në gjuhën shqipe për çështjet e rëndësishme të arsimimit në Zvicër. Aty mund të gjeni po ashtu edhe një mori të informatave si dhe bazat e të dhënave për profesionet, për arsimimin dhe ngritjen e mëtejme në tri gjuhët kombëtare gjermane, frenge dhe italiane:

Gjermanisht: www.berufsberatung.ch/sq

Frenjisht: www.orientation.ch/sq

Italisht: www.orientamento.ch/sq

Ju mund t'i gjeni aty fletëpalosjet dhe vjeggëzat për temat në vijim:

- Kalimi prej nivelit fillor në nivelin sekondar I
- Sistemi dual i arsimit dhe depërtueshmëria
- Nga shkolla në profesion
- Çka është zanati? 3 vende mësimi
- Praktika provuese
- Testet e aftësisë
- Të kërkosh një vend për mësim të profesionit (zanatit)
- Intervistë e prezantimit
- Sjellja me refuzimet
- Kontrata për mësimin e profesionit
- Parazanati
- Kërkoj punë apo dua të ushtroj një profesion?
- Rrugët e arsimimit shkollor
- Financimi i arsimit dhe i ngritjeve të mëtejme
- Njohja e diplomave të huaja
- Ngritja e mëtejme dhe gjuha

Oferta të tjera të rëndësishme

Një doracakt me titullin «Mirësevini në Zvicër» ju ofron informata të rëndësishme në gjuhën tuaj për çështjet e vlerave themelore, të drejtat dhe detyrimet, ligjet si dhe ushtrat praktike të jetës dhe të punës në Zvicër:

www.sem.admin.ch › Publikationen › Willkommen in der Schweiz

Informata të shumta, kontakte dhe adresa në gjuhë të ndryshme i gjeni edhe në Migraweb, një projekt për vetëndihmë nga migrantet dhe migrantët për migrantet dhe migrantët: www.migraweb.ch

Informata të tjera në gjuhë të ndryshme ofrojnë edhe webfaqet e këshillimoreve për profesione dhe të Drejtorisë për Ngritje dhe Edukim (gjegjësisht të Entit për Shkollat e Mesme dhe Edukimin Profesional) të kantonit tuaj.

Çfarë duhet të dini në lidhje me këtë doracak

Mirëdita!

**Ju jeni një i huaj ose e huaj në Zvicër?
Atëherë sigurisht do t'ju interesojë ky doracak.
Sepse ka të bëjë me shkollimin dhe punën tuaj.
Ose me shkollimin e fëmijëve tuaj.**

Sistemi i arsimit në Zvicër është kompleks sikurse të gjitha sistemet e arsimit, dhe me gjasë ndryshon në masë të madhe nga sistemi i arsimit në vendin tuaj të origjinës. Përveç kësaj, shkolla dhe arsimi në Zvicër, në shumë gjëra, janë të organizuara në baza kantonale ose (gjuhësore) rajonale: Varësisht nëse jetoni në rajonin gjermanofolës, atë frankofon ose në atë itianofolës të Zvicrës, hasni në kushte të ndryshme; dhe mundësitë që ju kenë në Cyrih mund të jenë ndryshe nga ato në Bernë, ato në Lozanë ndryshe nga ato në Neuchatel. Për dallim, sistemi arsimimit profesional është gati i njësuar në tërë Zvicrën dhe funksionon sipas motos: Nuk ka përfundim pa përfshirje. Kjodo të thotë se nuk varet vetëm nga ajo se çfarë diplome kenë arritur, por edhe cili do të jetë arsimimi i mëtejshëm që ju mund të ndiqni pas diplomimit. Prandaj është erëndësishme që ju të njiheni me kushtet dhe me mundësitë në ambientin tuaj. Ky doracak do t'ju mbështetë gjatë këtij procesi.

Ju jeni prindër që kenë fëmijë në shkollë fillore? Ju dëshironi të dini se si funksionon kalimi nga niveli primar në nivelin sekondar I në Zvicër?
Atëherë, përgjigjet i gjeni në kapitullin 1 prej faqes 10.

Ju jeni në fund të shkollimit tuaj të detyrueshëm në nivelin sekondar I dhe kështu para një kalimi në arsimimin bazë profesional (mësim i zanatit)? Ose fëmija juaj është në prag të ndërmarrjes së këtij hapi?
Kapitulli 2 prej faqes 20 tregon se cilat rrugë dhe mundësi të arsimimit ekzistojnë në nivelin sekondar II.

Ju jeni në fund të shkollimit tuaj të detyrueshëm në nivelin sekondar I dhe kështu jeni përpara një kalimi në një shkollë të arsimimit të përgjithshëm (gjimnaz ose shkollë të mesme të specializuara)?
Kapitulli 3 prej faqes 38 tregon se çfarë kërkohet për një karrierë shkollore të arsimimit në Zvicër dhe çfarë alternativa ekzistojnë për ta bërë këtë.

Ju jeni në prag të kalimit në arsimimin bazë profesional/mësim të profesionit (zanatit) dhe duhet të dini se si të zgjidhni një profesion si dhe, si të kërkoni dhe të gjeni një vend për mësim të profesionit (zanatit)?
Kapitulli 4 prej faqes 48 ju tregon si të përgatiteni për të ndërmarrë këtë hap dhe si mund të përmirësoni shanset tuaja nëpërmjet ofertave ndërlihdhëse (kalimtare).

Ju dëshironi të dini se cilat mundësi zhvillimi të mëtutjeshme ekzistojnë pas përfundimit të arsimit bazë profesional / mësim të profesionit me ose pa maturë profesionale?

Në kapitullin 5 prej faqes 72 i gjeni informatat mbi ngritjet e mëtejme dhe mundësitë për karrierë.

Ju jeni duke ndjekur një shkollë të mesme të specializuar, një gjimnaz, një arsimim bazë profesional me maturë profesionale, ose jeni në një situatë, ku jeni duke planifikuar për të studiuar në ndonjë shkollë të lartë profesionale, shkollë të lartë universitare ose universitet?


Kapitulli 6 prej faqes 94 ofron informata se si mund të organizoni kalimin nga niveli i II sekondar (shkollat e arsimit të përgjithshëm, arsimimi bazë profesional) në nivelin terciar (shkolla të larta profesionale, shkolla të larta universitare, universitete) dhe çfarë drejtime studimore dhe diploma ofrojnë shkollat e larta në Zvicër.

Ju punoni në Zvicër, por kurrë nuk e keni bërë një diplomë? Ju dëshironi t'i përmirësoni mundësitë dhe shanset tuaja në tregun e punës, duke bërë më vonë një kualifikim profesional?


Kapitulli 7 prej faqes 108 tregon se si bëhet kjo.

Të gjithë kapitujt e veçantë kanë një strukturë të ngjashme

Në çdo kapitull dhe nënkaptull, në kolonën e 1-rë në të majtë ka një përshkrim të shkurtër. Aty gjenden shënime mbi ofertat në internet.

Nën  jepen informatat e rëndësishme të shkurtra në lidhje me ngritjen dhe arsimimin e mëtejme.

Portrete të shumta të njerëzve nga e gjithë bota, ilustrojnë rrugët e mundshme të arsimit.

Në kuti të veçanta  prindërit gjejnë këshilla dhe informata për mënyrën si ata mund t'i mbështesin fëmijët e tyre në përzgjedhjen e arsimit.

Për të gjitha pyetjet e tjera, ju lutemi kontaktoni këshillimoret për këshillime për profesion, studime dhe karrierë në kantonin tuaj ose vizitoni Qendrën Informative për profesionet.

Ne ju urojmë shumë suksese në rrugën e arsimit dhe në karrierën tuaj profesionale!

Heinz Staufer, SDBB

Përmbajtja

	Faqe	
	6	Sistemi arsimor zviceran
	6	Ofertat arsimore
	7	Ekipi për zgjedhjetë profesionit
	8	Sistemi arsimor – i depërtueshëm dhe i rrjetëzuar
	9	Financimi i arsimimit dhe i aftësimi të mëtejshëm
	9	Tareq Zeineddine, Liban, kimi dhe teknologji farmaceutike «Rruga për te profesioni im i ëndrrave»
Kapitulli 1	10	Vendosja e parë e drejtimit të binarëve: Prej nivelit primar në atë sekondar I
	12	Tre fëmijë – secili ndjek rrugën e vet
	17	Zgjedhja e arsimimit – ky proces do kohë
	18	Një klasë shkollore në zgjedhje të profesionit
Kapitulli 2	20	Hyrja në praktikë: Nga niveli sekondar I në arsimimin profesional
	22	Arsimimi bazë profesional për Atestin Federal të Profesionit
	25	Arsimimi bazë profesional për Certifikatën Federale të Aftësimi
	31	Arsimimi bazë profesional me maturë profesionale
	34	Arsimimi bazë i organizuar në mënyrë shkollore
Kapitulli 3	38	Zgjerimi dhe thellimi i arsimimit të përgjithshëm: Nga niveli sekondar I në gjimnaz ose në shkollë të mesme speciale
	40	Shkolla e Mesme Speciale dhe Matura Speciale
	42	Gjimnazi
Kapitulli 4	48	Hapat e parë në karrierën profesionale: Përgaditja e zgjedhjes së profesionit
Kapitulli 5	72	Modelimi i karrierës profesionale: Çfarë pas arsimimit bazë profesional?
	74	Punësimi ose arsimimi?
	76	Mësimi i shkurtuar pas Atestit Federal të Profesionit
	78	Arsimimi i dytë bazë profesional
	80	Matura pas mësimi të profesionit
	82	Shkollim i mëtejshëm, studimet
	83	Provimi Profesional dhe Provimi i Lartë Profesional
	86	Shkolla e Lartë Profesionale
	89	Shkolla e Lartë Universitare, Shkolla e Lartë Pedagogjike
	92	Universiteti dhe Shkollat e Larta Teknike Federale
Kapitulli 6	94	Planifikimi dhe jetësimi i studimeve: Si më tutje, pas gjimnazit ose shkollës së mesme speciale?
	96	Arsimimi në nivel terciar
	97	Pasqyrë përmbledhëse
	98	Fushat e studimit
	100	Pas maturës profesionale
	102	Pas maturës së gjimnazit
Kapitulli 7	108	Shfrytëzmi i shanseve dhe i mundësive: Pasarsimimi
	114	Fjalor

Ofertat për arsimim

	Përfundimi	Kohëzgjatja	Shpenzimet	Zgjidhje direkte ndërlidhëse
Ofertat ndërlidhëse	Vërtetimi (pa përfunduar)	Zakonisht 1 vit	Varësisht nga kantoni, vendbanimi dhe oferta ndërlidhëse: falas ose deri në 14 000 fr./viti	<ul style="list-style-type: none"> – Arsimimi bazë profesional – Gjinnazi ose shkolla e mesme speciale
Arsimi bazë profesional me Atest Federal të Profesionit	Atesti federal i profesionit	2 vjet	Si nxënës (shegert) ju merrni një pagë për nxënës, e cila dallon varësisht nga profesioni.	<ul style="list-style-type: none"> – Vendi i punës – Arsimimi bazë profesional me Certifikatë Federale të Aftësisimit EFZ
Arsimi bazë profesional me Certifikatë Federale të Aftësisimit	Certifikata federale e aftësisimit	3 ose 4 vjet	Si nxënës (shegert) ju merrni një pagë për nxënës, e cila dallon varësisht nga profesioni.	<ul style="list-style-type: none"> – Vendi i punës – Matura speciale e mëvonshme – Provimi profesional – Shkolla e lartë profesionale
Arsimi bazë profesional me Certifikatë Federale të Aftësisimit rruga shkollore	Certifikata federale e aftësisimit	3 ose 4 vjet	Si nxënës (shegert) ju merrni një pagë për nxënës, e cila dallon varësisht nga profesioni.	<ul style="list-style-type: none"> – Vendi i punës – Matura speciale e mëvonshme – Provimi profesional – Shkolla e lartë profesionale
Matura profesionale	Matura profesionale (e mundshme vetëm në kombinim me një arsimim bazë profesional së paku trevjeçar)	3 ose 4 vjet	Shpenzimet i heqin ndërmarrja ku mësoni dhe kantoni. Shpenzimet për materialin shkollor, udhëtimet mësimore, shëtitjet etj., i paguani vetë ose prindërit tuaj.	<ul style="list-style-type: none"> – Vendi i punës – Studimet në shkollë të lartë universitare – Passerelle dhe universitet
Shkolla e mesme speciale	Certifikata e shkollës së mesme speciale	3 vjet	Financohet nga kantoni. Shpenzimet për materialin shkollor, udhëtimet mësimore, shëtitjet etj., i paguani vetë ose prindërit tuaj.	– Shkolla e Lartë Profesionale
	Matura speciale	4 vjet (përfshirë praktika)		– Shkolla e Lartë Universitare
Gjinnazi	Matura e gjinnazit		Financohet nga kantoni. Shpenzimet për materialin shkollor, udhëtimet mësimore, shëtitjet etj., i paguani vetë ose prindërit tuaj.	<ul style="list-style-type: none"> – Universiteti – Shkolla e Lartë Federale Teknike ETH – Me praktikë (së paku 1 vit:) Shkolla e Lartë Universitare



EKIPI PËR ZGJEDHJETË PROFESIONIT

Sa më mirë të funksionojë bashkëpunimi me prindërit tuaj ose personat e tjerë të besueshëm, me mësimdhënës në shkollë dhe me këshillimore profesionale, aq më e suksesshme do të jetë faza e vendimmarrjes.

Këshilltarja ose këshilltari profesional koordinon tërë procesin dhe ju mbështet çdoherë kur ju nuk mund të përparoni. Këshillimorja profesionale punon me ju në mënyrë individuale, bën testet e arritshmërisë dhe ju këshillon në përzgjedhje të arsimimit.


Mësimdhënësit, së bashku me ju dhe prindërit tuaj, marrin vendimin e parë: gjimnazi, shkolla e mesme speciale ose arsimimi bazë profesional? Shkolla ju ndihmon të përgatiteni për provimet pranuese dhe testet e arritshmërisë, ose për përgatitjen e një dosjeje moderne të aplikimit.

Prindërit tuaj e njohin botën e profesionit. Ata i diskutojnë me ju dëshirat e mundshme të arsimimit. Bisedat e tilla ju ndihmojnë për të marrë vendime të drejta.

Në shumë vende ekzistojnë programe të mentorimit. Burra dhe gra ju shoqërojnë falas gjatë kërkimit të një zanati ose profesioni. Pyetni në shkollë ose në këshillimoren për profesione se ku mund të lajmëroheni për një mentorim.

Ju vetë merrni të ardhmen tuaj profesionale në duart tuaja. Ju informoheni, krahasoni rrugët e arsimimit me interesat dhe aftësitë tuaja, ju vendosni dhe veproni, mos hiqni dorë edhe nëse ndonjëherë hasni në vështirësi.

Sistemi arsimor – i depërtueshëm dhe i rrjetëzuar



Nuk ka përfundim pa lidhje

Sistemi arsimor në Zvicër është i rrjetëzuar dhe i depërtueshëm. Pas shkollimit të obligueshëm ju mund të filloni karrierën profesionale me arsimime të ndryshme, t'i caktoni vetes qëllime të reja dhe t'i arrini ato me arsimime të mëtejme.

Çdo hap i arsimimit shpie në një përfundim, dhe çdo përfundim garanton një kalim në një hap tjetër më të avansuar të arsimimit. Sot është më pak e rëndësishme se cilin hap të arsimimit ose cilin profesion e zgjidhni. Shumë më e rëndësishme është, se si i shfrytëzoni mundësitë dhe shanset.

Në këtë skemë janë paraqitur vetëm rrugët më të rëndësishme. Ka edhe shumë rrugë dhe veçanti të tjera. Pyetni këshilltarin tuaj personal nga Këshillimorja Profesionale.



FINANCIMI I ARSIMIMIT DHE I AFTËSIMIT TË MËTEJSHËM

Mësimi gjatë gjithë jetës shihet si parakusht në botën e sotme të punës dhe mund të jetë i shtrenjtë. Varësisht nga institucioni arsimor, studentët ose nxënësit e zanatit paguajnë shpenzime të shkollës, taksa, libra dhe material. Nëse nuk kanë para, prej kantonit të tyre të banimit ata mund të kërkojnë ndihmë financiare për arsimim.

Bursat kantonale

Shpërndarjen e kontributeve për arsimim e rregullojnë kantonet. Secili kanton ka një legjislacion të bursave. Përgjegjësit vendosin në bazë të rregulloreve, se a do të merrni ndihmë financiare për arsimim në formë të bursës, të cilën zakonisht nuk duhet ta ktheni, ose – rrallëherë – një kredi studimi, të cilën pas përfundimit të arsimimit duhet t'ia ktheni kantonit.

Bursa joshtetërore

Përveç kësaj, ekzistojnë fondacione dhe fonde të shumta, të cilat mbështesin arsimimin dhe ngritjen e mëtejme. Këshillimoret profesionale dhe këshillimoret për bursa mund t'ju ndihmojnë që të gjeni një përkrahje të tillë private financiare dhe të kërkon kontribute arsimore.

Informata të hollësishme për kontributet kantonale për arsimim mund të gjeni në <http://stipendien.educa.ch>. Ose bisedoni me këshillimoren për bursa në Këshillimoren Profesionale në rajonin tuaj.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2



TAREQ ZEINEDDINE, LIBAN

VITI I 1-RË

KIMI DHE TEKNOLOGJI FARMACEUTIKE

Rruga për te profesioni im i ëndrrave:

«Zgjedhja ime e profesionit ka të bëjë shumë me profesionin tim të ëndrrave. ...»

Unë patjetër dua të bëhem kimist. Unë intensivisht jam përpjekur që të gjej një vend për të mësuar zanatin, kam punuar ditë të tëra, madjejavë të tëra në përpilimin e shkresës së motivacionit. Ia ka vlejtur: Dega e kimisë dhe e teknologjisë farmaceutike është një fillim ideal për jetën time profesionale. Si profesionist i kësaj fushe më duhet ta përdor trurin tim dhe ta bëj punën me respekt dhe me përgjegjësi, sepse punoj me mjete kimike të cilat në sasi të mëdha mund të jenë të rrezikshme. Puna ime më bën krenar.

Ndërmarrja ku mësoj është në një fshat. Unë mendoj që kjo e bën punën më të thjeshtë, sepse të gjithë janë shumë të sjellshëm.

Në fillim të zanatit kisha frikë nga mentaliteti zviceran. Ky shqetësim imi ka të bëjë me thashethemet e të tjerëve për zviceranët dhe zviceranet. Kisha ndjenjë që të gjithë janë të paqasshëm dhe të ngurtë. Por është krejt ndryshe: Kolegët e mi zviceranë nuk janë kokëgdhe, ata janë të hapur dhe bisedojnë me dëshirë. Në ndërmarrje punët ecin super. Në shkollën profesionale nuk kam vështirësi me lëndët profesionale, me kiminë ose të tjerat. Përkundrazi, mosnjohja e gjuhës është një problem. Për detyrat e shtëpisë mua më duhet katër herë më shumë kohë se sa kolegeve dhe kolegëve të mi. Për fat më ndihmon mjeshtri im. Unë dua t'i përmirësoj njohuritë e mia gjuhësore, prandaj dhe tri herë në javë e vizitoj një kurs të gjuhës në mbrëmje. Dhe unë dua të mbetem te profesioni i ëndrrave të mia: pas përfundimit të zanatit, unë dëshiroj të mbledh provojë profesionale dhe krahas punës ta bëj maturën profesionale, pastaj Passarellen dhe të studioj kiminë në universitet.»

Që me kalimin nga niveli primar në nivelin Sekondar I vihen binarët drejtues. Mirëpo, sistemi arsimor në Zvicër mundëson zhvillime, ndryshime dhe riorientime gjatë gjithë karrierës profesionale. Ai lidh si rrjet rrugët e arsimimit të përgjithshëm dheshtigjet e formimit profesional së bashku dhe lejon mundësi të shumta për lidhje të ndërthurrura.

Ky kapitull është me interes të veçantë sidomos për prindër të huaj në Zvicër, fëmijët e të cilëve shkojnë në shkollën fillore. Ose për të gjithë ata, të cilët duan të dinë se si bëhet kalimi nga niveli primar në nivelin sekondar dhe për rolin e përcaktimit për karrierën e mëtejshme arsimore.

Vendosja e parë e drejtimit të binarëve

Prej nivelit primar në atë sekondar I

Faqe

- 12 *Një bisedë me Eveline dhe Michael Meni*
«Tre fëmijë – secili ndjek rrugën e vet»
- 16 *Marc Moran, Zvicër, Mësues i shkollës fillore*
«Ta vlerësosh drejt secilin fëmijë»
- 17 **Zgjedhja e arsimimit – ky proces do kohë**
- 18 **Një klasë shkollore në zgjedhje të profesionit**
Nxënëset dhe nxënësit e S3a nga Fehraltorf tregojnë

Kalimi nga niveli primar në nivelin sekondar I është vendosja e parë e drejtimit të binarëve në historinë earsimit të një fëmije qëshkon në shkollë në Zvicër. Nxënësit dhe nxënëset klasifikohen në nivelin sekondar I – varësisht nga suksesi në shkollë fillore – caktohen në klasa të niveleve të ndryshme.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2

Tre fëmijë – secili ndjek rrugën e vet



SHKOLLIMI I DETYRUESHËM

Shumica e nxënësve dhe e nxënësve ndjekin shkollimin e detyrueshëm në një shkollë publike në komunën e tyre të banimit. Përafërsisht 5% ndjekin një shkollë private. Shkolla publike ka një funksion të rëndësishëm të integritimit: fëmijët me prejardhje të ndryshme shoqërore, gjuhësore dhe kulturore ndjekin të njëjtën shkollë. Përgjegjësinë për shkollimin e detyrueshëm e kanë kantonet. Komunitat organizojnë mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ndjekja e shkollës publike është falas. Me rastin e fillimit të shkollimit të detyrueshëm, fëmijët zakonisht janë të moshës 4-vjeçare. Shkollimi i detyrueshëm zgjat 11 vjet. Niveli primar – duke përfshirë edhe kopshtin 2-vjeçar, ose (nëpër disa kantone) dy vjetët e para të një niveli hyrës- përfshin 8 vjet. Niveli sekondar I zgjat 3 vjet. Në Ticino niveli sekondar I (Scuola media) zgjat katër vjet.

KALIMI PREJ NIVELIT PRIMAR NË NIVELIN SEKUNDAR I

Të gjithë fëmijët nuk e kanë të njëjtin sukses dhe zotësi në shkollë. Dhe jo të gjithë kanë talente, interesa dhe aftësi të njëjta. Disa kanë dëshirë të punojnë me kokë, të tjerët janë shumë të talentuar dhe kanë dhunti dhe aftësi muzikore, shoqërore ose teknike. Dhe disa prej tyre nuk e kanë gjithmonë lehtë të përbushin kërkesat e shkollës.

Në këtë një të parë në historinë arsimore të një fëmije, është e rëndësishme që ai/ajo në nivelin sekondar të klasifikohet në nivelin e duhur të performancës.

NGARKESA E MANGËT POR EDHE MBINGARKESA PENGOJNË

Nxënëset dhe nxënësit hyjnë në nivelin sekondar I, zakonisht në moshën 12-vjeçare. Suksesi në fund të nivelit primar, rekomandimi i/e mësuesit/mësueses – shpeshherë përfshihen edhe prindërit në këtë vendim – e në disa vende provimet kaluese, madje edhe suksesi gjatë periudhës provuese në nivelin sekondar, janë vendimtarë për klasifikimin në një nivel të caktuar të arritjeve për nivelin sekondar I.

Këshilla dhe sugjerime për prindër

Si nënë ose baba ju mund të pranoni dobësitë e fëmijës dhe të thoni se «fëmija im nuk është aq i mirë në shkollë ashtu si e paramendoj unë». Nëse pajtoheni me këtë, atëherë fëmija ka shanse të reja.

Shkolla funksionon më së miri si bashkësi. Andaj, ju si prindëri përpiquni që shkollën dhe klasën t'i shihni si tërësi dhe

mos lakmoni të nxirrni përparësi vetëm për fëmijën tuaj.

Ju angazhoheni në shkollë, diskutoni me të tjerët, sillni mendimet tuaja. Atëherë kur është e qartë se keni parasysh mbarëvajtjen e krejt shkollës, atëherë keni të drejtë edhe të kritikoni dhe ajo kritikë pranohet.

Ju si prind nuk duhet të bëni presion për rezultate, mos kërkonti gjithmonë nota më të mira.

Ju duhet të lejoni që interesat e fëmijëve të zhvillohen dhe të mundë të ndryshojnë, që fëmija juaj të mundë të ndryshojë mendimin sërish.

Ju nuk i bëni presion kohor fëmijës tuaj. Fëmija juaj duhet ta ketë kohën e majftueshme që i nevojitet, për të marrë vendimet e veta.



FAMILJA MENI, ZVICËR

Secili fëmijë është ndryshe: «Secili fëmijë ka veçanti të tjera.» Nëse njëri djalë kishte probleme të shoqërimit me njerëz tjetërë, tjetri ndoshta ishte tepër i ri për të hyrë në shkollë. ...

Eveline Meni është drejtoreshë e Qendrës për Fëmijë në shkollën fillore Steckborn, punon me thirrje në shkollën fillore si ndihmëse në klasë dhe mbështet fëmijët në raste individuale në procesin e integritimit.

Michael Meni është zëvendës-drejtor i Qendrës Rajonale për Ndërmjetësim në rast papunësie në Winterthur.

Ata kanë tre fëmijë:

Lars (19) është shitës profesional me pakicë me Certifikat Federale të Aftësisimit, në degën e pijeve dhe ushqimit.

Jano (18) në vitin e 3-të të zanatit si tregtar me pakicë në degën logjistike e pjesëve të automjeteve

Sina (12) në klasën e fundit të shkollës fillore

A ju kujtohet koha kur Lars ka filluar shkollën, si ishte atëherë? Çfarë ka qenë e rëndësishme për ju?

Eveline: Më kujtohet mirë. Unë vetëm kam dëshiruar, që atij t'i ecën mbarë kalimi në shkollë. Ai ka qenë më i riu në klasë, por më shtatlarti. Dhe ai kishte një problem të vogël me të folurit, sepse nuk ka mundur ta theksonte «ts» drejt. Për këtë arsye logopedja ka kërkuar që ai, me fillimin e shkollës, të fillonte edhe një terapi. Këtë e kemi refuzuar ne, sepse ne donim që ai të fillonte shkollën pa shushurima ose zhurmë rreth tij. Thjesht, me handikapi e moshës dhe të gabimit gjuhësor. Ndoshta – më vonë kemi menduar shpesh për këtë – është dashur të presim edhe një vit me fillimin e shkollës.

Michael: Unë, herë pas here, të premtëve në mëngjes, vizitoja fëmijët në kopshtin e fëmijëve dhe përcillja fëmijët në pyll, për shembull. Nëse një fëmijë në këtë moshë është më i ri se të tjerët, atëherë kjo vërehet. Larsi përpiquej, por disa gjëra nuk mund t'i bënte aq mirë si fëmijët e tjerë. Dukej qartë se ai duhej të mësonte edhe ca. Edhe për mua ka qenë shumë me rëndësi që Larsi me rastin e hyrjes në shkollë, të ndihej mirë.»



A ka mundur Larsi të përshtatet mirë?

Eveline: Në nivelin e ulët nuk kishte probleme Mirëpo rreth moshës dhjetëvjeçare ai kishte vështirësi. Larsi përpiqej, ishte i zellshëm, megjithatë suksesi i tij shkollor filloi të bjerë prej nivelit të mirë në atë mesatar. Mes tjerash edhe për shkak të problemeve që kishte me mësuesin.

Michael: Ne gjithmonë përpiqemi të kemi kontakt aktiv me shkollën, i diskutojmë problemet aktuale shpejt me mësuesit, angazhohemi në këshillin e prindërve dhe shkojmë rregullisht në mbrëmjet e prindërve. Por në këtë rast nuk ia vlente të ndërmerremi diçka, sepse mësuesi ishte para pensionimit; Larsi duhej të qëndronte dhe të vazhdonte.

A nuk ishte pak fatkeqe kjo gjendje, kur është fjala te kalimi në nivelin sekondar?

Michael: Jo edhe aq. Ne si prindër nuk kemi bërë presion ndaj fëmijëve për të arritur diçka. Unë kurrë nuk kam dashur të marr pjesë në garën midis disa prindërve, të cilët thoshin djali im është më i miri, vajza ime është më e madhja. E di, edhe nga përvoja ime profesionale, se: përfundimi i shkollës me rezultate të mira është me rëndësi. Mirëpo, gjithashtu po aq e rëndësishme është të fillosh karrierën profesionale me një diplomë në profesion.

Eveline: Larsi është ckatuar në nivelin e mesëm dhe ka mbaruar dy vjetët e nivelit sekondar me nota aq të mira, sa që klasën e 3-të të nivelit sekondar ka mundur ta bëjë në një nivel të zgjeruar. Caktimi në këtë nivel në fillim të nivelit sekondar për të nuk ka luajtur rol edhe aq të madh.

Në të vërtetë, atëherë ai me dëshirë do të ishte bërë edukator në kopsht të fëmijëve. Për fat të keq, për pak nuk e kaloi provimin pranues në shkollën e mesme profesionale.

Michael: Provimet pranuese në shkollat e mesme profesionale ose gjimnaze ishin në prill, pra shumë vonë. Të gjithë fëmijët, që nuk kalojnë provimin pranues, duhet të gjejnë një vend zanati brenda një afati të shkurtër. Edhe Larsi.

Për fat të mirë ai gjeti një vend zanati si tregtar profesional me pakicë me Certifikatë Federale të Aftësimi. Është një profesion, i cili i pëlqen dhe ku ai kishte bërë një trajnim të shkurtër. Ai hyri në një ndërmarrje e cila i sfidon nxënësit mirë. Sot, pas përfundimit të suksesshëm të zanatit dhe vazhdimi të punës në po atë ndërmarrje ku bëri zanatin, Larsi është në fillim të një karriere shumë premtuese profesionale, nëse e shfrytëzon shansin i cili i është dhënë.

Ju keni mundur të mësoni shumë duke përcjellur shkollimin e Larsit.**A ju ka ndihmuar kjo për përkrahjen e dy fëmijëve të tjerë?**

Eveline: Secili fëmijë është ndryshe, secili fëmijë ka veçoritë e tij. Jano, djali ynë i dytë, nuk ka pasur probleme shkollore. Ai ka pasur vështirësi për t'i pranuar ndryshimet.

Ai pati vështirësi për t'u larguar prej shtëpisë, për të pranuar persona të tjerë të rritur si persona të besueshëm. Atij i është dashur një gjysmë viti për t'u hapur ndaj mësimdhënësve të rinj.

Me rastin e kalimit në nivelin sekondar, ai është caktuar në nivelin e zgjeruar ose më të lartë. Por, Jano është tip njeriu të cilit i duhet mjaft kohë e lirë për t'u ndier mirë dhe për t'u zhvilluar si duhet. Kur ne si prindër vërejtëm presionin e lartë ndaj tij, se sa e madhe ishte ngarkesa për të, ne arritëm që ai të kthehet në nivelin bazë. Ne nuk deshëm këtë performancë nga ai. Kënaqësia e Janos ishte më e rëndësishme për ne. Vitet e rinisë janë vendimtare për zhvillimin e tij. Këto vite nuk ikthehen kurrë.

Michael: Më e rëndësishmja për ne është, që fëmijët tanë të arsimohen. Mësimi i një profesioni për ne ka të njëjtën rëndësi si karriera shkollore. Nëse Jano më vonë bën plane të tjera dhe do të studiojë, ai këtë mund ta bëjë edhe më vonë, sepse sistemi ynë i arsimit është i depërtueshëm dhe elastik.

Si është puna me Sinën, vajzën më të re?

Michael: Sina është një mendje e lirë, të mos them kokëfortë. Sina ka vështirësi në mësimin e matematikës, po edhe për lëndët e tjera duhet të investojë shumë kohë, për të përmbushur objektivat e mësimin. Sina ka një ritëm tjetër të të mësuarit, më të ngadalshëm, se fëmijët e tjerë në klasën e saj.

Eveline: Unë punoj si ndihmëse e klasës dhe i përkrah fëmijët individualisht për integrim. Unë kam zbatuar atë që ka caktuar pedagogu special i shkollës dhe kështu kam mësuar shumë për ballafaqimin me vështirësitë mësimore. Mirëpo, mundësitë për ta përkrahur Sinën në shtëpi janë të kufizuara, sepse në jetën e saj kam edhe një rol tjetër. Unë jam nëna dhe jo mësuesja e saj.

Ne e kemi biseduar këtë problem me shkollën. Si hap i parë, Sina ka punuar në matematikë me një pedagog special të shkollës dhe kjo ende është një sfidë tepër e madhe për të. Tash, në klasën e fundit të shkollës fillore, shkolla i ka përshtatur sërish objektivat mësimore për Sinën. Ne do të vazhdojmë të përcjellim, se si do të zhvillohet kjo më tutje dhe së bashku me shkollën të gjejmë zgjidhjen më të mirë.



MODELET E NDRYSHME SHKOLLORE NË NIVELIN SEKONNDAR VARËSISHT NGA KANTONI

Secili kanton përcaktohet për një procedurë të kalimit nga niveli primar në nivelin sekondar I, si dhe për një model shkollor në nivelin sekondar I. Ekzistojnë 3 modele të ndryshme:

Modeli i ndarë

Ndarja e nxënësve dhe nxënësve bëhet në përputhje me nivelin e rezultateve. Klasat dhe shkollat e bazuara në rezultate ose nota, mësimin e zhvillojnë me programe dhe mjete mësimore të ndryshme dhe të diferencuara. Zakonisht ekzistojnë 2 deri 3 lloje të shkollave, emërtimet e të cilave nuk janë të njëjta në të gjitha kantonet. Struktura e hasur shpesh përbëhet prej 3 llojeve të shkollave, me një tip të shkollës me standarde më të larta, një më të mesme dhe një me kërkesa themelore (p.sh. shkolla e sekondare A, B dhe C).

Modeli bashkëpunues

Modeli bashkëpunues është i bazuar në klasa bazë me kërkesa të ndryshme. Varësisht nga niveli i rezultateve, nxënësit dhe nxënëset caktohen në një klasë bazë. Mirëpo, lëndë të caktuara i ndjekin në grupe të nivelit të caktuar. Për shembull, një nxënës në matematikë i plotëson kërkesat themelore, ndërsa në gjuhë ato të larta.

Modeli i integruar

Modeli i integruar përbëhet nga klasët bazë pa seleksionim: nxënësit dhe nxënëset me rezultate të ndryshme vijojnë klasën e njëjtë bazë. Përzjerja e klasës mbetet. Në disa lëndë, sikurse edhe në modelin bashkëpunues, krijohen grupet e niveleve të ndryshme.

Ta Vlerësosh drejt secilin fëmijë: «Si mësues unë jam përgjegjës edhe për kalimin në nivelin sekondar me tri nivele ose në gjimnaz. ...

MARK MORAN, ZVICËR
MËSUES I FILLORES KLASAT 4 - 6
WINTERTHUR



Ta vlerësosh drejt secilin fëmijë, për mua kjo është një përgjegjësi e madhe, sepse këtu kërkohet që nxënësen ose nxënësin mos ta mbivlerësoj po as ta nënvlerësoj.

Vendimin tim, të cilin mund ta diskutoj me profesionistë, e bisedoj pastaj me prindërit. Jo gjithmonë ne i vlerësojmë njëjtë potencialin dhe aftësitë e një fëmije. Nëse unë, në bazë të rezultateve të tre vjetëve të fundit, e shoh më të arsyeshme që nxënësi të vazhdojë në Sek B, prindërit druajnë se ky klasifikim më i ulët mund ta dëmtojë fëmijën e tyre, se mund të stigmatizohet si i paaftë dhe kjo do t'i shkaktojë vështirësi më vonë në zgjedhjen e profesionit. Ndonjëherë vjen deri te biseda e dytë me prindërit, e ndonjëherë përfshihen edhe drejtorja e shkollës dhe mësuesi i nivelit Sekondar I. Ne gjithmonë duhet të gjejmë një zgjidhje, e cila në rend të parë i përshtatet nxënësit ose nxënëses.»



NDIKIMET E NIVELITË PËR PERFORMANCËN PËR KALIMIN NË NIVELIN SEKONDAR II

Me rastin e kalimit në të ashtuquajturën nivelin Sekondar II, një rol e luan klasifikimi i nivelit në nivelin Sekondar I (shih fq. 15).

Pas shkollës së detyrueshme, në nivelin Sekondar II keni në dispozicion dy rrugë të arsimit:

1. Rruga përmes drejtimeve të arsimit të përgjithshëm, si gjimnazi ose shkolla e mesme speciale: me këtë ju zakonisht nuk kualifikoheni drejtpërdrejt për një profesion të caktuar, por përgatiteni për studime në universitet, shkolla të larta profesionale apo shkolla të larta universitare.
2. Rruga nëpërmjet arsimit bazë profesional (zanat): të rinjtë mësojnë një profesion në ndërmarrje me mësim plotësues shkollor (shkollë profesionale) dhe mësim teorik dhe praktik (kurset jashtë ndërmarrjes). Arsimimi bazë profesional po ashtu mund të bëhet edhe në shkolla me orar të plotë.

Nxënësit dhe nxënëset me rezultate të mira, mund të zgjedhin midis dy formave të arsimit, të shkojnë në gjimnaz ose shkollë të mesme speciale ose të vendosin për një arsim bazë profesional. Të dy rrugët mund të përfundojnë me një diplomë (matura e gjimnazit, matura profesionale, ose maturë zanati) dhe të hapin rrugën për studime në një shkollim të lartë. Nxënëset dhe nxënësit më pak të talentuar dhe ata të cilët tregojnë pak interesim për të mësuar, mund të zgjedhin nga një gamë e gjerë e arsimeve bazë profesionale, atë që u përshtatet më së miri aftësive dhe interesit të tyre.

Zgjedhja e arsimimit të duhur është një proces. Ju e njihni vetveten, i vlerësoni aftësitë tuaja në mënyrë reale dhe i krahasoni ato me mundësitë dhe me shanset në botën e arsimimit. Ju vendosni për një rrugë dhe e realizoni arsimimin që keni zgjedhur.

Zgjedhja e arsimimit – ky proces do kohë

Pas kohës së shkollimit të detyrueshëm, ju i keni dy rrugë të barasvlershme të arsimimit. Mund të vendosni për një rrugë shkollore, gjimnaz ose shkollë të mesme speciale ose të zgjidhni një arsimim bazë profesional. Varet nga interesat dhe aftësitë tuaja, cila rrugë e arsimimit ju përgjigjet juve.

Gjimnazi dhe shkolla e mesme speciale – më shumë angazhim dhe më shumë detyra të shtëpisë

Gjimnazistët dhe gjimnazistet, nxënëset dhe nxënësit e shkollës së mesme speciale, shkojnë në shkollë me kënaqësi, mësojnë me vullnet si dhe munden e duan – në krahasim me shkollimin e detyrueshëm – të angazhohen më shumë në shkollë, të mësojnë më shumë. Ata nuk i pengon fakti se çdo ditë duhet të bëjnë nga dy, e ndoshta edhe nga tri orë, detyra shtëpie.

Në mënyrë që të pranohen në gjimnaz ose në shkollë të mesme speciale, ata qysh gjatë shkollimit të detyrueshëm janë nxënëse dhe nxënës të mirë. Ata ndjekin shkollën e nivelit të lartë me kërkesa të avancuara, kanë nota të mira në të gjitha lëndët dhe interesim të gjerë.

Në pjesën gjermanofolëse ju ndihmon testi i arritshmërisë, i cili ofrohet prej shkollave ose këshillimoreve për zgjedhjen e profesionit dhe tregon në mënyrë objektive ku qëndroni. Nëse e arrini një rezultat prej 600 deri 700 pikë, atëherë gjimnazi ose shkolla e mesme speciale mund të jetë rruga e përshtatshme për ju.

Me kureshtje në procesin e zgjedhjes së profesionit

Krahasuar me rrugën e shkollimit të përgjithshëm, zgjedhja e profesionit të përshtatshëm dhe gjetja e ndërmarrjes për mësimin e profesionit është një proces kompleks, sepse ekzistojnë rreth 200 profesione për të cilat ju mund të përcaktoheni. Në këtë fazë të zgjedhjes së profesionit, ju duhet të jeni kureshtarë, t'i shikoni profesionet e ndryshme në fusha të ndryshme profesionale dhe t'i krahasoni ato me interesimin dhe aftësitë tuaja.

Ndoshta këtë proces do ta bëni vetë, në mënyrë të pavarur, ndoshta ju filloni në shkollë me ligjërata për zgjedhjen e profesionit. Nëse keni nevojë, kërkoni mbështetje, flisni me prindërit tuaj, me mësimdhënësit, kolegët dhe koleget tuaja ose me këshillimoren për profesione.

Një klasë shkollore në nivelin Sekondar I në përzgjedhje të profesionit. Shumica në këtë klasë të Cyrihut janë përcaktuar për një arsimim bazë profesional.

Një klasë shkollore në zgjedhje të profesionit

Shumica e nxënësve dhe nxënseve të klasës S3a (niveli më i lartë shkollore) në Fehraltorf, e kanë ditur saktësisht, shumë herët, se çfarë arsimimi duan të bëjnë pas përfundimit të shkollimit të detyrueshëm. Përveç dy prej tyre, të gjithë ishin përcaktuar për arsimimin bazë profesional dhe kishin gjetur vende për mësim të zanatit. Dy vajza duan të shkojnë në gjimnaz.

Njëra dëshiron të studiojë gjeologji – ose thënë më saktë – dëshira e saj është të punojë njëherë si vullkanologe. Tjetra dëshiron të vazhdojë shkollën, meqë ende nuk e di saktësisht se cili do të jetë profesioni i saj i ardhshëm. «Unë kam pasur oferta për të mësuar profesionin e asistentes së farmakologjisë, mirëpo disi ky profesion nuk më është përshtatur. Unë do të shkoj në gjimnaz, që të mos e humb tërësisht lidhjen me shkollën. Nëse më pëlqen, vitin e ardhshëm do të mbetem në gjimnaz, përndryshe përsëri kërkohet një vend për të mësuar profesionin.»

Shumësia e profesioneve

Gjashtë duan të bëhen tregtarë, tre në informatikë, dy asistente të praktikës mjekësore, dy mekanikë të përgjithshëm (Polimekanik); shumë prej tyre duan të kombinojnë shkollimin bazë profesional me maturën profesionale. Një nxënës do të bëhet marangoz, ngase ky profesion i përshtatet interesave të tij, sepse ai është alpinist i pasionuar dhe mezi pret të ndërtojë çati në lartësi të mëdha. Një tjetër dëshiron të bëhet automekantronik, pasi më shumë i pëlqen të punojë me duar sesa me kompjuter.

Një nxënës dëshiron të mësojë zanatin e elektroinstalueses. Ajo gjithmonë e ka ditur se do të mësojë një profesion teknik dhe ka bërë një përvojë provuese si elektroplanifikuese. Në zyrë i është dukur e mërzitshme, në ndërtimtari i ka pëlqyer më shumë. Ajo e di se në vitin e parë të mësimin të profesionit do të jetë e vetmja femër në shkollën profesionale. Ajo mendon, se kjo është çështje e përshtatjes, mirëpo ajo do t'ia dalë. Sidoqoftë, ajo i gëzohet zanatit.

Këshilla dhe sugjerime për prindër

Nxënëset dhe nxënësit duhet të marrin procesin në duart e veta. Ata duhet me kënaqësi të vendosin për rrugën e tyre të arsimimit. Por, ata kanë nevojë edhe për mbështetjen tuaj:

Tema e zgjedhjes së profesionit duhet të jetë temë tryeze në familje. Diskutoni me fëmijët tuaj për interesimet e tyre, aftësitë dhe të metat ose veçoritë e karakterit.

Përkujtojani fëmijëve tuaj gjërat të cilat ata më herët i kanë bërë me kënaqësi.

Vendosni interesat e fëmijëve tuaj në qendër. Mos tentoni që nëpërmjet fëmijëve t'i realizoni ëndërrat tuaja profesionale.

Bëhuni edhe ju kureshtarë; përpiquni që së bashku me fëmijët tuaj të zgjeroni horizontin tuaj, të shikoni profesione të cilat edhe ju vetë nuk i njihni.

Bëjeni temë bisede edhe përditshmërinë tuaj, flisni mbi përvojat tuaja në vendin e punës.

Motivoni fëmijët tuaj të jenë aktivë dhe të motivuar.

Tregoni interesim në procesin e zgjedhjes së profesionit, pyetni fëmijët për përvojat e tyre në punën provuese dhe vlerësoni ato së bashku me fëmijët tuaj.

Me pak aplikacione në cak

Shumica e nxënësve dhe nxënësve është dashur të shkruajnë më pak se dhjetë aplikacione, për të gjetur vend për mësim të profesionit. Duket qartë se niveli më i lartë shkollor sjell përparësi, thonë ata njëzëri. «Duket haptas, se zakonisht ne jemi të mirë në shkollë dhe supozojmë se nuk jemi të pakokë. Nëse angazhohesh dhe tregon interesim të plotë, je i sjellshëm në prezantim, atëherë ndërmarrja të ofron vend për mësim të profesionit», mendon një nxënës.

«Mirëpo, këto vende për mësimin e profesionit nuk na janë falur», ka nënvizuar një nxënës. «Ne jemi përpjekur, kemi menduar mirë për dobësitë dhe aftësitë tona, kemi filluar me kohë të shkruajmë aplikacione atraktive dhe të pastra, jemi përgatitur në mënyrë intensive për intervistat, jemi informuar mirë për ndërmarrjet ku kemi aplikuar dhe kemi arritur të formulojmë se pse kemi zgjedhur këtë profesion. Sigurisht edhe këta kanë qenë faktorët e suksesit, sikur edhe notat e mira.»



ARSIMIMI BAZË PROFE- SIONAL OSE SHKOLLA E ARSIMITË PËRGJITH- SHËM?

Në kantonet gjermanofolëse, mesatarisht rreth 20 deri 25 për qind të nxënësve dhe nxënësve, pas nivelit Sekondar I, bëjnë një arsimim të përgjithshëm shkollor, ndërsa pjesa dërmuese e tyre zgjedh rrugën e arsimimit bazë profesionale. Në pjesën frankofone dhe atë italofone të Zvicrës, kjo përqindje është dukshëm më e lartë, por edhe atje shumica e të rinjve mëson një zana, meqenëse arsimimi bazë profesional atje, më shpesh se në pjesën gjermanofolëse, është i organizuar në shkollat me orar të plotë me praktikë. Sistemi arsimor zviceran ka një reputacion të mirë. Kjo, pjesërisht ka lidhje me nivelin e lartë të shkollave të mesme speciale, gjimnazeve dhe shkollave të larta, e në anën tjetër me sistemin e mirëmen-
duar, të ashtuquajtur sistem dual, i cili, falë kombinimit të mësimit shkollor dhe arsimi-
mit praktik, për shumë të rinj ofron zgjidhje më të mira dhe adekuate, sesa shkollimi i përgjithshëm. Të dy format e arsimimit shpiejnë në profesione me mundësi të mira për ngritje të mëtejme profesionale.

Duke qenë se sistemi arsimor zviceran është edhe shumë i depërtueshëm, ky përcaktim i parë i drejtimit «zanati ose shkolla?» edhe pse është i rëndësishëm në jetën e çdo nxënësi dhe duhet të merret seriozisht, megjithatë nuk është vendimi përfundimtar për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës profesionale.

Shfrytëzoni ndihmën profesionale, nëse keni përshtypjen se procesi nuk po ecën.

Kërkoni të bisedoni me mësime dhënë, bisedoni me ta, se cila është rruga më e mirë dhe më e për-

shtatshme e arsimimit për djalin ose vajzën tuaj. Vizitoni bashkë me vajzën ose djalin tuaj Qendrën Informative për Profesionet. Shikoni së bashku informacionet në videokaseta, internet ose në letër.

Vizitoni bashkë me vajzën ose djalin tuaj një panair profesional. Informohuni nga kontaktet e drejtpërdrejta me

profesionistët, në lidhje me profesionet përkatëse.

Pyetni në këshillimoren për profesione, nëse vajza ose djali juaj mund të marrë mbështetje shtesë nga një mentore ose mentor, nëse ngec.

Kalimi nga niveli **Sekondar I në arsimim profesional të nivelit **Sekondar II**, është përcaktimi i drejtimit të binarëve për një fushë profesionale ose degë: natyra ose dizajni, ndërtim ose shitje, informatikë ose shëndetësi? Arsimimi bazë profesional, i quajtur «zanat» ose «mësim profesioni», zgjat 2, 3 ose 4 vjetdhe ofron më se 200 profesione. Kjo mund të kombinohet me maturën profesionale.**

Ky kapitull është interesant për migrantët e rinj ose migrantet e reja (dhe prindërit e tyre), të cilët janë në prag të përfundimit të shkollimit të tyre të detyrueshëm në nivelin Sekondar I, janë para kalimit në arsimim bazë profesional dhe duan të dinë se cilat mundësi të arsimimit në nivelin Sekondar II ekzistojnë.

Hyrja në praktikë

Nga niveli sekondar I në arsimimin profesional

Faqe

- 22 **Arsimimi bazë profesional për Atestin Federal të Profesionit**
- 23 *Rondik Taher Mosa, Irak, shitës-asistent me pakicë*
«Mjaft kohë, për të mësuar mirë»
- 24 *Samuel Frei, Zvicër, punonjës kuzhine*
«Përkujdesja e mirë për sukses»
- 25 **Arsimimi bazë profesional për Certifikatën Federale të Aftësisimit**
- 26 *Norina Bosshard, Zvicër, oxhaktare*
«Pas punës provuese ishte e qartë»
- 27 *Dafina Elmazi, Kosovë, nëpunëse e profilit B*
«Unë me çdo kusht dëshiroja të bëhesha nëpunëse»
- 28 *Celia Haldimann, Brazil, përkujdesje shtëpiake*
«Aftësitë e vërteta për profesionin»
- 29 *Kiber Ahmadzy, Afganistan, elektroinstalues*
«Patjetër një profesion me elektroteknikë»
- 30 *Farhan Abdi Omar, Somali, bukëpjekës-pastiçeri-konfiseri*
«Profesioni i ëndrrave është shtyrë për më vonë»
- 31 **Arsimimi bazë profesional me maturë profesionale**
- 32 *Preethy Vadakkadath, Indi, automatike*
«Lidhja ideale e teorisë me praktikën»
- 33 *Mark Egli, Zvicër, elektronist*
«Jo në gjimnaz»
- 34 **Arsimimi bazë i organizuar në mënyrë shkollore**
- 35 *Marius Küng, Zvicër, informatikë*
«Hyrja shkollore në informatikë»
- 36 *Michael Roschi, nëpunës*
«Shkolla e mesme komerciale si hyrje në jetën profesionale»
- 37 *Isabel Silva, Portugali, nëpunëse*
«Arsimimi i mirë i përgjithshëm, nisje i mirë»

Arsimimi për Atestin Federal të Profesionit, zgjat 2 vjet dhe është menduar për nxënësit dhe nxënëset, të cilët gjatë mësimin kanë nevojë për pak më shumë kohë, ose performanca shkollore e të cilëve për një arsimim bazë 3 ose 4-vjeçar nuk mjafton. Arsimimi praktik në ndërmarrje dhe mësimi në shkollën profesionale, si dhe në kurset jashtë ndërmarrjes, marrin parasysh këto rrethana.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2

Arsimimi bazë profesional për Atestin Federal të Profesionit



ÇFARË ËSHTË ARSIMIMI BAZË ME ATESTIN FEDERAL TË PROFESIONIT?

Arsimimi bazë 2-vjeçar shpie tek Atesti Federal i Profesionit. Pas përfundimit, nxënësit – në të njëjtin profesion – kanë aftësi dhe kompetenca të krahasueshme, pa marrë parasysh se a kanë mësuar në Bazel, St. Gallen, Lozanë ose Belinzona. Kjo lehtëson kërkimin e vendeve të punës, sepse Atesti Federal i Profesionit, i bën të dukshme dhe transparente kompetencat e arritura profesionale, metodologjike dhe sociale për punëdhënësit.

ÇFARË ARSIMIMI BAZË SILLNI PËR ATESTIN PROFESIONAL?

Ndoshta ju keni talent në punë praktike, por ngjanë të keni vështirësi me të mësuarit teorik. Shkollat profesionale i adresojnë këto nevoja.

Ndoshta ju mësoni më ngadalë. Ndërmarrja mësimore dhe shkolla profesionale, do ta marrin parasysh këtë shprehi të të mësuarit.

Ndoshta keni nevojë për udhëzime të qarta, njohje memjedisin e punës, dhe meproceset e punës, për të arritur rezultate të mira në mësim. Ose ndoshta preferoni të zotëroni mirë një fushë të punës, para se të futeni në një fushë të re.

Këshilla dhe sugjerime për prindër

Kujdesuni që djali juaj, vajza juaj t'i vlerësojë realisht aftësitë e veta. Ajo ose ai nuk guxojnë as të mbingarkohen as të nënngarkohen gjatë arsimimit.

Shoqërojeni djalin tuaj, vajzën tuaj te këshilltari ose këshilltarja për profesione. Sqaroni bashkë me këshillimoren për profesione se, cilat aftësi dhe kompetenca i ka fëmija juaj.

Mbështeteni vajzën tuaj, djalin tuaj edhe gjatë arsimimit.

Ndoshta nuk jeni gjatë kohë në Zvicër dhe njohuritë tuaja gjuhësore nuk mjaftojnë për shkollën profesionale të një arsimimi bazë për Certifikatë Federale të Aftësimit. Për ju një arsimim bazë me atest do të ishte hyrja ideale në botën profesionale.

OFERTAT

Për të pasur një pasqyrë më të mirë, bota e punës në Zvicër zakonisht ndahet në fusha profesionale (shih poashtu faqen 51). Arsimimi ekziston pothuajse në të gjitha fushat profesionale. Tipike janë për shembull në degët e natyrës, ushqim ekonomi shtëpiake, hoteleri/gastronomi, tekstil, bukuri/kozmetikë, ndërtim, teknologji e ndërtimit, dru dhe ndërtim i brendshëm, përpunim i metalit, automjete, ekonomi/administratë, shitje, trafik/logjistikë ose lëmi i shëndetësisë dhe social.



RONDIK TAHER MOSA, IRAK

VITI 1-RË

SHITËS-ASISTENTE NË TREGTINË ME PAKICË

DEGA USHQIMORE DHE E PIJEVE, ATESTI FEDERAL I PROFESIONIT

Mjaft kohë, për të mësuar mirë: «Unë vij nga një familje, ku mësimi është i rëndësishëm. ...

Babai im gjithmonë ka dashur, që të gjithë fëmijët e tij të mësojnë, të kenë një shkollim të mirë, një profesion të mirë dhe të bëjnë karrierë. Prandaj unë në Irak kam shkuar dymbëdhjetë vjet në shollë dhe kam përfunduar maturën. Kur erdha në Zvicër, unë shpejt e kuptova se këtu nuk është lehtë të gesh një punë të mirë pa shkollim. Dhe unë nuk dua që tërë jetën time të pastroj ose të qëndroj në shtëpi, jeta e shtëpiakes për mua do të ishte shumë e mërzitshme. Unë dua të punoj.

Po të kisha qëndruar në Irak, unë do të kisha mësuar profesionin e farmacistes. Këtu në Zvicër kjo për fat të keq nuk është e mundur për mua. Në kursin e integritimit unë kam parë shumë profesione. Sektori i shitjes

me pakicë, me fokus në degën e ushqimeve dhe të pijeve, më ka pëlqyer më së miri.

Knaqësi në lidhjen e kontakteve

Në këtë profesion unë kam kontakte me njerëz të tjerë. Kjo për mua është me rëndësi, sepse unë jam një person shumë i hapur dhe i shoqërueshëm. Dhe në këtë shkollim mësoj shumë për gjërat ushqimore. Këto janë njohuri profesionale, të cilat unë mund t'i përdor në jetën time të përditshme. Është mirë të dimë, se si ne mund të ushqehemi shëndetshëm.

Unë e di që dy vjetët e ardhshme nuk do të jenë të lehta për mua. Unë ende duhet t'i përmirësoj njohuritë e mia gjuhësore, për detyrat e shtëpisë më duhet të investoj më shumë kohë sesa kolegët e mi. Por unë jam me fat. Partneri im më mbështet, ai më ndihmon në punët e shtëpisë, madje edhe përgatit ushqimin. Ai dëshiron që unë të kem kohë të mjaftueshme për të mësuar. Prandaj unë jam e sigurt se do t'ia dal.»



SAMUEL FREI, ZVICËR

VITI 2-TË, ZANAT

PUNONJËS KUZHINE, ATESTI FEDERAL I PROFESIONIT

Përkujdesja e mirë për sukses: «Gatimi gjithnjë ka qenë hobi im. Pas klasës së 10 fillova arsimimin trevjeçar për kuzhinier. ...

Ndërmarrja e zanatit ishte në një kanton tjetër. U detyrova të banoja aty. Fatkeqësisht, ndërmarrja mësimore dhe unë nuk përputheshim fare. Për mua ishte posaçërisht i vështirë orari i parregullt i punës.

Me përkrahjen e prindërve të mi u ktheva përsëri në Cyrih. Në vitin e dytë, në një ndërmarrje të re, u detyrova të njihja njerëz të ri dhe të mësohesha për të punuar me ta. Fatkeqësisht pata disa probleme: punoja tepër ngadalë dhe kisha vështirësi t'i bëja disa punë njëkohësisht. Ndërmarrja më propozoi që të bëja një arsimim dyvjeçar me Atest Federal të

Profesionit. Fillimisht isha i zhgënjyer, mirëpo tani po i shoh përparësitë. Në shkollën profesionale speciale jemi një klasë e vogël me 10 nxënës. Ne të gjithë e njohim mirë njëri-tjetrin dhe mësimdhënësi ka më shumë kohë për të punuar me ne. Po ashtu, në ndërmarrjen time të tanishme po e ndiej veten mirë. Unë kam një ambient të mirë mësimi.

Hapi i parë drejt qëllimit

Në verë do ta bëj provimin e zanatit. Ky është hapi i parë drejt qëllimit tim. Nëse është e mundur, do t'ia filloj mësimin përsëri në vitin e 2-të arsimimit bazë trevjeçar dhe ta përfundoj si kuzhinier me Certifikatë Federale të Aftësimit. Për të ardhmen time profesionale mund të paramendoj shumë gjëra: shef i kuzhinës ose mësues lëndor i profesionit – për këtë më duhet matura profesionale – ose një përvojë jashtë vendit dhe njohja e kuzhinës kineze ose japoneze.»



KURSET MBËSHTETËSE DHE PËRCJELLJA INDIVIDUALE

Për arsye të ndryshme, arsimimi bazë profesional për atest në ndërmarrje të zanatit ose në shkollën profesionale speciale mund të sjellë vështirësi:

Ndoshta e kuptoni se nuk mund të përcillni mirë mësimet. Në këtë rast, ju duhet që mundësisht sa më shpejtë të diskutoni me mësimdhënësin për problemin. Eventualisht, ju mund t'i përmirësoni rezultatet me një kurs mbështetës.

Ndoshta ju keni vështirësi bashkëpunimi në ndërmarrje, në marrëdhëniet me kolege dhe kolegë më të moshuar. Ose kërkesat, të cilat i parashtron ndërmarrja janë shumë të larta. Flisni për këtë mundësisht sa më shpejt me mjeshttrin ose mjeshtren. Ata mund të kujdesen, që ju gjatë mësimin të zanatit të keni mbështetje dhe përcjellje individuale.

S'KA PËRFUNDIM PA PËRFSHIRJE

Pas përfundimit me sukses të arsimimit bazë profesional me Atest Federal të Profesionit mund të kërkoni një punë ose të bëni një arsimim bazë me Certifikatën Federale të Aftësimit. Në kushte normale, ju filloni menjëherë në vitin e dytë të shkollimit profesional.

Arsimimi bazë profesional për Certifikatën Federale të Aftësimit

Arsimimi për Certifikatën Federale të Aftësimit zgjat 3 ose 4 vjet dhe ofron kompetenca të plota në më shumë se 200 profesione të licencuara. Për çdo vit në Zvicër më shumë se dy të tretat e të rinjve përfundojnë një arsimim të tillë, i cili njihet edhe si «mësim zanati» ose «shkollim profesional». Secili shkollim profesional shtron kërkesa të ndryshme në aftësitë praktike dhe kapacitetet shkollore.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2



ÇKA ËSHTË ARSIMIMI BAZË PROFESIONAL?

Arsimimi bazë profesional kombinon praktikën (në ndërmarrje të zanatit dhe në kurset në disa ndërmarrje) dhe teorinë (në shkollën profesionale speciale). Në të tri këto vende të mësimit, arsimtaret dhe arsimtarët profesionalë ndjekin të vetmin synim, t'ju hapin rrugën drejthyrjes në botën e punës, që aty të mundë të jeni të suksesshëm dhe të mundë të integroheshi në shoqëri. Ndonjëherë arsimimi bazë profesional gjithashtu mund të bëhet me orar të plotë nënjë shkollë profesionale, duke kombinuar atë me faza të përvojës praktike. Ky model, është veçanërisht i përhapur në pjesën franceze dhe italiane të Zvicrës (Shih edhe faqe 34).

Ndërmarrja e zanatit

Gjatë 3-4 ditëve në ndërmarrje, ju pajiseni me njohuri praktike të nevojshme profesionale dhe përmirësoni kompetencat metodologjike dhe sociale.

Kurset në disa ndërmarrje

Kurset në disa ndërmarrje, për disa ditë në vit, ju pajisin me teknikat dhe shkathtësitë themelore që ju nevojiten për profesionin tuaj.

Shkolla profesionale speciale

Shkolla profesionale speciale me 1 deri 2 ditë në javë, mësimin e arritur në praktikë e plotëson me njohuri të nevojshme teorike profesionale. Pjesa e lëndës profesionale ofron kompetencën e rëndësishme profesionale. Ligjërata të ngritjes së përgjithshme thëllon dy lëmenj mësimor: lënda «gjuha dhe komunikimi» krijon kompetenca verbale dhe jo verbale, kështu që ju, në rrethanat personale, profesionale dhe shoqërore jeni në gjendje të komunikoni kuptueshëm me të tjerët. Në lëndën «Shoqëria» keni të bëni mes tjerash me temat politike, ekologjike ose mjedisore, ligjore, shoqërore dhe kulturore.

Këshilla dhe sugjerime për prindër

Jepni vetes kohë. Sqaroni bashkë me vajzën dhe djalin tuaj, mundësisht në mënyrë precize, se për cilat fusha interesohen dhe kanë aftësi.

Shikoni fillimisht gjithë spektrin e fushës profesionale.

Kështu mund të gjeni profesione të cilat i përshtaten ngritjes shkollore të fëmijës tuaj.

Bisedoni me kohë me mësimdhënësin se si mund ta mbështesni më shumë vajzën ose djalin tuaj, që të përgatitet për gjërat që kërkohen në profesionin që ata e adhurojnë.



ÇFARË ARSIMIMI BAZË PROFESIONAL ME CERTIFIKATË FEDERALE TË AFTËSIMIT SILLNI JU?

Në secilën fushë profesionale gjeni profesione, që i përsh-taten interesimit dhe aftësive tuaja, dhe shtrojnë kërkesa të ndryshme të paraar-simit shkollor (të larta, të mesme dhe të ulëta).

Fushat teknike profesionale:

Ju pëlqejnë matematika dhe shkencat natyrore, mund të mendoni në mënyrë abstrakte dhe logjike, keni aftësi të parafytyrimit hapësinor dhe interesoheni për lidhshmëritë teknike.

Fushat profesionale tekniko-artizanale:

Ju jeni shumë të mirë në lëndët matematikë-varësisht nga profesioni-edhe në gjeometri. Përveç kësaj, keni aftësi parafytyrimi hapësinor dhe e doni punën me saktësi milimetrike.

Fushat profesionale artizanale (punëdore):

Ju pëlqen mate-matika, por mbi të gjitha keni duar të shkathëta lëvizni me kënaqësi dhe jeni fizikisht i aftë.

Fushat profesionale në lëmin e shërbimeve publike:

Ju interesoheni për të gjitha lëndët shkollore, edhe për matematikë. Para së gjithash, zotëroni shumë mirë gjuhën vendore të rajonit, keni dhunti për gjuhët e huaja, komu-nikoni me dëshirë dhe jeni elokuent.

Fushat profesionale në lëmin social dhe të shëndetësisë:

Ju komunikoni me dëshirë me njerëz të tjerë dhe lehtë i mësoni gjuhët. Për veç kësaj, i pëlqeni shkencat natyrore dhe e doni matematikën.

Fushat profesionale kreative:

Qoftë si floktar, dizajner ose luleshitës, ju keni një sy për gjëra të bukura, ju pëlqen të krijoni dhe keni duar të shkathëta. Vizatimet, punëdoret, por edhe gjeometria janë lëndët tuaja më të preferuara në shkollë.



NORINA BOSSHARD, ZVICËR

1. VITI I PARË

OXHAKTARE CERTIFIKATA FEDERALE E AFTËSIMIT

Pas punës provuese ishte e qartë: «Së pari më interesoi profesioni ekspertes së resaturimit. Gjatë punës provuese vërejtja që e kisha vështirë t'i qasesha mysafirëve. ...

Pas punës provuese m'u desh që t'ia filloja përsëri nga e para.

Për t'u bërë oxhaktare ishte propozim i nënës. Ajo bisedoi rastësisht me mjeshttrin tim. Ai ishte i mendimit se kjo ndoshta do të ishte diçka për mua. Unë bëra një javë punë provuese, dhashë testin e përshtatshmërisë dhe sigurova vendin për mësimin e zanatit. Tani, gjatë punës së përditshme, e shoh që puna në këtë profesion është e vështirë

fizikisht. Ndodh që në mbrëmje ta ndiej ngarkesën në shpinë ose në gjunjë. Para së gjithash, kur për orë të tëra gërryesh blazën në hapsirën e ngrohtores. Edhe shkolla profesionale speciale është më rëndë se sa e kam menduar unë.

Kimia dhe fizika për punën e përditshme

Tani, në vitin e 1-rë, ngarkesa kryesore është në kimi dhe në fizikë. Nuk janë lëndët e mia më të dashura, por të dyja më nevojiten nëpunën time të përditshme. Meqenëse në mbrëmje, në shumicën e rasteve, jam tepër e lodhur, më duhet edhe gjatë vikendit të mësoj për shkollën.

Për të ardhmen time profesionale mund të paramendoj shumëçka: Pas mbarimit të provimit përfundimtar, së pari dua të fitoj para, pastaj të udhëtoj, ndoshta të mësoj anglisht. Ose të bëj diçka krejt tjetër, një zanat të dytë ose ta bëj një sezonë në ndonjë hotel në terrenet e skijimit.»

Unë me çdo kusht dëshiroja të bëhesha nëpunëse: «Qysh në Kosovë kam dashur të punoj në një bankë. Unë vij nga një familje nëpunësish. ...

Nëna ime, kushërirat e mia, madje edhe vëllaiim, janë të interesuar për këtë drejtim profesional. Kur unë si 15 vjeçare erdha në Zvicër, të gjithë më thoshin, harroje këtë, kurrë nuk do t'ia dalësh, këtu duhet të kesh njohuri perfekte të gjuhës gjermane. Dhe unë mendova, së pari të mësoja një profesion tjetër, në të cilin duhen më pak njohuri të gjermanishtes dhe më vonë të ndryshoja profesionin. Unë pastaj bëra një praktikë tetëmuajore në një spital, por kjo thjesht nuk ishte puna e duhur për mua.

Pas kësaj praktike unë vendosa: të shkoj në shkollën për nëpunëse komerciale (KV), e për këtë më duhej gjuha gjermane dhe një gjuhë e huaj. Anglishtja nuk ishte problem për mua, prandaj e fillova një kurs intensiv të gjuhës gjermane.

Dosja e bukur e aplikacionit

Dhe unë kam pasur fat, sepse një mentor më ka përkrahur në procesin e aplikimit. Së pari kam kompletuar një dosje me letër ngjyrë kremi, një dosje shumë e bukur e aplikimit. Për çdo aplikim kam bërë një dosje të re dhe të gjitha dokumentet i kam shtypur të freskëta. Dhe pas rreth 20 aplikimeve jam ftuar për intervistën e parë. Ende më kujtohet mirë se sa kohë kam ushtruar me mentorin tim. Si të prezantohem? Si ta mbaj kontaktin me sy? Si mund të shkud dorën? Çfarë të them? Si mund ta them atë?

Për këtë intervistë ishin ftuar dhjetë të interesuar, pra një konkurrencë e madhe për katër vende për mësim të profesionit. Ata të gjithë kanë ndjekur shkollën në Zvicër dhe gjermanishtja ime nuk ishte ende e përsosur. Për këtë intervistë kam pasur vetëm motivimin tim, vullnetin tim, bindjen time se unë mund ta bëj këtë. Për të fituar vendin për mësimin e profesionit, unë është dashur t'i bind personat përgjegjës, që unë kam besim në vetveten se me sukses do ta bëj mësimin e profesionit të komercialistes.

Në profesionin e duhur

Tani unë jam në vitin e tretë dhe në profesionin e duhur. Në dy vjetët e fundit jam njoftuar me punët në Departamentin Presidencial (në repartin e personelit) dhe Departamentin e Shërbimeve Sociale (vendi i punës dhe shkollimi pranë Weid), këtë vit unë jam duke punuar në kontrollin financiar në administratën e qytetit të Cyrihut. Puna më pëlqen shumë, sidomos kjo përzierje e punës së pavarur dhe kontaktet me njerëzit e tjerë.

Edhe në shkollën profesionale speciale puna ecën mbarë. Megjithatë, një mbrëmje në javë unë ndjek mësimin mbështetës për nxënësit të cilët mësojnë profesionin (zanatin). Aty e bëj edhe një pjesë të detyrave të shtëpisë. Po të kem ndonjë pyetje, aty gjithmonë është i pranishëm një mësues, i cili do të mund të më ndihmojë. Dhe unë jam duke mësuar frëngjishten, sepse pas përfundimit të zantatit, kam dëshirë të bëj maturën profesionale dhe të studioj në një shkollë të lartë universitare.»

DAFINA ELMAZI, KOSOVË
VITI 3-TË I ZANATIT
NËPUNËSE E PROFILIT B





CELIA HALDIMANN, BRAZIL
VITI I 3-TË
PËRKUJDESJE SHTËPIAKE DSA

Aftësitë e vërteta për profesionin: «Unë jam komunikative dhe me kënaqësi punoj si e pavarur. ...»

Si eksperte e shëndetit punoj për Spitex-in dhe kontribuoj që të sëmurët ose njerëzit e moshuar të jetojnë edhe më tej në shtëpi. Unë përkujdesem për ta, u ndihmoj në punët e shtëpisë dhe i motivoj klientet dhe klientët që ta bëjnë jetën e tyre mundësisht sa më të pavarur.

Unë sjell me vete veçori të rëndësishme për këtë profesion: unë e kam të lehtë t'u qasem njerëzve dhe t'i marr ata seriozisht. Kështu u mundësoj klienteve dhe klientëve – ata janë shpesh të vetmuar dhe të mërzitur – ta ndiejnë afërsinë dhe ngrohtësinë, tregoj mirëkuptim për problemet e tyre dhe i dëgjoj me durim. Kjo pjesë e arsimit ishte e thjeshtë për mua, para se gjithash pasi kam mësuar të distan-

cohem. Edhe në fushën e shprehjeve profesionale mjekësore kam përparësi. Unë mund t'i gjej shprehjet adekuatë në gjuhën time amtare portugeze dhe kështu t'i mbaj mend. Gjuha gjermane është më e vështirë. Të folurit s'është aq problematik, me që komunikimi joverbal më ndihmon. Por shkrimi! Për punimet me shkrim harxhoj shumë kohë dhe kurrë nuk jam e kënaqur. Ka një vit që punoj me një mësues privat të gjermanishtes dhe e diskutoj me të çdo tekst, para se ta dorëzoj atë në shkollën profesionale.

Tani po përgatitem për provimin e diplomës. Për fat notat që i kam marr më parë janë të mira. Pas kësaj dua të bëj përvojë profesionale, t'i përmirësoj më tutje njohuritë e mia të gjermanishtes, para se të vazhdoj me arsimim të mëtejshëm. Unë s'jam akoma e sigurt se sido të vazhdoj më tutje: do të shkoj në ndonjë shkollë të lartë në fushën e përkujdesjes, ose do ta bëj maturën profesionale dhe të studioj në një shkollë të lartë profesionale.»



VËSHTRËSITË GJATË ARSIMIMIT BAZË PROFESIONAL

Kalimi nga shkolla fillore e detyrueshme në arsimin bazë profesional është gjithashtu një kalim drejt një pavarësimi më të madh. Jo vetëm në ndërmarrjen ku bëni zanatin, pritjet nga ju që të bashkë-mendoni në mënyrë aktive, por edhe në shkollën profesionale duhet të mësoni të punoni e pavarur. Ndoshta e përjetoni këtë kalim me vështirësi dhe e shihni se po krijohen probleme në ndërmarrje ose në shkollën profesionale. Në rast të tillë mundësisht kërkoni menjëherë një zgjidhje:

- Diskutoni problemet me mësuesin në shkollën profesionale dhe, eventualisht lajmërohuni për një kurs mbështetës ose për kurse shtesë të gjuhës.
- Bisedoni me mësuesin ose mësuesen e profesionit dhe kërkoni zgjidhje për vështirësitë eventuale në ndërmarrje.

Ndonjëherë problemet nuk mund të zgjidhen. Para se ta ndërpriti arsimin bazë profesional, patjetër duhet ta kontaktoni personin përgjegjës specialist në kanton – emri i tij është i shënuar në kontratën për zanatin. Shpesh mund të gjendet një zgjidhje – p.sh. kalimi në një ndërmarrje tjetër, ndryshimi i arsimit bazë profesional nga Certifikata Federale e Aftësisë në Atestin Federal të Profesionit ose anasjelltas.

Në rast se e ndërpriti arsimin bazë profesional, patjetër duhet t'i diskutoni hapat e ardhshëm me Këshillimorën Profesionale.

Patjetër një profesion me elektroteknikë: «Për mua gjithmonë ka qenë e qartë se do ta bëj një arsimim. ...»

Nëse jeton në Zvicër dhe nuk ke arsimim, atëherë profesionalisht ngec në vend. Tërë jetën bën të njëjtën punë. Por unë kam dashur një punë të mirë, përgjegjësi në punë, një karrierë dhe gjithmonë dua të mësoj edhe më tutje.

Asokohe profesioni im më i preferuar ka qenë informatika. Por, gjatë përcjelljes së kursit të integritimit, kur kërkoja vend për zanat, nuk kisha as një vit në Zvicër. Natyrisht që, për këtë arsye nuk kam arritur një rezultat të mirë në testin «Multicheck». Njohuritë e mia gjuhësore ishin ende të pamjaftueshme. Për këtë arsye vendosa të bëj një parashkollim si instalues

elektrik në një ndërmarrje të madhe dhe pastaj të vazhdoja me ngritjen time të mëtutjeshme. Kur e bëra provimin pranues për paramësim në shkollën profesionale speciale, rezultati im ishte aq i mirë, sa që vendosëm që drejtpërdrejt të bëja zanatin.

Vetiniativa dhe bashkëpunimi

Shkollimi profesional në një ndërmarrje të madhe kërkon shumë vetiniativë. Ndonjëherë unë mund të punoj me një montazher të mirë, atëherë përfitoj shumë.

Por ka edhe kurse në ndërmarrjet të tjera dhe shkolla profesionale. Në kurset në ndërmarrjet e tjera i mësoj të gjitha shkathtësitë themelore, të cilat më hyjnë në punë në profesionin tim, në shkollën profesionale speciale mësoj teori, sidomos fizikë, elektroteknikë dhe matematikë. Mësimi teorik i profesionit për mua është i i thjeshtë, sepse unë kam studiuar në Afganistan.

Megjithatë, unë në vitin e parë kam menduar të ndërpres mësimin e profesionit. Unë në atë kohë kam qenë 22-vjeçar, kurse kolegët e mi më të rinj se 18 vjeç. Unë kam pasur ndjenjën se isha në kopshtin e fëmijëve. Tani është më mirë. Sot kemi marrëdhënie të mira dhe unë i mbështes kolegët e mi edhe në mësim. Ne takohemi të shtunën dhe unë u shpjegoj atyre ndërlidhjet fizike, nëse nuk i kanë kuptuar ato si duhet në shkollë.

Të kuptoj saktësisht se si funksionon një gjenerator

Gjuha në arsimin e përgjithshëm shkollor ka qenë e vështirë, prandaj që në vitin e parë të zanatit vullnetarisht kam ndjekur mësimin mbështetës një mbrëmje në javë. Edhe partnerja ime gjithmonë më ka ndihmuar. Ajo i ka korrigjuar tekstet e mia, ose unë i kam ushtruar prezantimet e mia me të. Unë mësoj me kënaqësi dhe nuk e kam mërzi, nëse në mbrëmje për dy ose tri orë duhet të bëj detyrat e shtëpisë. Për shembull, në qoftë se në shkollën profesionale shpjegohet shkurtimisht një gjenerator, atëherë unë pas kthimit në shtëpi hulumtoj deri sa ta kuptoj saktësisht se si punon një gjenerator. Kjo vërtetë më pëlqen.

Për procesin e kualifikimit unë dua nota të mira paraprake, sepse unë që tani mendoj për një ngritje të mëtutjeshme. Inxhinier i elektroteknikës në një shkollë të lartë universitare, do të më pëlqente. Momentalisht ky është arsimimi im i preferuar.»

KHYBER AHMADZY, AFGANISTAN
VITI 4-TË I ZANATIT
ELEKTROINSTALUES



Profesioni i ëndrrave është shtyrë për më vonë: «Unë jetoj gati tre vjet në Zvicër. Që nga fillimi jam përpjekur të integrohem shpejt dhe mirë. ...

FARHAN ABDI OMAR, SOMALIA
VITI I PARË NË
BUKËPJEKËS-PASTIÇERI-KONFISERI



Jo vetëm që kam mësuar gjuhën këtu, por mora pjesë edhe në një teatër për migrantët dhe migrantet. Kënaqësi e madhe! Ne kemi pasur shfaqje teatrale në rrugë, por edhe në shtëpi pleqsh. Kam ndjerë kënaqësi kur kam parë njerëzit duke qeshur, si janë gëzuar. Më pëlqen kur i shoh njerëzit të lumtur, kur ata janë mirë.

Puna me ndërrime

Vitin e kaluar isha në kursin e integritimit. Aty jam përgatitur për zgjedhjen e profesionit. Kam shikuar profesione të ndryshme punëdore, kam bërë punë provuese si këpucëtar dhe sidomos ortopedia më ka fascinuar shumë. Për fat të keq në kantonin tonë nuk ka pasur vende të lira për mësim të profesionit.

Pastaj kam bërë një punë provuese si bukëpjekës-pastiçer-konfiser në një furrë të vogël. Ky profesion i përshtatet shumë mirë aftësive të mia dhe interesimit tim. Ky është një profesion në të cilin duart e shkathëta janë të rëndësishme dhe unë jam shumë i talentuar në punë praktike. Pastaj edhe më pëlqen shumë puna në ndërrime. Më pëlqen të punoj kryesisht natën dhe në mëngjes, mirëpo pasditen e kam të lirë. Kjo më përshtatet, sepse jashtë profesionit dua të vazhdoj shkollimin për aktor.

Të jetoj i pavarur dhe i sigurt

Unë me gjithë dëshirë do të punoja si aktor. Kam marrë pjesë në një audicion dhe jam përzgjedhur për të luajtur në një komedi. Kemi pasur shumë kënaqësi gjatë xhirimeve, kemi punuar, ngrënë dhe kemi qeshur së bashku. Por unë e di, si aktor nuk mund të fitoj të holla për çdo muaj.

Kjo është arsyeja pse mësoj një zanat. Pasi të kem mësuar profesionin bukëpjekës-pastiçer-konfiser, unë do të kem njohuri profesionale, e kjo më jep siguri gjatë kërkimit të punës. Unë mund të fitoj para dhe të jetoj i pavarur. Dhe unë mund të mbaj kokën lart, sepse kam arritur diçka. Për mua mësimi i zanatit është themeli për jetën time.»

Arsimimi bazë profesional me Maturë Profesionale

Ju mund ta kombinoni arsimimin bazë profesional me Certifikat Federale të Aftësimit me maturën profesionale. Shkolla e maturës profesionale, ju ofron një arsimim të gjithanshëm të avancuar dhe ju hap mundësinë për të studiuar në njëshkollë të lartë universitare, – varësisht prej drejtimit – pa provime ose me procedurën e pranimit.



ÇKA ËSHTË MATURA PROFESIONALE?

Gjatë arsimimit bazë profesional, ju ndiqni një ditë shtesë në shkollën e maturës profesionale, domethënë ju punoni një ditë më pak në ndërmarrje. Pas përfundimit të suksesshëm të shkollës së maturës profesionale, ju posedoni Certifikatën Federale të Maturës Profesionale. Certifikata Federale e Aftësimit si dhe matura profesionale ju mundësojnë përfshirjen në forma të mëtejme të arsimimit.

Pas kalimit të provimit të diplomës dhe të maturës profesionale, varësisht nga drejtimi i studimeve, pa provim pranues ose përmes procedurës pranuese, ju mund të studioni në një shkollë të lartë universitare, që i përshtatet arsimimit tuaj bazë.

Matura profesionale ju mundëson po ashtu studimet në një universitet: «Passerelle» ju përgatitë për provime shtesë, të cilat kërkohen për studime.

ÇFARË SHKOLLETË MATURËS PROFESIONALE SILLNI JU?

Ju jeni një nxënës ose një nxënës i mirë dhe vendosni të bëni arsimimin bazë profesional me maturë profesionale. Ky kombinim kërkon që ju të jeni të gatshëm të mësoni, dhe që gjatë arsimimit bazë profesional të punoni shumë dhe të bëni me orë të tëra gjatë javës detyrat e shtëpisë. Përveç kësaj, edhe ndërmarrja ku mësoni zanatin duhet të pajtohet me këtë.

Ju e zgjidhni profilin e përshtatshëm për profesionin tuaj dhe bisedoni me mësuesin për përgjegjësitë të zanatit në ndërmarrje që ju doni të vizitoni shkollën e maturës profesionale.

Ekzistojnë këto drejtime të maturës profesionale:

- Teknikë, arkitekturë, shkencat shoqërore
- Natyra, hapësira dhe gjërat ushqimore
- Ekonomi dhe shërbime
- Krijimtari dhe art
- Shëndetësi dhe çështje sociale

Procesi i pranimit nuk është i rregulluar njëjtë në çdo kanton. Në disa kantone mjafton një mesatare e caktuar e notave dhe rekomandimi i mësuesit të nivelit Sekondar I.

Në kantonet e tjera ju duhet të kaloni një provim pranues në shkollën e maturës profesionale. Testohet programi mësimor i nivelit më të lartë shkollor në matematikë dhe për gjuhët.

Këshilla dhe sugjerime për prindër

Bisedoni me kohë – qysh në nivelin e dytë të epërm – me mësuesin nëse shkolla e maturës profesionale është e përshtatshme për vajzën ose djalin tuaj.

Vizitoni së bashku tubimet orientuese të shkollave me maturë profesionale në kantonin tuaj.

Nëse djali ose vajza juaj aplikon për vende të hapura për mësim të profesionit, interesimi për shkollat me maturë profesionale duhet përmendur gjithsesi. Përgjegjësit në ndërmarrjet e zanatit, duhet të pajtohen me një ditë shkolle shtesë.

Në faqet e internetit të enteve për arsimim profesional (shih adresat në: www.adressen.sdbb.ch) në kantonet e ndryshme janë të publikuara provimet pranuese të viteve të fundit.



PREETHY VADAKKADATH, INDI
VITI I 4-TË I ZANATIT
AUTOMATIKE ME MATURË PROFESIONALE

Lidhja ideale e teorisë me praktikën: «Unë kam bërë në Indi një maturë teknike dhe kam ardhur në Zvicër në moshën 18-vjeçare. ...»

Kam zgjedhur një profesion në të cilin do të mund t'i përdorja njohuritë e fituara më herët. Përmes zanatit bazë dëshiroja të lidhja teorinë me praktikën dhe t'i kombinoja arsimimin me maturën profesionale. Mësova intensivisht frëngjisht dhe dhashë provimin pranues.

Në javën e parë të zanatit shkua në ekskursion. Ne ishim 58 meshkuj dhe 2 gra. Ky ishte një shok për mua. Veç kësaj unë atëherë isha 19-vjeçare. Në fillim isha shpesh e mërzitshme. Tani nuk është më problem, kolegët e mi janë rritur një çikë dhe bashkëpunimi

me ta është shumë i mirë. Ne e mbështesim njëri-tjetrin. Sa i përket matematikës dhe teknikës, mësimi nuk është problem, sepse më mjaftojnë njohuritë nga gjimnazi. Unë koncentrohem te lëndët e tjera. Kurset mbështetëse të gjermanishtes dhe frëngjishtes më kanë ndihmuar shumë. Gjermanishtja nuk është fare e lehtë, sepse shprehjet profesionale të përdorura në libra dhe shprehjet profesionale në punishte ndryshojnë: Për shembull diçka që në libër emërohet si «Motorschutz-relais» në punishte quhet «Thermoblock». Edhe në punishte kam mësuar shumë dhe jam një punonjëse e talentuar. Mirëpo, si automatike jo vetëm që programoj por edhe i zbatoj projektet në praktikë.

Pas diplomimit do të punoj një vit dhe do të fitoj para. Unë e kam një vend pune. Pastaj dua të studioj në shkollën e lartë universitare, po qe e mundshme krahas punës. P.sh. krijimtarinë ose vizualizimin teknik. Kështu do të mund të lidhja profesionin dhe hobin, sepse unë vizatoj dhe pikturoj në kohën time të lirë.»



MATURA PROFESIONALE PAS ZANATIT

Ju mund të përqendroheni së pari në arsimimin bazë profesional dhe pas diplomimit të bëni maturën profesionale (Matura Profesionale 2). Qoftë krahas punës ose në një shkollë me orar të plotë (1 vit), për maturën profesionale 2 po ashtu kërkohet një provim pranues dhe një bisedë shtesë. Në shumicën e shkollave të maturës profesionale ka kurse përgatitore për provimin pranues.

Natyrisht, së pari mund të punoni për të fituar përvojë profesionale dhe vetëm më vonë të vendosni për të bërë shkollën e maturës profesionale 2.

Jo në gjimnaz: «Në vitin e 3-të të nivelit sekondar, i kam mbajtur të gjitha opsionet të hapura. Në të njëjtën javë kam kaluar provimin pranues për në gjimnaz dhe për shkollën e maturës profesionale. ...

Unë kam qenë i sigurt se me dëshirë kam preferuar zanatin elektronikës me shkollë të mesme profesionale, mirëpo në një ndërmarrje zanati. Për fat të mirë, gjithçka ka shkuar sipas planit, jam pranuar në zanat dhe me këtë kam marrë edhe një arsimim bazë shumë të mirë.

Shkolla profesionale speciale nuk ishte shumë e vështirë, sepse unë kisha interesim në profesion. Në ndërmarrje nuk kam mësuar vetëm për përditshmërinë profesionale – ndryshe nga shkolla – ne ishim disa nxënës, kishim mbështetjen nga profesorët dhe nxitim dhe

përkrahim njëritjetrit. Ne diskutim shumë mes vete, këmbënim përvojat, realizim projektet tona, shpesh duke punuar më gjatë se kemi qenë të obliguar. Ky ishte një mjedis pune interesant me kolege dhe kolegë të interesuar, një fillim perfekt në botën e punës.

Pas zanatit erdhi ushtria dhe studimet në Shkollën e Lartë Universitare. Këtë të fundit nuk e kam përfunduar, sepse më mungonin pak pikë, ndoshta për shkak se kam bërë tepër kurse përsëritëse në ushtri, ndoshta edhe për shkak se arsimimi bazë profesionale më është dukur i lehtë dhe me vonesë kam realizuar se është dashur të mësoj më shumë. Sot kjo nuk më pengon. Unë nuk kam diplomë, mirëpo kam njohuri të dobishme themelore.

Rruga për udhëheqës teknik

Një koleg i mirë themeloi një ndërmarrje të vogël, dhe synonte të ofronte zgjidhje informatike dhe kështu kam filluar të punoj për të. Ne nuk kishim ide nëse kjo ndërmarrje do të funksiononte, por kishim një plan emergjence: Në qoftë se ndërmarrja e themeluar do të dështonte, ne do të punësoheshim nga ndonjë bankë dhe do të fitonim shumë të holla, mendonim ne.


Por kjo nuk ishte e nevojshme, sepse ne u vendosëm me zyre në një godinë dhe si fqinjë kishim një agjenci për reklama, e cila kërkonte informaticientë. Pra, të dy kompanitë u shkrinë dhe unë u bëra drejtor teknik. Qe katër vjet unë jam përgjegjës për funksionimin teknik të faqeve të internetit të zhvilluara nga ne, bëj zhvillimin e zgjidhjeve të reja, ushroj dhe mbështes bashkëpunëtorët ose praktikantët dhe praktikantët.

Referenca nga përditshmëria profesionale në studime

Me korrespondencë kam studiuar dhe përfunduar Informatikën në Shkollën e Lartë Universitare me Bachelor. Edhe ky ka qenë një studim shumë interesant. Gjatë këtij studimi kamë thëlluar njohuritë e mia teorike, por pothuajse më shumë kam përfituar nga përvojat e përditshme, të cilat kanë rezultuar nga diskutimet me ekspertë dhe eksperte, sepse këta kolegë dhe kolege vinin nga fusha më të ndryshme profesionale të informatikës.

Në vitet e fundit kam pasur fat të madh, për të punuar me shumë kolege dhe kolegë të interesuar. Unë gjithmonë kamë bërë atë që më ka pëlqyer. Nëse jam i kënaqur në një punë, nëse kam mundësi të shkëmbej idetë me të tjerët, në qoftë se ne në mënyrë reciproke i bëjmë një vlerësim kritik punës tonë, atëherë unë mund të arrij shumë në informatikë.»

MARC EGLI, ZVICËR
ELEKTRONIST ME CERTIFIKATË FEDERALE TË AFTËSIMIT
ME MATURË PROFESIONALE
INFORMATICIENT, SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE



Në profesione të caktuara është e mundur që arsimimi bazë profesional, e me këtë edhe Certifikata Federale e Aftësisë, të fitohen edhe përmes shkollimit me orar të plotë. Në Zvicrën franceze dhe atë italiane kjo formë e arsimimit profesional është më e përhapur se në Zvicrën gjermane.



FLETËPALOSJA NË
INTERNET
shih faqe 2

Arsimimi bazë i organizuar në mënyrë shkollore

Në këtë rast kemi të bëjmë me oferta publike, mirëpo ka edhe shkolla private. Në ofertat e shkollimit me orar të plotë, aftësitë praktike fitohen në praktikën e ofruar në shkollë apo në praktikën e kryer në ndërmarrje.

Oferta të tilla nuk ka për të gjithë, por ka për profesione të ndryshme. Nuk janë të rralla arsimimet në fushën e komerciale (Shkollat e mesme tregtare), mirëpo ekzistojnë për shembull edhe shkolla me orar të plotë në fushat e artit, fotografisë, shëndetit, teknikës apo edhe në gastronomi. Në disa raste arsimimi bëhet – me ose pa kombinim të maturës profesionale – edhe në shkollat e mesme speciale (krahaso po ashtu faqe 40). Në Zvicrën gjermane shkollat e mesme për informatikë luajnë rol me rëndësi.

Shumë nga këto oferta janë të organizuara në baza rajonale apo kantonale dhe vënë kushte të veçanta për pranim (provime pranuese, dosjet e kandidatëve, kurset përgatitore, nota minimale në lëndë të caktuara). Absolventet dhe absolventët, që ndjekin këtë lloj arsimimi shkollor, shpeshherë kanë orare të ngjashme mësimi dhe pushime sikurse gjimnazistët/et dhe nxënësit/et e shkollave të mesme speciale. Për dallim nga nxënësit në arsimimin bazë profesional, zakonisht këta nuk marrin pagë shëgertësh.

Këshilla dhe sugjerime për prindër

Arsimimet bazë profesionale sikurse edhe shkollat e mesme profesionale shpesh në një diplomë të njëjtë: Certifikata Federale e Aftësisë (me ose pa maturë profesionale). Diskutoni me djalën,

vajzën tuaj, nëse ai ose ajo është i/e interesuar të vazhdojë shkollimin, ose preferon mësimin e zanatit në ndonjë ndërmarrje.

Shkollat e mesme profesionale ofrohen nga institucionet arsimore publike dhe private. Sqarohuni në rajonin tuaj, cilat oferta ekzistojnë për shkollat e

mesme profesionale dhe pyesni nëse shpenzimet eventuale të shkollimit duhet t'i bartni vetë.

Kini kujdes, sepse në disa nga shkollat e mesme profesionale ka kufizime në moshë.

Hyrja shkollore në informatikë: «Në moshën 16-vjeçare fillova gjimnazin, mirëpo gjatë vitit të parë vëreja se kjo nuk ishte ajo e duhura për mua. ...

Mësimi ishte pak i thatë, shkencat natyrore më mërznin. Prandaj unë kërkova një alternativë ndaj gjimnazit, diçka që më interesonte mua. Fatmirësisht, drejtorja e shkollës më informoi për Shkollën e Mesme të Informatikës në të njëjtën shkollë. Kalimi nga gjimnazi në Shkollën e Mesme të Informatikës ishte perfekt për mua, tani më interesonte lënda mësimore.

Në Shkollën e Mesme të Informatikës unë kisha mundësi të përgatitesha për të marrë Certifikatën Federale të Aftësisht, drejtimi zhvillimi i aplikacioneve, dhe të kombinoj këtë aftësim me maturën profesionale për ekonomi dhe ofrimin e i shërbimeve. Pas tre vjetëve të para të shkollimit të plotë – i ndërprerë vetëm për shkak të praktikës

trijavore – përmbylla lëndët shkollore me provime, për të vazhduar në vitin e katërt me një praktikë për përvojë pune. Shkolla e Mesme e Informatikës na dha një listë të ndërmarrjeve dhe unë shpejt gjeta një vend për mbajtjen e praktikës.

Dizajnimi i faqeve të internetit në kohë të lirë

Por puna në këtë ndërmarrje nuk më ka pëlqyer shumë. Unë nuk u bazova vetëm në listën të cilën na kishte dhënë shkolla, por kërkova kokë më vete edhe më tutje. I shkrova edhe 10 aplikacione dhe gjeta një vend për praktikë në një agjenci interneti në Cyrih. Këtë vend për praktikë me siguri e fitova edhe për arsye se gjatë shkollimit në Shkollën e Mesme të Informatikës, në kohën e lirë, kam dizajnuar dhe programuar faqe të internetit. Çdo ditë nga Bazeli në Cyrih, tri orë rrugë! Por për mua kjo ia vllente, sepse në këtë agjenci interneti kammësuar pikërisht ato gjëra që më interesonin.

Gjatë këtij viti po ashtu i kam njohur më mirë preferencat e mia, gjë që më ka hapur udhën drejt hapit të ri në karrierën time, studimin Bachelor në iCompetence në Shkollën e Lartë Universitare, e cila bën lidhjen optimale midis informatikës, dizajnit dhe menaxhmentit.

Mungesat në matematikë

Viti i parë i studimeve ishte shumë interesant, por rraskapitës. Meqenëse kisha përfunduar një maturë profesionale në degën e nëpunësisë, kam pasur mangësi në matematikë. Krahasuar me koleget dhe kolegët e mi studentë, të cilët kishin kombinuar profesionin e informatikës me maturë profesionale teknike, kjo lëndë më ka kushtuar dyfishin e kohës. Mirëpo, në anën tjetër, unë kisha përparësi në lëmenjtë e tjerë, pasi që Shkolla e Mesme e Informatikës i ka kushtuar rëndësi të madhe një edukimi të themeltë të përgjithshëm.

Pesë vjet më parë, kur fillova Shkollën e Mesme të Informatikës, nuk kam mundur të imagjinoj karrierën time profesionale. Tani jam duke i zhvilluar dhe thelluar interesimet e mia dhe jam i sigurt se gjatë studimeve për Bachelor, do të mund të zbuloj shumë gjëra në lidhje me karrierën time të ardhshme profesionale.»

MARIUS KÜNG, ZVICËR
SHKOLLA E MESME E INFORMATIKËS BAZEL
STUDIME NË ICOMPETENCE
(INFORMATIKË, DIZAJN DHE MENAXHIM)
SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE



*Shkolla e Mesme
Komeriale si hyrje
në jetën profesionale:
«Për mua, vizita e Shkollës
Komeriale në Neuenburg,
është dëshmuar si një bazë
solide. ...*

Jam regjistruar atje pas nivelit Sekondar, nga njëra anë, sepse kisha dëshirë t'i përsosja njohuritë e mia të gjuhës frënge dhe, në anën tjetër të kisha kohë të mjaftueshme për aktivitetet e mia sportive dhe ndërmarrëse.

Filloi në një garazh

Pas diplomës komerciale – një maturë profesionale nuk ka ekzistuar në atë kohë – kam filluar relativisht herët me ndërtimin e biznesit tim: si çiklist malor elitare dhe snouboarder i pasionuar, kam pasur lidhje të mira në botën e sportit. Kështu m'u dha mundësia për të ndërtuar një rrjet shpërndarës të pajisjeve të sportit dimëror. Ashtu si në rastin e shumë ndërmarrësve të rinj, gjithçka filloi në garazhin e prindërve të mi.

Pas tetë vjetësh si afarist i pavarur, në sektorin e sportit dhe kohës së lirë, kam mbaruar Shkollën e Lartë Profesionale të turizmit në Samedan dhe arsimimin si ekspert i diplomuar i turizmit me Diplomë Federale Profesionale në Lucern. Të bësh marketing të qëndrueshëm në hapësirën madhështore të Zvicrës, më nxiti dhe motivon edhe sot. Se isha i vetmi në klasë, që menjëherë pas shkollimit ka gjetur drejtpërsëdrejti një vend udhëheqës, ia di për nder, para së gjithash, përvojës sime të deriathershme profesionale.

Prej bujkut malësor deri te përfaqësuesi i shoqatës

Prej 2007 deri në 2011, kam udhëhequr Emmental Tours AG, një degë e BLS AG (Ndërmarrje rajonale hekurudhore). Që nga viti 2011 jam drejtor i turizmit Thun-Thunersee (liqeni i Thun-it), që nga viti 2013 udhëheq po ashtu edhe menaxhimin e produktit të Interlaken-Tourismus.

Mua më pëlqen shumanshmëria e profesionit tim: në të njëjtën ditë unë shpesh takohem me njerëz të ndryshëm, nga fermerët malësorë për temën «fjetja në kashtë», e deri te përfaqësuesit e shoqatave me kostume biznesi. Në turizëm i kushtoj rëndësi cilësisë së lartë të ofertave dhe i mbështes idetë e reja. Kulminacioni i angazhimit ishte padyshim rekordi botëror me artistin Fredy Nock, me ç'rast kemi shtrirë një kablo tre kilometra të gjatë mbi liqenin e Thunit.»

MICHAEL ROSCHI, ZVICËR
SHKOLLA E MESME KOMERCIALE
EKSPERT I TURIZMIT ME DIPLOMË FEDERALE






SHKOLLAT E MESME KOMERCIALE

Shkolla e mesme komerciale zgjatë 3 vjet deri te Certifikata Federale e Aftësimit për komercialiste ose komercialist. Nëse doni si shtesë edhe maturën profesionale komerciale, atëherë e ndiqni shkollën e mesme komerciale 4 vjet.

Krahasuar me arsimimin bazë profesional, shkolla e mesme komerciale si prioritet më të lartë e vlerëson arsimimin epërgjithshëm dhe integron praktikën në mësimin e rregullt. Praktikrat shtesë në ndërmarrje thellojnë njohuritë themelore praktike.



ISABEL SILVA, PORTUGALI
VITI I 3-TË, SHKOLLA E MESME KOMERCIALE

*Arsimimi i mirë
i përgjithshëm, nisje e
mirë: «Unë jam përcaktuar
për Shkollën e Mesme
Komerciale, sepse nuk e kam
ditur se çka dëshiroj të. ...*

Meqenëse edhe motra ime e ka bërë Shkollën e Mesme Komerciale, jam paraqitur për provim pranues që në nivelin e 2-të Sekondar. Pas tri vitesh e kam përfunduar Shkollën e Mesme Komerciale me Certifikatën Federale të Aftësimit. Pas një viti praktik dhe një punimi me shkrim, në vitin e 4-t kam bërë maturën profesionale.

Unë bëj një arsimim të themeltë. Para së gjithash, në gjuhë: në frëngjisht, diploma e gjuhës DELF (Diplôme d'Etudes de Langue

Française) është e obligueshme, në anglisht kam bërë First Certificate dhe kam qenë përnjë praktikë njëmuje në Vancouver; në këtë kohë kam «jetuar» anglisht. Kërkimi i praktikës njëmuje ka qenë i vështirë. Unë kam shkruar 35 aplikime. Një pjesë e ndërmarrjeve madje nuk më ka kthyer fare përgjigje. Megjithatë ia kam dalë dhe jam e lumtur që praktikën njëvjeçare mund ta bëj në të njëjtën ndërmarrje.

Unë jam e përgatitur mirë për jetën e punës. Natyrisht, shumë thonë se, në krahasim me gjimnazin, shkolla e mesme komerciale është e thjeshtë. Nuk mund të krahasohen këto dy rrugë të ndryshme të arsimit: Me gjimnaz unë përgatitem për universitet – unë këtë nuk e kam dashur – me Shkollën e Mesme Komerciale specializohem për një profesion. Pas arsimimit dua të punoj dhe, krahas punës, të vijoj shkollën e lartë universitare dhe me këtë ta lidh në mënyrë optimale teorinë me praktikën.»

Kalimi nga niveli Sekondar I në një shkollë të arsimit të përgjithshëm, është më i hapur në raport me veprimtarinë profesionale në të ardhmen. Një arsimim i thelluar në profile të ndryshme në shkollë të mesme speciale, përgatitë për arsimime më të larta në fusha të caktuara profesionale. Gjimnazi zakonisht shpie në studime në universitete, ETH/EPF, shkolla të larta universitare ose shkolla të larta pedagogjike; mirëpo, profesioni i synuar mund të definohet gjatë periudhës së arsimimit. Shkollat e mesme speciale dhe shkollat e mesme u rekomandohen të gjithë atyre që shkojnë në shkollë me kënaqësi.

Ky kapitull u dedikohet të rinjve dhe të rejave të huaja me rezultate të mira në shkollë (dhe prindërve të tyre), të cilët janë në prag të përfundimit të shkollimit të tyre të detyrueshëm në nivelin Sekondar I dhe para kalimit në një shkollë të arsimit të përgjithshëm. Informon për kushtet që ua shtron atyre një karrierë arsimore, si dhe për alternativat e mundshme të studimeve.

Zgjerimi dhe thellimi i arsimimit të përgjithshëm

Nga niveli sekondar I në gjimnaz ose në shkollë të mesme speciale

Faqe

- 40 **Shkolla e Mesme Speciale dhe Matura Speciale**
- 41 *Laura Vogelsang, Zvicër, Shkolla e Mesme Speciale,
studime për inxheniere të mjedisit në Shkollën e Lartë Universitare
«Unë isha e pavendosur»*
- 42 **Gjimnazi**
- 43 *Ouwen Xu, Kinë, Gjimnaz
«Fatmirësisht unë dua atë që dua prindërit e mi»*
- 45 *Selina Valdivia, Zvicër dhe Kubë
«Mësimi për mua është i lehtë»*
- 46 *Priska Krieg, Zvicër, nëpunëse
«Gjimnazi nuk ka qenë drejtimi i duhur»*

Shkollat e mesme speciale thellojnë arsimimin e përgjithshëm, forcojnë kompetencat personale dhe sociale dhe përgatisin zakonisht për arsimim në fushat e shëndetësisë, sociale ose edukimit. Lëndët mësimore gjithashtu ofrojnë një bazë të mirë për karrierë në profesione si gazetari, komunikim dhe informacion, krijimtari dhe art, muzikë dhe teatër si dhe në sport.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2

Këshilla dhe sugjerime për prindër

Informohuni në Qendrën Informative për Profesionet, se cilat shkolla të mesme speciale me cilat profile ofrohen në kantonin tuaj.

Vizitoni tubimet orientuese të shkollave përkatëse dhe informohuni për kushtet e pranimit. Informacione të tjera në lidhje me shkollat e mesme speciale gjeni në Internet.

Shkolla e Mesme Speciale dhe Matura Speciale



ÇKA ËSHTË SHKOLLA E MESME SPECIALE?

Shkolla e mesme speciale kombinon arsimimin e përgjithshëm dhe mësimin e ndërlidhur me profesionin. Pas vitit themeltar, e nganjëherë edhe në fillim të arsimimit, ju vendosni për një fushë të profesionit. Jo të gjitha shkollat e mesme speciale ofrojnë të gjitha fushat profesionale. Shkolla e mesme speciale përbën një bazë të mirë për arsimimin në shkolla të larta profesionale dhe në shkollat e larta universitare në fushat si në vijim:

Shëndetësi

Përkujdesje, fizioterapi, ergoterapi, analiza mjekësore biologjike, radiologji tekniko-mjekësore, teknika e operacioneve, ndihma për lindje (obstetrikë).

Punë Sociale

Punë sociale, pedagogji sociale, animim sociokulturor

Pedagogji

Profesione mësimdhënëse në parashkollorë / çerdhe, arsimin bazë dhe atë primar, sport dhe aktivitet fizik.

Komunikimi dhe Informacioni

Profesionet e mediave, gazetari, biblioteka, turizmi dhe hoteleria, përkthimet me shkrim dhe gojë.

Krijimtari dhe art si dhe muzikë dhe teatër

Profesionet mësimdhënëse për krijimtari ose muzikë, muzikant, artist, valltar

Psikologji aplikative

Profesione terapeutike dhe këshilluese në fushën e psikologjisë dhe këshillimit jetësor

SHKOLLAT E MESME PROFESIONALE KANË NDËRTIM DYSHKALLËSH


Tri vjetët e para shkollorë i përfundoni me certifikatën e shkollës së mesme speciale. Me këtë diplomë mund të studioni në shkollat e larta profesionale të fushave gjegjëse, megjithëse në të shumtën e rasteve duhet t'i plotësoni edhe disa kushte për praninë (sqarimin mbi përshtatshmërinë, praktikën, përndryshe informohuni në shkollën përkatëse.)

Me një vit shtesë mund të fitoni maturën speciale. Ju duhet të bëni një praktikë shumëmuajshe (3 deri në 9 muaj) në fushën e zgjedhur profesionale dhe shkruani një punim të maturës speciale, në të cilin pasqyroni praktikën e bërë. Matura speciale do të paraqitet në një provim ku do të shtrohen pyetje. Matura speciale ju jep të drejtën të studioni në shkolla të larta profesionale dhe shkollat e larta universitare në fushat përkatëse.

Edhe në shkollat e larta universitare shpeshherë ka kritere shtesë të pranimit (midis tjerash sqarimin mbi përshtatshmërinë, praktikën). Sqarohuni për këtë në institucionin arsimor përkatës.

SHKOLLA E MESME SPECIALE RREGULLOHET NGAKANTONET

Arsimimin në shkollat e mesme speciale e rregullojnë kantonet. Zakonisht, ky arsimim vazhdon pa ndërprerje pas shkollimit të obligueshëm; sidoqoftë, për pranim në shkollën e mesme speciale ekziston një kufizim në moshë. Kushtet e pranimit janë të ndryshme: varësisht nga kantoni, hyrja në shkollën e mesme speciale është pa provime, ose provimin pranues e bëjnë të gjithë ose vetëm ata të cilët nuk e kanë arritur një notë mesatare të caktuar.



LAURA VOGELSANG, ZVICËR
SHKOLLA E MESME SPECIALE, INXHINIERE
E MJEDISIT SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE

«Unë isha e pavendosur: Meqenëse nuk mund të vendosja për një profesion, bëra shkollën e mesme speciale. ...»

Unë kam bërë praktikë provuese në gastronomi dhe në fushën sociale. Por, në të vërtetë nuk më bindi asnjë profesion. Në klasën e 10-të m'u kthye vullneti për të mësuar dhe vendosa për shkollën e mesme speciale, dega për punë sociale. Pas tre vjetësh në shkollën e mesme speciale, pasi bëra praktikën në një ent për njerëz me aftësi të kufizuara dhe punimin me shkrim si dhe prezantimin e punimit, mbarova maturën speciale. Atë kohë unë doja të studioja pedagogji sociale, prandaj qëndrova edhe rreth një vit në Emmental. Mirëpo, pikërisht kur unë fitova vendin për mësimin e zanatit në të njëjtin ent dhe duhej të lajmërohesha për procedurën e pranimit në shkollën e lartë universitare, e ndieja se nuk mund ta paramendoja që unë edhe 5 vjet tjetër të mbetesh në Emmental. Vendosa të

bëja një pushim. U lajmërova te Organizata Ndërkombëtare e Fermave Organike (World Wide Opportunities on Organic Farms – WWOOF). Një vit jetova dhe punova në Spanjë, vetëm për banim dhe ushqim, në pesë ferma të ndryshme të cilat prodhonin perime organike. Kjo punë vullnetare ndryshoi interesat e mia profesionale. U largova nga pedagogjia sociale dhe u orientova për mjedisin. Qysh saisha në Spanjë, kam filluar të informohem në lidhje me mundësitë e shkollimit në këtë degë dhe vendosa të studioja si inxhinierë e mjedisit në shkollën e lartë universitare.

Shkolla e mesme speciale, drejtimi i punës sociale, ndoshta nuk është parakusht ideal për këtë studim. Mangësitë në shkencat natyrore, sidomos në kimi dhe biologji, është dashur t'i tejkaloj disa mangësi duke mësuar më shumë në fillim të studimeve. Krahasuar me kolegët dhe kolegët e studimeve, të cilët kishin mbaruar zanatin ose maturën speciale dhe ishin përgatitur për këtë studim, unë është dashur të përkushtohem më shumë, duke investuar kohë për t'i arritur njohuritë bazë në këtë drejtim. Por ia dola, sidomos pasi vitin e parë e ndava brenda dy vjetëve.»

Gjimnazi

Gjimnazet ofrojnë një arsimim të thellë dhe të zgjeruar të përgjithshëm, por nuk ofrojnë arsimim special ose profesional. Gjimnazin e përfundoni me maturën e gjimnazit. Kjo certifikatë ju jep të drejtën për të studiuar në universitete.

 FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2



ÇKA ËSHTË GJIMNAZI?

Në gjimnaz ju i përcillni një numër të lëndëve kryesore të detyrueshme. Kësaj i shtohet edhe një lëndë kryesore dhe një lëndë shtesë. Me zgjedhjen e lëndës kryesore, ju vendosni deri diku edhe për një profil, d.m.th. ju e përcaktoni drejtimin tuaj gjatë shkollimit në gjimnaz dhe eventualisht edhe për më vonë në studime, ku e shihni interesimin tuaj kryesor për studime. Profilet që ju hasni shpesh, sidomos në Zvicrën gjermanofolëse, janë:

Profili i gjuhëve të lashta

(përfshirë latinisht dhe/ose greqisht; lëndë kryesore është një gjuhë),

Profili i gjuhëve të reja

(përmban vetëm gjuhët moderne; lëndë kryesore është një gjuhë),

Profili i shkencave natyrore-matematikore

(lëndë kryesore janë biologjia dhe kimia ose fizika dhe aplikimet e matematikës)

Profili ekonomiko-juridik

(lëndë kryesore janë ekonomia dhe drejtësia)

Profili muzikor

(lëndë kryesore janë dizajni artistik ose muzika)

Jo në të gjitha gjimnazet ofrohen të gjitha profilet, por edhe nuk punohet me këto profile në të gjitha kantonet. Zgjedhja e një profili lë edhe më tutje të hapur të gjitha drejtimet e studimeve, dhe shërben vetëm si orientim për karrierën e ardhshme arsimore.

ME MATURË NË SHKOLLË TË LARTË

Gjimnazin e përfundoni – varësisht nga kantoni – pas tre deri në pesë vjet, me një punim të pavarur të maturës si dhe një provim me gojë dhe me shkrim. Pas përfundimit me sukses ju do të merrni një certifikatë të maturës, e cila konsiderohet si dëshmi pjekurie për shkollim të lartë dhe hap rrugë të ndryshme të arsimimit:

- Studimet në universitetet kantonale ose shkollat e larta pedagogjike
- Studimet në Shkollën e Lartë Federale Teknikë ETH / EPF
- Mundësimi i dhënies së provimeve pranuese për degët e mjekësisë nëse doni të bëheni mjek/e, dentist/e ose veterinar/e (në disa shkolla të larta të Zvicrës franceze është i mundshëm studimi i mjekësisë pa provim pranues)
- Studimet në shkollat e larta universitare pas një praktike profesionale së paku njëvjeçare
- Qasja në zanate.



OUWEN XU, KINË
GJIMNAZ, MATEMATIKË
DHE SHKENCA NATYRORE

«Fatmirësisht unë dua atë që duan prindërit e mi: Rruga e shkollimit tim nuk ishte lineare: Së pari kam shkuar në Kinë në shkollë, pastaj një vit në Gjermani, pastaj përsëri në Kinë dhe që 5 vjet në Zvicër. ...

Këtu kam filluar mësimin në një klasë të vogël, pasgjysmë viti kam kaluar në Sek A dhe në të njëjtin vit kam dhënë provimin pranues për gjimnaz.

Në fillim kam qenë i tërhequr, sepse më mungonte gjermanishtja. Me zgjerimin e njohurive të gjermanishtes më është rritur edhe vetëbesimi. Nuk është e rëndësishme se a e flas gjermanishten e shkruar ose dialektin, e rëndësishme është që tësinjalizoj hapje dhe interesim, kështu unë vë kontakte në të dy gjuhët. Në kuptimin e të mësuarit gjimnazi është diçka që bëhet.

Lëndët matematikore më duken të lehta, kështu që mund të koncentrohem për lëndët gjuhësore si gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht. Krahas tyre, rregullisht mësoj me nënën time kinezisht. Unë nuk dua ta lë mbrapa gjuhën e vendlindjes, sepse në shtëpi flasim një dialekt të Shanghait.

«Edhe unë dua një arsimim të mirë»

Për prindërit e mi është e qartë që ata duan, për djalin e tyre të vetëm, një arsimim të mirë. Dhe ata presin prej meje që unë të angazhohem. Unë kam fat, sepse dua të njëjtën gjë si prindërit e mi. Unë do të studioj elektronikën dhe teknologjinë e informimit në Shkollën e Lartë Federale Teknike. Studimi në Shkollën e Lartë Federale Teknike vlerësohet lart edhe në Kinë dhe kjo do të ma lehtësojë të bëj karrierë profesionale.»



ÇFARË GJIMNAZI SILLNI JU?

Gjimnazi është i menduar për nxënëse dhe nxënës, të cilëve u pëlqen të mësojnë dhe nuk i pengon, nëse ata çdo ditë – ndonjëherë edhe me orë të tëra – ulen dhe bëjnë detyrat e shtëpisë, si dhe për të rinjtë, të cilët dëshirojnë të ndjekin dhe mbarojnë një studim në shkolla të larta.

Gjimnazi vazhdon pas klasës së 2-të ose të 3-të nivelit Sekondar, dhe ka – varësisht nga kantoni – kohëzgjatje të ndryshme, por kryesisht zgjat vetëm 4 vjet deri në maturë.

Nëpër disa kantone të Zvicrës gjermanofolëse, ekziston arsimimi afatgjatë, i cili fillon menjëherë pas shkollës fillore dhe zgjat plotë 6 vjet.

KANTONET RREGULLOJNË QASJEN NË GJIMNAZE

Procesi i pranimit në gjimnaz është përgjegjësi e kantonëve. Prandaj ka shumë dallime:

- Është i mundshëm kalimi pa provim në gjimnaz, me notë të caktuar mesatare.
- Disa kantone kërkojnë një rekomandim për pranim nga kujdestari i klasës.
- Kantonet e tjera kanë një procedurë të kalimit – testime dhe biseda.
- Ose kërkohet një provim pranues me shkrim dhe/ose me gojë.

«Mësimi për mua është i lehtë: Që në kopshtin e fëmijëve kam qenë e interesuar për matematikë, natyrisht, me llogaritje të thjeshta, për shembull me këtë: Kur xhaxhai është ulur ende në tryezë me ne, atëherë ne jemi kaq njerëz, por nëse kushërirat do të ngriheshin nga tavolina, do të jemi vetëm kaq. ...

SELINA VALDIVIA, ZVICËR DHE KUBË
VITI I 4-T GJIMNAZ, MATEMATIKË DHE
SHKENCA NATYRORE



Që atëherë të gjithë më kanë thënë se unë sigurisht do të shkoj në gjimnaz. Në klasën e 8-të e provova provimin pranues dhe u pranova në gjimnaz. Nuk jam e vetmja në familje që interesohej për matematikë dhe biokimi. Kushërinjtë dhe kushërirat e mia e kanë zgjedhur të njëjtin drejtim.

Rregullimi i pavarur i të mësuarit

Gjimnazi është vendi i duhur për mua. Si 13-vjeçare unë kam mundur të planifikoj në mënyrë të pavarur kohën dhe mësimet. Kjo edhe duhet. Një mësim-dhënës jep mësim në shumë klasa dhe nuk ka kohë të kujdeset për secilin nxënës dhe nxënëse veçmas. Askush nuk i kontrollon detyrat e shtëpisë, andaj ti duhet të vendosësh vetë, kur dhe sa do të mësosh.

Por, një shkollë e madhe ka gjithashtu edhe shumë përparësi. Te ne rreth 1,500 nxënës dhe nxënës vijojnë gjimnazin dhe kështu kam krijuar një rreth shumë të madh të të njohurve, shumë miq dhe mi-kesha të mira.

Dhe për mësim kam zhvilluar sistemin tim. Gjatë orëve të mësimt jam aktive, përvetësoj shumë nga lënda e ligjruar. Natyrisht, unë duhet të mësoj edhe fjalë të reja për frëngjishten dhe anglishten. Por kjo nuk do angazhim të madh, sepse unë kam një mbamendje shumë të mirë. Atë që e kemi mësuar para pushimeve të verës unë ende e mbaj mend, edhe pas pushimeve.

«Mësoj me shumë kënaqësi»

Pra, mua nuk më duhet kohë e tepërt për t'i bërë detyrat e shtëpisë. Nëse një javë nuk kemi provime, atëherë ndodhë të mos i bëj detyrat e shtëpisë. Nëse janë planifikuar tri-katër teste gjatë javës, atëherë unë mësoj disa orë. Dhe unë mësoj me kënaqësi. Për gjimnaz duhet të kesh dëshirë për mësim. Nëse dikush nuk ka interesim për përmbajtjen e lëndëve të mësimt, nuk shkon me vullnet në shkollë, atëherë gjimnazi është mjaft i vështirë.

Unë ende nuk e di se çfarë dua të studioj më vonë. Ndoshta matematikë. E mundshme është edhe historia dhe gjuha gjermane ose gazetaria, sepse unë interesohej për temat aktuale dhe lexoj rregullisht gazetën.»



PRISKA KRIEG, ZVICËR
VITI I 1-RË ZANAT
NËPUNËSE, PROFILI M

Gjimnazi nuk ka qenë drejtimi i duhur: «Pasi ia dola me sukses provimit pranues për në gjimnaz, mua m'u përmbush një ëndërr. Pastaj realiteti në gjimnaz nuk ishte edhe aq i këndshëm. ...

Për shembull nuk mund të pajtohesha me faktin se tërë ditën, edhe gjatë drekës, duhej të qëndroja në shkollë. Më është dashur të mësohem me këtë realitet. Më së keqi për mua ka qenë fakti se unë – në shollën sekundare isha ndër nxënëset më të mira – tash në gjimnaz isha në mesin e nxënësve mesatarë ose të dobët.

E vërejtja se kisha sjellë me veti shumë mangësi mësimore, sidomos në frëngjisht dhe në matematikë.

Në fillim kam qenë e mbingarkuar në mësim. Me kalimin e kohës arrita të përmirësohesha, ndoshta edhe për shkak se merrja orë ndihmëse në frëngjisht. Mirëpo, ishte një ngarkesë e madhe, sepse në provime nuk dola mirë, ashtu si kisha dëshirë.

Aplikimi i fshehtë

Rastësisht kam pa që Televizioni i Zvicrës kishte shpallur një vend për mësim të zanatit për nëpunëse, një profesion dhe një ndërmarrje të cilat gjithmonë më kanë interesuar. Aplikova pa i treguar askujt. Dhe unë u pranova në zanat.

Prindërit e mi donin që unë megjithatë të përfundoja vitin e filluar të gjimnazit, si parapërgaditje për shkollën e maturës profesionale. Unë e pyesja veten pse duhet të përballoja këtë stres edhe njëgjysmë viti. I binda prindërit e mi dhe u ktheva në sekondare. Ky ishte vendim i duhur, unë isha prapë së bashku me kolegët dhe koleget e mia dhe kisha më shumë kohë të lirë. Megjithatë doja të përgaditesha në mënyrë të fokusuar për shkollën e maturës profesionale, sidomos doja t'i përmirësoja njohuritë e gjuhës frënge. Mësoja shumë dhe isha e lumtur kur ia dola të jepja provimin pranues në shkollën e maturës profesionale.

Ndërlidhja e teorisë me praktikën

Tash jam duke mësuar profesionin, jam duke i bërë përvojat e para profesionale. Me dëshirë jam në ndërmarrje dhe puna më duket interesante. Megjithatë gëzohem që dy ditë në javë mund të shkoj në shkollë. Ndërlidhja e teorisë me praktikën, për mua është përzjerja e duhur. Nuk ka qenë e lehtë për mua të ndërpres gjimnazin. Por, sot e di, nëse dua, edhe më vonë mund të studioj. Tash e bëj maturën profesionale, mund ta bashkëngjes Passarelle-n dhe pastaj të shkoj në universitet.»

Këshilla dhe sugjerime për prindër

Nëse biri juaj, bija juaj shpreh dëshirën që të shkojë në gjimnaz, bisedoni më herët dhe sqaroheni me mësimdhënësin, nëse kjo dëshirë është në përputhje me rezultatet mësimore dhe me angazhimin në shkollë:

- për gjimnazin afatgjatë qysh në fund të klasës së 5-të primare
- për gjimnazin afatshkurtër, në fund të nivelit 1 të lartë (viti i 7 shkollor).

Sqarohuni me djalin tuaj, vajzën tuaj, në Qendrën Informative për Profesione,

- si është e rregulluar procedura e pranimit në kantonin tuaj;
- cilat gjimnaze çfarë profile maturash ofrojnë në rajonin tuaj (jo çdo shkollë ofron çdo profil).

Ju keni vendosur për gjimnazin, por duhet të diskutoni edhe alternativat:

- Djali juaj, vajza juaj duhet të përgatitet për procedurën pranuese. Nëse kjo nuk bëhet, ai ose ajo mund ta përsërisë njëherë provimin pranues.
- Informohuni për ofertat ndërlidhëse në rajonin tuaj. Në një ofertë ndërlidhëse shkollore djali juaj, vajza juaj mund të përgatitet për përsëritjen e provimit pranues.
- Mirëpo duhen edhe alternativa. Zgjidhja ideale do të ishte, nëse djali juaj, vajza juaj, ka energji të mjaftueshme për t'u përgatitur për provimin pranues, duke e kombinuar me kërkimin e një vendi për mësimin e zanatit.

Gjatë kalimit nga niveli Sekondar I në arsimimin profesional (niveli Sekondar II), përgatitja për zgjedhjen e profesionit luan një rol të rëndësishëm. Ky është një proces individual. Edhe pse të gjithë bëjnë hapat e njëjtë, megjithatë te disa faza e zgjedhjes së profesionit zgjatë pak më gjatë se te tjetërët. Përderisa ju ndoshta keni gjetur një zanat, kolegët dhe koleget tuaja janë ende duke menduar se çfarë duan të mësojnë. Ose, ju nuk mund të vendosni për një profesion të caktuar dhe vijoni gjatë një viti një ofertë ndërlidhëse praktike ose shkollore.

Ky kapitull ka për qëllim t'u tregojë të rinjve dhe të rejava të huaja (dhe prindërve të tyre), se si ata më së miri mund të zgjedhin një profesion dhe, si mund të përgatiten më së miri për të gjetur dhe ruajtur një vend për mësim të profesionit. Informon edhe për zgjidhjet kalimtare, nëse nuk funksionon hyrja e menjëhershme në mësim të profesionit.

Hapat e parë në karrierën profesionale

Përgaditja e zgjedhjes së profesionit

Faqe

50	Plani ose orari i zgjedhjes së profesionit
51	Ju e dini çfarë dëshironi
52	Të njohësh përditshmërinë e punës
54	Testi i përshtatshmërisë – një çështje nervash
55	Dosja e aplikimit - shumë, shumë punë
56	Kërkimi i vendit për zanat – kontakti i parë me një ndërmarrje
57	<i>Emanuel Tanner, Zvicër, mjeshtër i tymparëve</i> «Çfarë pres unë prej nxënësve?»
58	Me përgatitje të mirë, intervista e suksesshme
60	Përkundër refuzimeve, mos u dorëzoni
62	Kontrata për mësim të zanatit në dorë
64	Ofertat shkollore ndërlidhëse
65	<i>Vinnhy Tayele, Kongo, oferta ndërlidhëse</i> «Mua më duhet më shumë kohë për vendimmarrje»
67	<i>Vanessa Lopez, Zvicër dhe Kanada, nxënëse – nëpunëse</i> «Unë kam dashur të përmirësohem në përgjithësi»
68	Ofertat ndërlidhëse të orientuara në praktikë:
69	<i>Rohullah Rahimi, Afganistan, paramësim ekspert i automobilave</i> «Mësimi hap pas hapi»
70	<i>Ruth Girmay, Eritre, praktika zanatit e profesionistes së shëndetësisë</i> «Gjuha - gur pengese në rrugën time»

Në Zvicër, ju merreni herët me zgjedhjen e profesionit, përkatësisht në dy vjetët e fundit të shkollimit të detyrueshëm, d.m.th rreth moshës 15 ose 16 vjet.

Plani ose orari i zgjedhjes së profesionit

Stacionet në procesin e zgjedhjes së profesionit janë të njëjta për të gjithë. Megjithatë, disave u duhet pak më shumë kohë se të tjerëve, derisa ata të kenë zgjedhur një profesion. Ky është një proces me shumë hapa të vegjël: ju e dini çfarë profesioni dëshironi, e keni zgjedhur një profesion, ua dërgoni dosjen e aplikimit ndërmarrjeve të zgjedhura, e bëni testin e përshtatshmërisë, bëni punë provuese, i përgaditni me sukses intervistat dhe e fitoni kontratën për mësimin e profesionit.

Fazat e zgjedhjes së profesionit

	Viti i 9-të shkollor	Viti i 10-të shkollor	Viti i 11-të shkollor
Njohja e vetvetes			
Informimi (Qendra Informative për Profesione Interneti etj.)			
Njohja profesionale (Vizitat në ndërmarrje, intervistat, panairët profesionale)			
Këllimi profesional personal			
Zgjedhja e profesionit – mësimi provues			
Kërkimi i zanatit – Praktika selektive			

Faza e ballafaqimit të mundshëm

Faza e ballafaqimit intensiv



MBI 200 ZANATE

Profesionet e ndryshme shtrojnë kërkesa të ndryshme në lidhje me parapërgatitjen personale dhe shkollore:

- Shumicën e më se 200 zanateve ju mund t'i mësoni drejtpërsëdrejti pas përfundimit të shkollimit të detyrueshëm.
- Për profesionet e tjera, ju duhet të ndiqni së pari një shkollë të arsimimit të përgjithshëm – shkollë të mesme profesionale ose gjimnaz.

FUSHAT PROFESIONALE DHE SEKTORËT

Bota profesionale është e ndarë në fusha profesionale dhe në sektorë. Ato ua lehtësojnë vështrimin në lidhje me zgjedhjen e profesionit dhe jumundësojnë një vështrim të parë në fusha të ndryshme të interesimeve dhe profesioneve. Ato ua mundësojnë juve, po ashtu, të njihni profesionet, të cilat ndoshta ende nuk i njihni, e të cilat janë të përafërta me profesionet e dëshiruara.

Ju e dini çfarë dëshironi

Zanatet ofrohen për rreth 200 profesione. Në secilën fushë profesionale, gjeni arsimime me kërkesat e ndryshme ndaj aftësive tuaja shkollore dhe personale. Ndoshta kjo shumëllojshmëri e profesioneve dhe e rrugëve të arsimimit, veçanërisht në fillim të përgatitjes për zgjedhjen e profesionit, është pak sa e koklavitur. Në Qendrën Informative për Profesione, ju mund të informoheni në mënyrë të pavarur, ndërsa në Këshillimorën Profesionale e merrni përkrahjen e synuar. Për ju si nxënëse ose nxënës, të dy ofertat janë falas.

Qendra Informative për Profesione

Qendrën Informative për Profesione ju mund ta shfrytëzoni në mënyrë të pavarur gjatë orarit të punës, ndërsa ekspertët e pranishëm do t'ju mbështesin. Në Qendrën Informative për Profesione i gjeni të gjitha informacionet, të cilat u nevojiten për zgjedhjen e profesionit. Doracakët për zgjedhjen e profesioneve ose filmat e shkurtër, ofrojnë një pasqyrë për një profesion ose e prezantojnë atë në mënyrë të saktë, ndërsa në regjistratorët ose në stacionet e internetit gjeni informacione të mëtutjeshme.

Këshillimorja për Profesione

Nëse ju vetëm nuk mund të përparoni, nëse nuk e gjeni se cili profesion ju përshtatet juve, atëherë lajmërohuni për një këshillim individual. Në bisedat me këshilltarin ose këshilltaren profesionale, ose me anë të testeve, do të kuptoni më shumë për vetveten dhe i ofroheni kështu një zgjidhjeje të mundshme. Pas një këshillimi, ju mund të ballafaqoheni në mënyrë të thelluar me një profesion dhe të zgjidhni më të përshtatshmin.

Emërtimet e shpeshta të fushave profesionale dhe sektorëve

- | | | | |
|---|---|---|--|
| – Natyrë, bujqësi, kopshtari, blegtoaria / kultivimi i kafshëve, pylltaria | – Shtypje grafike, industria grafike, shtypje dhe përpunim i mëtejshëm | – Përpunim i metalit, inxhinieri mekanike, farkëtari, prodhim i orëve | – Informatikë, mediamatikë, multimedia |
| – Ushqimi, ekonomia shtëpiake/ menaxhimi i objektit gastronomi/restorante, hoteleri, turizëm | – Ndërtimtari, ndërtimtari e lartë, ndërtimtari e ulët, përpunim i gurit, druri, xhami, dizajni i brendshëm | – Kimi, fizikë, biologji, laborator | – Kulturë, medie dhe komunikim (radio, TV, film), teatër/arti i aktrimit, muzika, ruajtja e kulturës |
| – Tekstile, veshmbathje, përpunim i lëkurës, bukuri, kujdesi i trupit | – Teknika e ndërtesës (paisjet sanitare, ngrohja, ajrosja) | – Mjedisi, ekologjia | – Shëndeti, mjekësi, përkujdesja mjekësore, shpëtimi |
| – Krijimtari, dizajn, art, vepra artizanale, punim i instrumenteve, artet e bukura (arti pamor) | – Automjetet, teknika dhe mirëmbajtja e automjeteve, karoseria (trupit i automjetit) | – Planifikimi, konstruktimi | – Sporti dhe lëvizja |
| | – Elektroteknika, instalimi elektrik, elektronika | – Shitja, blerja, tregti me shumicë dhe pakicë | – Edukimi, arsimimi, mësimdhënia |
| | | – Ekonomi, administratë | – Sociale, këshillimi |
| | | – Transporti (hekurudhat, trafiku ajror, rrugor dhe ujor), logjistikë, polici, siguri, riciklim | |

Gjatë një pune provuese do të njiheni më mirë me profesionin, ndërsa në një praktikë seleksionuese ndërmarrja provon nëse ju jeni i përshtatshëm për profesionin.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2

Të njohësh përditshmërinë e punës

Ekzistojnë mundësi të ndryshme për zgjedhësit e profesioneve, për ta njohur përditshmërinë e punës në profesione. Përveç studimit të mediave informative dhe filmave, tubimet informative në ndërmarrje ose orientimet profesionale dhe panairët profesionale, janë mundësi e shkëlqyeshme për të kundruar njerëz profesional në punë dhe për të folur me ta në lidhje me punën e tyre të përditshme.

Puna provuese ose praktika seleksionuese

Punën e përditshme mund ta përjetoni më së miri vetë, falë punëve provuese ose praktikave seleksionuese. Ato zakonisht zgjasin 2 deri në 5 ditë, të cilat i kaloni në ndërmarrje dhe aty kryeni detyra. Zakonisht, punët provuese ose praktikat seleksionuese funksionojnë pothuajse njëjtë, por ndërmarrja ka qëllime të ndryshme:

- Në një punë provuese, ndërmarrja ju jep mundësinë për t'u njoftuar më mirë me një profesion dhe me punën e përditshme. Nga kjo ju e vëreni nëse pikëpamja juaj për profesionin dhe përditshmërinë në punë është reale.
- Në një praktikë seleksionuese, ndërmarrja midis të tjerave dëshiron të dijë nëse ju jeni personi më i përshtatshëm për profesionin dhe për mësimin e profesionit. Për një praktikë të tillë, ndërmarrja fton ndoshta dy deri tre kandidatë dhe kandidatë, por vetëm një person e fiton vendin për zanat.

Qëllimet tuaja për punën provuese ose për praktikën seleksionuese

Nëse doni të bëni një punë provuese ose një praktikë seleksionuese, atëherë ju në radhë të parë dëshironi që aty të zini një vend si shegert. Por, ju gjithsesi mund t'i shfrytëzoni këto ditë në ndërmarrje, edhe për t'i sqaruar pyetjet e hapura. Për shembull:

- A është reale pikëpamja, që keni pasur për profesionin, për ndërmarrjen?
- A ju pëlqen puna?
- A jeni të përshtatshëm për profesionin?
- A e ndieni veten mirë në ndërmarrje? A është atmosfera e përshtatshme?
- A mund të imagjinoni për të mësuar dhe punuar tri, katër vjetët e ardhshëm në këtë ndërmarrje?

Këshilla dhe sugjerime për prindër

Si nënë ose baba, ne mendojmë ta dimë saktësisht çka është më së miri për fëmijën tonë. Në këtë fazë të përgatitjes për zgjedhjen e profesionit është shumë e rëndësishme që, mundësisht të mbeteni objektiv.

Përpiquni që

- saktësisht të dëgjoni çfarë thotë vajza ose djali juaj.
- të relativizoni dëshirat që keni në roset me fëmijën tuaj dhe mundësitë e tij profesionale.
- ta përkrahni, pa e mbrojtur dhe pa i marrë vetiniciativën.

Rezultatet e një pune provuese ose një praktike seleksionuese

Puna provuese ose praktika seleksionuese mund të japin rezultate të ndryshme:

- Ju dhe personat përgjegjës në ndërmarrje jeni të bindur, se profesioni dhe ndërmarrja janë të përshtatshme për ju. Ju tregoni se jeni të interesuar për një vend për të mësuar zanatin.
- Përgjegjësit në ndërmarrje kanë dyshim se ju jeni të përshtatshëm për profesionin. Ju keni mendim tjetër. Ju e provoni fatin në ndërmarrje të tjera. Nëse nuk funksionon askund, atëherë bisedoni me Këshillimoren për Profesione.
- Ju keni pasur idenë e gabuar për profesionin. Ju përballeni sërish me temën «njihuni me profesionet».



PËRGATITJA

Ftesa për një punë provuese ose për praktikë seleksionuese është një sukses i rëndësishëm. Ndërmarrja dëshiron t'ju njohë më mirë, nëse jeni i përshtatshëm për ndërmarrjen dhe profesionin:

- A përshtateni në ekip?
- A jeni kureshtar?
A parashtroni pyetje?
- A jeni të motivuar?
A keni kënaqësi në punë?
- A jeni të përshtatshëm për profesionin?

Ju e dini se ku gjendet ndërmarrja, te kush duhet të lajmëroheni dhe çka duhet të merrni me vete. Ju mbërrini me kohë dhe jeni të përgatitur për punën provuese ose për praktikën seleksionuese:

- Çka dini për profesionin?
- Pse doni ta mësoni atë?
- Çka dini për ndërmarrjen?
- Pse doni të mësoni profesionin në këtë ndërmarrje?
- Cilat janë anët tuaja të forta?
- Cilat janë dobësitë tuaja?
Si silleni me to?



«Dhe nëse je i interesuar për një vend për të mësuar zanatin në një ndërmarrje të madhe, atëherë lajmërohu herët për tubimet informative ose për ditët provuese. Praktikën provuese si të tillë ato shpesh nuk e ofrojnë.» Sina



KUSHTET E TESTIT

Zakonisht testohen ajo që është mësuar deri në vitin e parafundit të shkollës, dhe aftësitë shtesë. Faqet e internetit Basic-check (www.basic-check.ch) dhe Multicheck (www.multicheck.org), ju informojnë mbi lajmërimin, kohëzgjatjen e testit, mjetet e lejueshme ndihmëse dhe vendin e mbajtjes. Përveç kësaj, ju do të mësoni se sa kushton testi dhe si duhet bërë pagesa. Për testet e ndërmarrjeve ofruese të vendeve për zanat ose të shoqatave profesionale, këto të dhëna janë të shkruara në ftesën për testim.

REZULTATI I TESTIT

Rezultatet e testit i merrni ose menjëherë pas testit, ose ato do t'ju dërgohen:

- Nëse keni arritur rezultat të mirë në test, atëherë bashkëngjiteni këtë në dosjen e aplikimit.
- Nëse keni arritur një rezultat të pakënaqshëm ose madje të pamjaftueshëm, atëherë bisedoni me këshilltaren ose me këshilltarin tuaj profesional në lidhje me alternativat për profesionin tuaj të dëshiruar.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2

Testi i përshtatshmërisë – një çështje nervash

Shumica e ndërmarrjeve të zanatit, kërkojnë edhe rezultatin e një testi të përshtatshmërisë, si pjesë e dosjes së aplikimit. Informacionet për llojin e testit të përshtatshmërisë, i cili pritet nga ju, i gjeni në ofertat e ndërmarrjeve për vendet e mësimit të zanatit.

«Gjatë testit të përshtatshmërisë fillimisht isha aq nervoz, sa nuk më kujtohej asgjë. M'u desh të pres dy-tri minuta, të marrë frymë thellë dhe të përqendrohem përsëri. Pastaj puna ka ecur diçka më mirë.» Wafa

Basic-check (Kontrolli themelor)

Kontrolli themelor për testin e përshtatshmërisë bën dallimin mes:

- Kontrollit praktik bazë (për të gjitha profesionet me Atest Federal të Profesionit dhe pak profesioneve me Certifikatë Federale të Aftësimin)
- Kontrolli standard (për të gjitha profesionet e sofistikuara me Certifikatë Federale të Aftësimin)

Basic - check kërkon detyra logjike me përmbajtje gjuhësore (gramatikë, lexim-kuptim, koncepte, kuptim të fjalëve), me numra (algjebër, aritmetikë, gjeometri) dhe me përmbajtje dy- ose tri-dimensionale (rradhitje të figurave, aftësitë e imagjinatës hapësinore) dhe gjuhët e huaja (gjermanisht, anglisht, frëngjisht).

Multicheck (kontrolli i shumanshëm)

Multicheck ofron teste të përshtatshmërisë për profesione të aplikuara në praktikë (profesionet administrative ose teknike, profesionet në tregti me pakicë, artizanat, në shëndetësi dhe çështje sociale, informatikë, Beauty ose në krijimtari) si dhe një test përshtatshmërie për të gjitha profesionet me Atest Federal të Profesionit.

Për fushat e veçanta profesionale, testet kanë peshë dhe prioritete të ndryshme: për tregtarët ose për tregtinë me pakicë, fokusi është më shumë në gjuhët, për profesione teknike ose për informatikë, fokusi është në matematikë dhe aftësi imagjinative, për profesionet shëndetësore rëndësi ka komunikimi dhe shkencat natyrore.

Për të gjitha fushat profesionale, testohen aftësitë shtesë, si logjika, mbamendja, kujtesa afatshkurtër, përqendrimi ose aftësitë organizative.

Testet e përshtatshmërisë të ndërmarrjeve ose të shoqatave profesionale

Ndërmarrjet ose shoqatat për arsimim me shumë shëgertë, si dhe sektorë ose shoqata profesionale, kanë krijuar testet e tyre. Varësisht nga profesioni ose ndërmarrja, këto teste kontrollojnë lëmenj të ndryshëm.



QËNDRUESHMËRIA

Në mësimin për zgjedhjen e profesionit në shkollë ju mësoni se çka përmban një dosje e aplikimit. Zakonisht, tani të gjithë nxënësit të cilët kërkojnë vende për zanat, dërgojnë më shumë se 10 aplikacione, prandaj punojnë edhe në shtëpi, duke shkruar letra të aplikimit. Nëna ose babai juaj sigurisht mund t'ju ndihmojnë në këtë rast.

Dosja e aplikimit – shumë, shumë punë

Dosja e aplikimit

Ju keni vendosur për një profesion, ndoshta keni bërë praktikë provuese dhe e keni kaluar testin e përshtatshmërisë. Tash doni të konkurroni për një vend të hapur për mësim zanati. Për këtë ju duhet një dosje e aplikimit, të cilën ju e përgatitni veçmas për çdo aplikim të ri.

Disa ndërmarrje mund të kërkojnë edhe dokumente të ndryshme shtesë. Për të qenë i sigurt, se të gjitha dokumentet e kërkuara janë të bashkëngjitur në dosje, kontrolloni faqen e internetit të ndërmarrjes, te e cila jeni duke aplikuar, se çka presin personat përgjegjës nga ju.

Zakonisht:

- Me aplikimin dhe letrën tuaj motivuese, ju e ngjallni interesimin e përgjegjësve në ndërmarrjet të cilat ofrojnë vende zanati. Ju sqaroni, pse keni zgjedhur pikërisht këtë profesion dhe këtë ndërmarrje.
- Në biografinë jetësore, në formë liste tabelore, ju shënoni të dhënat personale, shkollimet, njohuritë gjuhësore, aktivitetet e kohës së lirë dhe referencat.
- Me dëftesat e shkollës për tre vjetët e fundit, ju dëshmoni parapërgatitjen tuaj shkollore.
- Për shumicën e profesioneve kërkohen teste të veçanta të përshtatshmërisë. Rezultatin e testit ia bashkëngjitni dosjes së aplikimit.
- Rosertet nga praktika provuese ose praktika seleksionuese dëshmojnë se jeni interesuar dhe ballafaquar në mënyrë të themeltë me profesionin.
- Ndërmarrjet më të mëdha kërkojnë një pyetësor personal të plotësuar me dorë.
- Ndonjëherë dosjes ju duhet t'i bashkëngjitni një kopje të lejes së qëndrimit. Lejet e qëndrimit C ose B nuk janë një problem. Nëse keni një leje tjetër qëndrimi, atëherë informohuni pranë entit përkatës për migrim.

Këshilla dhe sugjerime për prindër

Ju si nënë, si baba, tani aktivizoheni dhe shfrytëzoni rrjetin tuaj të lidhjeve. Ju i informoni të gjithë të afërmit dhe të njohurit, punëdhënësit, kolegët dhe koleget e punës, anëtarët e shoqatës, mjeken ose edhe dentistin tuaj, se djali, vajza juaj është duke kërkuar një vend për mësimin e zanatit. Rrjeti i lidhjeve shpeshherë shpie deri te një vend për zanatin.

Me dosjen e aplikimit, ndërmarrjes ku dëshironi të mësoni zanatin, i krijoni një përshtypje të parë pozitive. Secila pjesë e dosjes duhet të jetë pa gabime, e pastër dhe e dizajnuar bukur.

Kërkimi i një vendi për zanat parimisht funksionon njëjtë si kërkimi i një vendi pune. Për këtë ju duhet durim dhe përkushtim.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2

Kërkimi i vendit për zanat – kontakti i parë me një ndërmarrje



SITË APLIKONI PËR NJË VEND PËR ZANAT?

Vendet e lira për zanate botohen në gazeta ditore ose në faqet e internetit të ndërmarrjeve. Nga shtatori i secilit vit, në dispozicion është edhe verifikimi i vendeve për shkollim pranë këshillimoreve për profesione në www.berufsberatung.ch/lehrstellen, www.orientation.ch/apprentissage, www.orientamento.ch/tirocionio në të cilën publikohen vendet e lira për mësimin e zanatit në rajon.

Ju mund të informoheni edhe duke telefonuar drejtpërsëdrejti në ndërmarrje, nëse vendi i shpallur ende është i lirë dhe nëse mund të aplikoni. Kështu, në letrën motivuese ju mund t'i drejtoheni me emër personit përgjegjës, t'ia dërgoni dosjen e plotë të aplikimit drejtpërdrejt atij, me postë ose nëpërmjet internetit.

ÇFARË REAGIME MUND TË PRISNI?

Ndërmarrjet për mësimin e zanatit pranojnë shumë aplikime, kështu që ato së pari ju dërgojnë vetëm një konfirmim ku ju lusin të jeni i durueshëm, për të reaguar më vonë sa më konkretisht.

Ndërmarrjet për mësimin e zanatit ju ftojnë për një test të brendshëm të përshtatshmërisë. Nëse arrini rezultat të mirë, atëherë procesi i aplikimit vazhdon. Nëse jo, do të merrni një refuzim.

Ndërmarrjet për mësimin e zanatit duan t'ju njohin më mirë dhe ju ftojnë për një praktikë provuese ose praktikë seleksionuese.

Ndërmarrjet për mësimin e zanatit duan t'ju njohin më mirë dhe ju ftojnë për një intervistë.


Ndërmarrjet për mësimin e zanatit nuk reagojnë fare. Për disa zanate aplikojnë me dhjetëra nxënës. Ndërmarrjet për mësimin e zanatit nuk përgjigjen në çdo letër aplikimi.

Ndërmarrjet për mësimin e zanatit dërgojnë një refuzim.

«Ndonjëherë kjo vërtet më ka shqetësuar. Shkruaj një aplikacion, përpiqem shumë dhe nuk marr madje as një refuzim. Thjesht, nuk dëgjoj asgjë.» Wafa



«Aplikacionin tim të parë gati për pak nuk e kam dërguar. Vazhdimisht e kam kontrolluar nëse gjithçka është në rregull dhe duket bukur.» Maida



EMANUEL TANNER, ZVICËR
MJSHTËR I TYMTARËVE ME PROVIM TË
SHKOLLËS SË LARTË PROFESIONALE

*«Çfarë pres unë prej
nxënësve?»*

*Brenda vitit lajmërohen rreth
15 të interesuar që duan
të marrin zanat në ndërmarrjen
time. Në një bisedë unë sqaroj
motivimin, ndërsa në praktikën
provuese përshtatshmërinë
artizanale. ...*

Ta shohësh punën më vete

Përparësi kanë qartazi ata të interesuar, të cilët ndihmojnë edhe në shtëpi dhe punën e shohin më vete dhe i përvishen asaj. Përveç përshtatshmërisë profesionale, shëgertët duhet të kenë edhe një paraqitje miqësore, sepse ata punojnë nëpër shtëpi dhe me mushterinj.

Prandaj duhet të punojnë me ndërgjegje dhe me përgjegjësi, sepse puna e punëtorit dhe e punëtores në tymtarë mund të parandalojë zjarret. I plotësojnë të interesuarit të gjitha këto kushte, e bëjnë testin e përshtatshmërisë, të cilin e ka hartuar Shoqata e Mjeshtërvë të Tymtarëve. Kush e kalon edhe këtë, përmbush të gjitha parakushtet për arsimimin bazë profesional.

Provimi i Lartë Profesional mua më ka përgatitur mirë për arsimimin e shëgertëve. Për mua gjithmonë ka qenë e qartë, që unë ndonjëherë do ta bëj Provimin e Lartë Profesional. Zanatlinjtë e tymtarëve mund të krijojnë një ndërmarrje të veten, vetëm nëse janë licencuar nga një komunë. Dhe, për të marrë një licencë, duhet të bësh Provimin e Lartë Profesional.

Përgatitja konsekuente

Unë jam përgatitur në mënyrë konsekuente për këtë hap në karrierë: pas provimit të diplomës, pasuan vitet e rrugëtimit. Unë fillova në Gjenevë dhe punova në të gjithë Zvicrën. Ndërtuesit dhe ndërtueset e stufave ndërtonin stufa të ndryshme, dhe unë dëshiroja të mësoja të gjitha llojet e ndërtimeve të tilla.

Provimi i Lartë Profesional teston teorinë dhe praktikën. Pjesën praktike të provimit mjeshtëror e kam bërë në Kantonin e Cyrihut. Midis të tjerash, me atë rast është vlerësuar edhe se si e planifikoj punën për bashkëpunëtorët dhe për shëgertët – në përputhje me vitin e tyre shkollor – dhe si i angazhoj unë njerëzit për detyra të ndryshme.»

Në një praktikë provuese ose seleksionuese, ju keni kohë disa ditë për të treguar atë që dini, sa të motivuar dhe të përkushtuar jeni. Intervista merr rreth një orë dhe zakonisht nuk përmban ndonjë punë praktike.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2

Me përgatitje të mirë, intervista e suksesshme

Nëse ftoheni për bisedë, ju gëzoheni me të drejtë. Por ju jeni për herë të parë në këtë situatë, nuk dini saktësisht se çfarë ju pret. Për këtë arsye ju do të përgatiteni mirë dhe në mënyrë të veçantë për këtë intervistë.

Njerëzit në rrethin tuaj personal ose në shkollë mund t'ju ndihmojnë për këtë. Sigurisht edhe prindërit tuaj e dinë nga përvoja e tyre, se si rrjedh një intervistë. Ndoshta ata mund të marrin rolin e mësimdhënësit të profesionit, duke ju mundësuar të ushtroni bisedën disa herë.



«Nëse ti e do një vend për mësim të zanatit, atëherë duhet të jesh vërtet i interesuar për këtë profesion. Nëse të ftojnë për intervistë, pamja jote e jashtme duhet t'i përshtatet profesionit dhe ndërmarrjes.» Debora

Këshilla dhe sugjerime për prindër

Sigurisht ju keni bërë përvojën tuaj në botën e punës. Ju e dini si rrjedh një intervistë, çfarë kërkohet aty. Bisedoni me djalin tuaj, vajzën tuaj në lidhje me këtë.

Tregojuni për përvojat tuaja të mira dhe më pak të mira.

Vihuni në dispozicion si një partner kundërshtues i djalit ose vajzës suaj, merrni rolin e përgjegjësit për arsimim dhe ushtroni me të.



PËRGATITJA PËR INTERVISTË

Njerëzit zhvillojnë forma individuale të relaksimit – pinë çaj kamomili, marrin frymë thellë, bëjnë ushtrime relaksuese.

Ju e gjeni formën e cila ju përshtatet më së miri. Ju guxonin të jeni nervoz dhe këtë ta përmendni gjatë bisedës. Rrobat janë të pastra dhe të rehatshme, i përshtaten mjedisit profesional dhe situatës së një interviste. Ju duhet të ndiheni mirë dhe i sigurt.

GJATË BISEDËS

- Mbresat e para janë gjithmonë të rëndësishme: buzëqeshni kur përshëndetni.
- Drejtohuni personit përballë me emër.
- Prisni derisa t'ju ofrohet një vend për t'u ulur.
- Uluni drejt dhe përpiguni të pushoni i qetë. Këmbët më së mirë është t'i vendosni në tokë.
- Qetësojeni frymëmarrjen.
- Shikojeni personin përballë hapur dhe drejt në sy.
- Dëgjoni me kujdes, përgjigjuni pyetjeve në mënyrë të hapur.
- Mos i ndërhyri në fjalë personit përballë.
- Mos u lavdëroni, por mos u tregoni edhe tepër modest.
- Merrni shënime.
- Shtroni pyetje.

FUNDI I INTERVISTËS

Edhe përshtypja e fundit do të mbetet në kujtesë. Ideale do të ishte nëse ju bisedën e përfundoni me një pyetje. Për shembull::

- «Në këtë moment unë nuk kam më pyetje, por a mund t'ju thërras, nëse dua të di edhe diçka?»
- «Si do të vete më tutje?»

Falënderohuni patjetër për intervistën.

«Ftesa për intervistë, për mua ka qenë një sukses i madh. E ushtrova bisedën së pari me mësuesen time e pastaj me familjen time. Kjo më ka ndihmuar. Edhe pse kam qenë shumë nervoz, e bëra punën si duhet. Unë pata mundësinë të bëj një punë provuese dhe arrita të marr vendin për mësim të zanatit.» Güler



Ju përpqeni – megjithatë, nuk funksionon: vijnë refuzimet. Këto janë momente të vështira. Ju mund të diskutoni arsyet e mundshme për refuzimet me prindërit tuaj, mësimdhënësin ose edhe me Këshillimorin për Profesionet. Njëkohësisht ju duhet të vazhdoni.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2

Edhe përkundër refuzimeve, mos u dorëzoni

Refuzimet janë diçka normale gjatë kërkimit të vendit për mësim të zanatit. Shumica marrin një ose shumë refuzime, sepse edhe konkurrenca për disa vende për mësimin e zanatit mund të jetë shumë e madhe. Nëse ju pranoni refuzim pas një praktike seleksionuese ose pas një interviste, është e mërzitshme, por ju edhe keni fituar informata të rëndësishme.

Ju jeni në rrugën e duhur. Ju jeni ftuar, ngase:

- Letra juaj motivuese dhe dosja e aplikimit është bindëse.
- Notat në dëftesë mjaftojnë për profesionin.
- Rezultati i testit të përshtatshmërisë është mjaft i mirë.

Por, ju keni pasur pak fat të keq, një tjetër kandidat, një tjetër kandidat është më i përshtatshëm se ju. Nëse për çdo aplikim merrni refuzime, atëherë do të ishte e vlefshme për ju të rishikoni profesionin e zgjedhur dhe të shihni me kohë për alternativa. Këshilltari ose këshilltarja profesionale mund t'ju mbështesë gjatë kësaj procedure.



Këshilla dhe sugjerime për prindër

Refuzimet minojnë vetëbesimin. Fëmija juaj tani ka nevojë për inkurajim dhe mbështetje.

Ju kujdeseni që dosja e aplikimit të jetë pa gabime, e pastër dhe e plotë. Në faqen

e internetit të ndërmarrjes janë shënuar dokumentet që kërkohen për aplikacion.

Fëmija juaj i kushton kohën e nevojshme aplikacioneve. Çdo letër motivimi dhe aplikimi dëshmon se e njëjta ndërmarrjen dhe e di se për çfarë arsye dëshiron të mësojë zanatin aty.

Ju e përkrahni vajzën ose djalin tuaj për përgaditjen e secilës intervistë veç e veç.

Kur të grumbullohen refuzimet, mendoni së bashku:

- A mjaftojnë notat në dëftesë për profesionin e preferuar?
- A janë plotësuar kushtet për profesionin e dëshiruar?

- A mjafton rezultati i testit të përshtatshmërisë për profesionin e zgjedhur?
- Cilat profesione do të ishin alternativë e mundshme?
- A është e udhës të kërkoni një bisedë me këshilltarët për profesione?

«Unë kam marrë shumë, shumë refuzime. Shumë keq ka qenë për mua. Kisha ndjenjën se askush nuk më do mua. Po të mos më kishte motivuar mësuesja ime, unë do të kisha hequr dorë. Fatmirësisht kam vazhduar edhe më tej dhe tani e kam një vend për të mësuar zanatin.» *Rut*



ARSYET E MUNDSHME PËR REFUZIME PAS APLIKIMIT ME SHKRIM

Për një vend zanati kanë konkurruar me dhjetëra. Ju nuk keni hyrë në përzgjedhjen e ngushtë.

Dosja e aplikimit nuk është e plotë, ka gabime, është e papastër ose e hartuar në mënyrë të pakujdesshme.

Në letrën e motivimit ose të aplikimit nuk keni gjetur argumente bindëse, se pse keni zgjedhur këtë profesion ose këtë ndërmarrje.

Notat në dëftesat e fundit nuk janë shumë të mira dhe nuk përputhen me kërkesat.

Rezultati i testit të përshtatshmërisë nuk mjafton për profesionin.

Ju keni aplikuar shumë vonë, dhe vendi i zanatit tashmë është zënë.

ARSYET E MUNDSHME PËR REFUZIME PAS INTERVISTËS

Koha në intervistë është e shkurtër. Ju prezantoheni për herë të parë në një botë të të rriturve, kjo ju ka bërë nervoz. Për ju ka qenë e vështirë të prezantoheni si duhet, megjithë përgatitjen e mirë.

Ndoshta edhe në intervistë konkurrentet dhe konkurrentët tuaj mund të kenë zotëruar detyrën më mirë. Në rast të refuzimit – kryesisht nëpërmjet telefonit – medoemos duhet të pyetni pse keni dështuar. Mësimet e nxjerra nga kjo përvojë mund t'i shfrytëzoni në intervistat e ardhshme.

Me çdo intervistë bëni përvoja të rëndësishme, të cilat mund t'i shfrytëzoni më vonë gjatë procesit të aplikimit. Tani duhet të jeni i qëndrueshëm.



Ju keni pranuar një konfirmim me shkrimose me gojë nga ndërmarrja për mësim të zanatit dhe jeni pranuar për të mësuar zanatin. Personi përgjegjës indërmarrjes, ju ose prindërit tuaj, sipërfaqësues ligjor, e nënshkruani kontratën për mësim të zanatit. Kontrata e nënshkruar nga të gjitha palët miratohet nga Enti Kantonal për Arsimim Profesional.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2

Kontrata për mësim të zanatit në dorë

Kontrata për mësim të zanatit rregullon çdo gjë që është e rëndësishme për kohëzgjatjen e arsimimit bazë profesional, dhe përfshin:

- Të dhënat tuaja personale dhe të prindërve tuaj si përfaqësues ligjorë
- Titulli i saktë i profesionit
- Kohëzgjatja e arsimimit bazë profesional dhe koha provuese
- Të dhënat rreth ndërmarrjes, veçanërisht të personit përgjegjës
- Të dhënat mbi shkollën profesionale, të cilën e vizitoni gjatë arsimimit bazë profesional
- Matura profesionale (po ose jo)
- Paga
- Orari i punës
- E drejta e pushimeve vjetore
- Përgjegjësi për sigurimin e veglave të punës dhe të veshmbathjeve profesionale
- Sigurimet
- Rregulla të veçanta eventuale



Këshilla dhe sugjerime për prindër

Me fillimin e mësim të zanatit nis rruga për në botën e të rriturve. Probleme të vogla ose edhe të mëdha, gjatë kësaj faze kalimtare, janë përherë të mundshme. Si hap i parë, fëmija juaj përpiket t'i

zgjdhë problemet vetë. Nëse nuk ka sukses, atëherë i ndryshon sjelljet. Shenjat e para mund të jenë mungesa e motivimit të djalit ose të vajzës juaj, në mëngjes nuk zgjohet, mungon në shkollë, nuk shkon me vullnet në punë, vazhdimisht ankohet për kokëdhembje dhe dhembje të barkut.

Me t'i vërejtur ose nuhatur këto shenja, ju si nënë ose baba, reagoni dhe menjëherë kërkoni të bisedoni.

«Kur e pashë kontratën për mësimin e profesionit në kutinë e postës, kam qenë tepër i lumtur. Mirëpo, më kujtohet mirë si mendoja, tash do të bëj katër vjet të njëjtën gjë. Këtë gati as që mund ta paramendoja. Dhe tash, gati e kam bërë gjysmën e zanatit.» *Syssa*



PROFESIONI I GABUAR? NDËRMARRJA E GABUAR?

Jo gjithmonë ecën gjithçka si duhet. Për suksesin në arsimimin bazë profesional, kryesore është që të gjithë personat e përfshirë, në rast të problemeve, së pari të kërkojnë të bisedojnë bashkë:

- Në rast të problemeve personale ose profesionale në ndërmarrje, mundësisht bisedoni menjëherë me përgjegjës në ndërmarrje dhe kërkonit zgjidhjen së bashku.
- Në rast të problemeve në shkollën profesionale, bisedoni me mësimdhënësin, ndoshta duhet të kërkonit leksione përkrahëse ose kurse të gjuhës shtesë.

Mund të ngjajë që, derisa jeni duke vijuar arsimimin bazë profesional, të kuptoni se keni zgjedhur profesionin e gabuar dhe prandaj dëshironi të ndërpritni zanatin. Ose ndoshta bashkëpunimi me ndërmarrjen është aq i keq, sa të mos dëshironi të absolvoni ose të përfundoni zanatin në këtë ndërmarrje. Në situatë të tillë, diskutoni problemin së pari me përgjegjës në ndërmarrje ose në shkollën profesionale.

Nëse nuk shihet asnjë zgjidhje, bisedoni patjetër me përgjegjës e Entit për Arsimim Profesional. Ndoshta është i mundur organizimi i ndonjë rivendosjeje – kjo domethënë, vazhdim i arsimimit bazë në një ndërmarrje tjetër. Në rast të ndërprerjes së zanatit, për veprimet e mëtutjeshme, diskutoni me këshilltaren ose këshilltarin profesional.



«Natyrisht që jam angazhuar shumë për të marrë nota të mira. Por edhe i kam kushtuar rëndësi edhe sjelljeve të mia. Për shumë ndërmarrje, kjo është shumë me rëndësi. A kam qenë gjithmonë i saktë? A nuk kam munguar kurrë pa arsye? A kam qenë gjithmonë i sjellsbëm? Është me rëndësi që edhe në shkollë të sillesh si duhet. Atëherë do të kesh sukses edhe në kërkim të vendit për mësimin e zanatit.» *Priska*

Oferta shkollore ndërlidhëse krijojnë një urë mes kohës së shkollimit të detyrueshëm dhe arsimimit bazë profesional, gjegjësisht të shkollës së mesme speciale ose gjimnazit. Ofertat ndërlidhëse pas shkollimit të detyrueshëm, janë ose vit shkollor vullnetar shtesë, ose një paramësim profesional ose një praktikë profesionale përgaditore.

Ofertat shkollore ndërlidhëse

Secili kanton e ka zhvilluar sistemin e vet të ofertave ndërlidhëse. Prandaj viti për zgjedhjen e profesionit në Bernë mund të ofrojë përmbajtje krejt tjetër nga viti për zgjedhjen e profesionit në Cyrih, Lozanë ose Lugano. Krahas këtyre, ekziston edhe një paletë e gjerë e ofertave ndërlidhëse private. Ju duhet të informoheni pranë Qendrës për Informim për Profesionet, se cila ofertë ndërlidhëse në kantonin tuaj i përshtatet më së miri nevojave tuaja, ose bisedoni për ofertat ndërlidhëse me mësuesin tuaj të klasës.

«Në vitin përgatitor për profesionin, përfundimisht kisha mjaft kohë për të njohur më afër shumë profesione të ndryshme.» Simon



Shumica e ofertave ndërlidhëse kushtojnë para. Se sa i shtrenjtë është shkollimi, kjo varet prej kriterëve të ndryshme: Çfarë ofron vendbanimi ose kantoni juaj? Për çfarë lloji të ofertës ndërlidhëse bëhet fjalë? A bëhet fjalë për një ofertë në një shkollë publike ose private? Varësisht nga këto, një ofertë ndërlidhëse mund të kushtojë deri në 14'000 Franga në vit. Informohuni në Qendrën Informative për Profesionet për shpenzimet dhe për mundësinë për të kërkuar një bursë.



VINNHY TAYELE, KONGO
OFERTA NDËRLIDHËSE

«Mua më duhet më shumë kohë për vendimmarrje: Unë e di që nga niveli Sekondar, që për mua në konsiderim vijnëvetëm dy profesione: një profesion i arsyes, nëpunës, ose njëprofesion i zemrës, në fushën sociale ose atë të përkujdesjes. ...»

Për kërkimin e vendit për të mësuar zanatin shpenzoj shumë kohë, dhe gjej. Unë jam duke bërë klasën e 10-të dhe brenda kësaj kohe jam duke shkruar shumë aplikime për zanat. Mirëpo, unë bëj edhe gjëra të tjera. Në kohën time të lirë organizoj kurse vallëzimi dhe mbrëmje për të rinj, në një qendër të bashkësisë. Ky është kontributi im për shoqërinë. Ose shkruaj dhe këndoj si reper, këtë e bëj për shpirtin tim. Megjithatë përpiqem për një vend për zanat. Në verë dua ta kem një zgjidhje.

Deri tani gjithçka ishte pak frustruese. Në fillim kam shkruar aplikime për zanat si nëpunës i profilit B. Shpresoja se do të ecë puna, sepse gjuha ime amtare është frëngjishtja. Ka tre vjet që jetoj në Zvicrën gjermane, dhe gjermanishtja ime ende nuk është perfekte. Ndoshta për këtë arsye kam marrë vetëm refuzime. Askush nuk më beson se unë mund të mësoj shpejt.

Refuzimet lëndojnë

Refuzimet më lëndojnë dhe kam ndjenjën sikur nuk më dëshiron askush. Kështu më humb dëshira për t'u përpjekur më tutje. Kjo nuk është aspak e thjeshtë, për shkak se edhe prindërit nuk mund të më ndihmojnë. Ata nuk e njohin sistemin zviceran.

Unë e kam zgjeruar kërkimin e vendit për zanat në profesionin tim të zemrës. Po kërkoj një praktikë në lëmin social dhe atë të përkujdesjes. Kështu unë mund t'i perfeksionoj njohuritë e mia të gjermanishtes dhe njëkohësisht të shikoj nëse jam vërtet i përshtatshëm për këtë profesion. Herëdokur dua të bëhem punëtor social dhe të punoj me të rinj. Me dëshirë do të punoja me të rinj të huaj, sepse i njoh problemet e tyre nga përvoja ime.»



KUR ËSHTË OFERTA NDËRLIDHËSE KUPTIMPLOTE?

Oferta ndërlidhëse është një vit i vështirë shkollor. Menjëherë, në javët e para, fillon procesi i zgjedhjes së profesionit dhe kërkimi i vendit për zanat. Ju diskutoni me mësimdhënësin dhe me prindërit tuaj, nëse dhe cila ofertë ndërlidhëse është e drejtë për ju.

Për shembull:

– Ju nuk jeni të sigurt se çka do të bëni pas shkollës. Përmes një oferte ndërlidhëse për zgjedhjen e profesionit, ju merreni edhe njëherë intensivisht me zgjedhjen e profesionit dhe përcaktoheni për një rrugë.

– Ju e dini saktësisht se cilin profesion dëshironi ta mësoni, por nuk keni gjetur ende vendin për të mësuar. Përmes një oferte ndërlidhëse përzgjedhjen e profesionit, njiheni më mirë me fushën e profesionit të dëshiruar dhe zhvilloni alternativa.

– Ju dëshironi të vijoni gjimnazin ose shkollën e mesme profesionale, por njohuritë shkollore ende s'mjaftojnë. Përmes një oferte shkollore ndërlidhëse, ju mund t'i kompensoni mangësitë mësimore dhe në mënyrë të qëllimshme të përgatiteni për provimet pranuese. Nërastin ideal, njëkohësisht ju merreni edhe me çështjen e zgjedhjes së profesionit. Në rast se nuk e kaloni provimin pranues, mund të aplikoni për një vend zanati.

– Ju dëshironi të mësoni një profesion në krijimtari. Për shumicën e arsimimeve krijuese – për arsimim shkollor (në shkollat e lartauniversitare dhe në shkollat e larta profesionale për krijimtari), ashtu si për arsimimin bazë profesional, kërkohet një parakurs.

– Ju e dini saktësisht se çka do të bëni pas shkollës. Njohuritë gjuhësore ende nuk mjaftojnë. Përmes një oferte ndërlidhëse shkollore, ju mund t'i përmirësoni njohuritë tuaja gjuhësore dhe njëkohësisht t'i përsërisni dhe thelloni njohuritë shkollore në lëndët e tjera.



Këshilla dhe sugjerime për prindër

Nëse e hetoni se fëmija juaj – pa marrë parasysh arsyet – ende nuk është i pjekur për zgjedhjen e profesionit, informohuni te mësimdhënësit

ose pranë Këshillimores për Profesione, se cila ofertë ndërlidhëse do të ishte e drejtë për fëmijën tuaj.

Lajmërojeni me kohë fëmijën tuaj për këtë ofertë ndërlidhëse. Nëse ofrohet ndonjë zgjidhje tjetër, përsëri mund ta çlajmëroni.



VANESSA LOPEZ, ZVICËR DHE KANADA
VITI 1-RË
NËPUNËSE PROFILI B

«Unë kam dashur të përmirësohem në përgjithësi: Në nivelin Sekondar B kam qenë nxënëse e mirë, me notë mesatare mbi 5 në dëftesë. ...

Në fillim kam kërkuar vend zanati për eksperte të hotelerisë, sepse kam menduar se në këtë profesion do të punoja vetëm në recepcion. Por, dita e parë e punës provuese i bëri të qarta kushtet reale të punës së një profesionisteje në degën e hotelerisë. U detyrova të riorientohej dhe – shumë vonë gjatë vitit - fillova të kërkoja një vend për të mësuar profesionin e nëpunëses. E kuptova se unë, si nxënëse e Sek B, isha pa kurrfarë shansi për të fituar një vend mësimi në profilin E.

Unë vendosa për të bërë klasën e 10-të. Si më e reja në klasë – sepse isha shumë herët e pjekur për shkollë – ende kisha kohë. Në shkollën për zgjedhjen e profesionit, pas një testi të përshtatshmërisë, isha caktuar të vazhdoja në klasën «Challenge». Kjo klasë ishte një vit shkollor për nxënëset dhe nxënësit të cilët ende nuk e dinin saktësisht se cilin profesion ata/ato duan të ndjekin. Për mua ky vit shkollor ishte perfekt, edhe pse ishte shumë më sfilitës se Sek B.

Objektivat ishin në rregull

Qëllimi i shkollës për zgjedhjen e profesionit është i qartë: secila nxënëse, secili nxënës duhet të ketë një zgjidhje. Në javën e parë ishim në një kamp, ku mësuan se si mund të aplikojmë për vendet e mësimi të profesionit. Që prej javës së dytë, nga ne pritej të shkruajmë dhe dërgojmë së paku tri aplikacione në javë. Këto objektiva ishin në rregull për mua dhe unë arrita shumë shpejt – qysh në shtator – të gjej një vend për mësimin e zanatit si nëpunëse e profilit B në një bankë.

Me kontratën e zanatit në xhep, unë tash mund të përqendrohesha në shkollë dhe në mësim. Ne përsërisnim lëndët shkollore dhe unë kam përmirësuar dukshëm dhe pëfundimisht njohuritë e mia në matematikë. Pastaj kam bërë edhe First Certificate in English FCE – dhe tani, si e vetmja nxënëse në drejtimin komercial të profilit B, jam në gjendje për të mësuar për nivelin Advanced.

Marrja e përgjegjësisë

Unë nuk kam përfitur vetëm nga aspekti shkollor. Unë mendoj se sot jam më pak fëmijërore. Unë kam mësuar që të jem më e hapur, më e sigurt në paraqitje dhe t'u qasem më mirë njerëzve të tjerë. Po ashtu kam mësuar të planifikoj kohën dhe punën time në mënyrë të pavarur. Dhe, reagoj më pak e frikësuar kur përballem me diçka të re. Kjo më ndihmon tani në mësimin e profesionit.

Kurset e përgjithshme jashtë ndërmarrjes për nxënësit e bankës kanë një organizim disi të posaçëm. Ne bëjmë një kurs 30-ditor në Qendrën për Profesionistët e Rinj në fushën e bankave. Ne si nxënës, jemi vetë përgjegjës se për cilat ditë të kurseve lajmërohemi. Nëse unë e organizoj lajmërimin për kurs shumë vonë, ndodh që detyrohem të ndjek kursin në Bazel, Gjenevë ose Lucern, sepse për kursin në Cyrih është plotësuar numri. Natyrisht, nëse ka probleme unë mund të flas me mësuesen e praktikës, por unë jam e lumtur që kam besim në veten time, për të marrë përgjegjësinë për mësimin e profesionit.

**Me një ofertë ndërli-
dhëse të orientuar
në praktikë – paramësim
ose praktikë – ju mund
të përgatiteni veçanë-
risht për mësimin e
profesionit.**



FLETËPALOSJA NË
INTERNET
shih faqe 2

Ofertat ndërlidhëse të orientuara në praktikë

Paramësimi

Paramësimi kombinon teorinë dhe praktikën dhe zgjat 1 vit. Në ndërmarrje njiheni me përditshmërinë e punës, në shkollën profesionale përmirësoni aftësitë tuaja gjuhësore ose përsërisni matematikën e shkollës fillore.

Gjatë paramësimit kërkoni një vend për mësim të zanatit. Ndoshta mund të vazhdoni mësimin e zanatit në ndërmarrjen e paramësimit, por edhe ndoshta detyroheni të kërkoni një ndërmarrje tjetër për të mësuar zanatin.

Praktika

Gjatë praktikës ju njiheni në mënyrë praktike me përditshmërinë e profesionit të zgjedhur. Njëkohësisht i përmirësoni aftësitë tuaja gjuhësore dhe mësoni së bashku me koleget dhe kolegët tuaj edhe dialektin lokal.

Nëse ju pas disa muajsh praktikë jeni të sigurt se ky është profesioni i qëlluar për ju, atëherë filloni të kërkoni vend për mësim të zanatit. Ndoshta mund të qëndroni në ndërmarrjen ku jeni duke bërë praktikën, por ndoshta edhe duhet të shikoni për një vend tjetër për mësim të zanatit.



«Paramësimi për mua është perfekt: Mund të përmirësoj gjermanishten time, të përsëris matematikën dhe njëkohësisht të njihem me botën e punës.» Rohulab




PARAMËSIMI

Paramësimi është një ofertë ndërlidhëse 1-vjeçare, gjatë së cilës përgatiteni në mënyrë praktike dhe shkollore përhyrje në arsimimin bazë profesional. Ju punoni 31/2 deri 4 ditë në një ndërmarrje dhe vizitoni 1 deri 11/2 shkollën. Për punën në ndërmarrje merrni një pagë. Në shkollë paguani vetëm për materialet dhe eventalisht për ndonjë ekskursion. Në çdo semestër vlerësohen rezultatet.

Edhe vendin për paramësim e kërkonti njëjtë sikurse vendin për mësim të zanatit. Këshillimoret për profesione ju përkrahin gjatë kërkimit të një ndërmarrjeje për paramësim. Pasi ta keni gjetur këtë, atëherë personat përgjegjës ju lajmërojnë në shkollën përkatëse. Këta sqarojnë nëse i përmbushni parakushtet për paramësim. Nëse po, atëherë ju e lidhni kontratën për paramësim mendërmarrjen.

Nëse ju përfundoni me sukses paramësimin, atëherë në këtë ndërmarrje mund të bëni një arsimim bazë profesional ose e kërkonti një ndërmarrje tjetër, në të cilën mund të mësoni zanatin.

Mirë është ta dini: Paramësimi nuk është i rregulluar në mënyrë të njëjtë në tërë Zvicrën. Në Zvicrën franceze dhe atë italiane, në të shumtën e rasteve kemi të bëjmë me një ofertë shkollore me praktikë në ndërmarrje.



ROHULLAH RAHIMI, AFGANISTAN
PARAMËSIM
PROFESIONIST I AUTOMOBILAVE

*Mësimi hap pas hapi:
«Edhe pse unë jetoj në Zvicër
vetëm pak më shumë se dy
vjet, unë kam fat: Unë mund
të mësoj profesionin tim të
dëshiruar. ...*

Profesioni i specialistit të automobilave më duket interesant, sepse i pëlqej makinat. Nën një garazh ku kam bërë punë provuese, të gjithë kanë qenë shumë të sjellshëm ndaj meje. Natyrisht se nuk i kam bërë të gjitha punët, por kam testuar shtypjen e ajrit në goma, kam ndërruar pllakat e frenave dhe vajin.

Arsimtari ka menduar se unë duhet të bëj një paramësim, pastaj mund ta përfundoj me sukses zanatin, sigurisht me një provim përfundimtar për zanat. Në shkollën profesionale kam bërë pastaj një provim: matematikë, të menduarit logjik dhe njohuritë gjuhësore.

Unë duhej të shkruaja një letër, pak gramatikë, të lexoja dhe kuptoja një tekst; këto i kam bërë mirë. Matematikën jo edhe aq mirë, por kjo ka mjaftuar. Tash sa jam duke vijuar paramësimin, njëherë në javë shkoj në shkollë. Në shkollë duhet të angazhohem, por ndoshta do të jetë vështirë. Për fat të mirë kam një mentor, i cili do të më ndihmojë për të bërë detyrat.

Ëndrra jetësore e përmbushur

Me këtë paramësim më është përmbushur një ëndërr jetësore. Në Afganistan nuk ka pasur kaq shumë lloje të ndryshme të makinave si këtu, prandaj unë ende nuk i njoh shumë lloje. Por mua më pëlqen Mercedes-Benz, sidomos limuzinat. Po ashtu gëzohem që gjatë mësimit të zanatit do të mund të mësoj të ngas makinën. Nëse përfundoj me sukses shkollën profesionale dhe provimin përfundimtar për zanat, atëherë dëshiroj të punoj, të fitoj para, ndoshta të kem një makinë timen ose një banesë timen. Por, tani të gjitha do t'i bëj hap pas hapi.»

«Gjuha – gur pengese në rrugën time: Jam rritur në Eritre, dhe atje kam ndjekur shkollën për njëmbëdhjetë vjet. ...

Ne në Eritre kemi një sistem të veçantë: Të gjithë nxënësit dhe nxënëset në vitin e dymbëdhjetë të shkollës, duhet të shkojnë në ushtri. Gjatë këtij viti të parë në ushtri, ne mund të bëjmë provimin pranues në universitet. Dhe, vetëm më të mirët e kalojnë këtë provim dhe u lejohej të studiojnë. Por, këta nuk kanë të drejtë të zgjedhin drejtimin e studimeve, kjo u caktohet atyre. Të gjithë të tjerët duhet të mbeten në ushtri, të punojnë tërë jetën për pak të holla, sa nuk mund të jetojnë financiarisht të pavarur.

Këtë mënyrë të jetës nuk kam mundur ta paramendoj, sepse kam dashur patjetër të jem e pavarur në vendimmarrjen për vete. Për këtë arsye kam ikur në Zvicër. Vetëm babai, nëna dhe vëllezërit e mi kanë mbetur

në Eritre. Nuk ishte e lehtë, sepse më mungojnë dhe ndihem shumë e vetmuar. Për fat të mirë shpejt kam gjetur shokë dhe shoqe, në kampet e refugjatëve në strehimoret e azilit, në kurset e gjuhës dhe në kursin e integritimit.

Unë dua të integrohem këtu në Zvicër sa më shpejt që të jetë e mundur, personalisht dhe profesionalisht. Kam mësuar gjuhën dhe kam ndjekur pastaj një kurs intensiv të integritimit. Në këtë vit shkollor kam menduar me përkushtim për zgjedhjen e një profesioni. Kam shikuar profesione të ndryshme, por në fund ajo që ka mbetur gjithmonë ka qenë profesioni i specialistes shëndetësore ajo që më ka interesuar.

Në fakt, unë me kënaqësi do të kërkoja një vend për mësimin e zanatit, por për këtë është dashur të bëj testin e përshtatshmërisë. Dhe unë mendoj se këto dy vjetët e fundit kam bërë shumë përparime në gjuhë, por jo aq sa për të kaluar me një rezultat të mirë testin.

Përgatitja e qëllimtë

Prandaj kam vendosur që nëpërmjet një praktike të përgatitem për arsimim profesional si specialiste për shëndetësi. E paramendoj se gjatë këtij viti në punë do të mësoj mirë, sidomos dialektin vendor. Njëkohësisht dua të ndjek edhe një kurs të gjuhës dhe ndoshta të bëj edhe diplomën gjuhësore.

Për mua, kjo është një rrugë e mirë, jo vetëm për shkak të gjuhës. Në praktikë unë e shoh se si funksionon bota profesionale dhe ajo e punës në Zvicër, çka është me rëndësi në bashkëpunim me të tjerët dhe si mund të integrohem më së miri profesionalisht. Dhe unë jam e sigurt, se do të njoftohem me shumë njerëz dhe se do të mund të flas shumë me kolege dhe kolegë. Të gjitha këto do të më ndihmojnë, që pastaj me sukses ta kryej arsimimin bazë profesional për specialiste të shëndetësisë. Edhe nëse kjo zgjatë pak më shumë, unë e di se do të punoj në profesionin tim të zgjedhur.»

RUTH GIRMAY, ERITREA
PRAKTIKA SI PËRGATITJE PËR
ZANATIN E PROFESIONISTES SË SHËNDETËSISË





PRAKTIKA SI PËRGATITJE PËR ARSIMIMIN BAZË PROFESIONAL

Arsimimin bazë profesional, zakonisht mund ta filloni menjëherë pas përfundimit të shkollimit të detyrueshëm, nëse i përmbushni kërkesat për profesion pa ndonjë zgjidhje të ndërmjetme, pa praktikë. Në raste të jashtëzakonshme një praktikë ia vlen:

– Ju dëshironi të mësoni një profesion mjekësor ose shoqëror, por nuk jeni të sigurt nëse jeni të përshtatshëm për të, ndërsa për një punë provuese koha është tepër e shkurtër që të mund të vendosni. Me një praktikë njëvjeçare ju përgatiteni për kërkesat, të cilat i parashtrajnë këto fusha profesionale.

– Ju nuk jetoni gjatë kohë në Zvicër; njohuritë tuaja të gjuhës lokale ende nuk janë të përkryera. Me një praktikë ose një paramësim ju përmirësoni njohuritë tuaja gjuhësore.



FLETËPALOSJA NË
INTERNET
shih faqe 2

Përfundimi me sukses i arsimimit bazë profesional është një hap i parë i rëndësishëm në rrugën e karrierës suaj profesionale dhe, shënon kalimin nga arsimimi profesional në karrierën profesionale. Tani ju mund të punoni dhe të zgjeroni aftësitë tuaja profesionale në mënyrë praktike. Ose ju kombinoni punën tuaj me një arsimim përcjellës profesional krahas punës, thelloni kompetencat tuaja me një ngritje të mëtutjeshme shkollore ose përgatiteni për diplomim në një shkollim të lartë profesional. Me një maturë profesionale mund të vijë në shprehje edhe një studim në shkollë të lartë universitare.

Ky kapitull u dedikohet të huajave dhe të huajve, të cilët janë duke absolvuar një arsimim bazë profesional/ zanat dhe duan të dinë se, cilin formim të mëtejshëm duan ta implementojnë pas përfundimit të arsimimit të tyre. Ka edhe informacione për zgjedhës ose zgjedhëse të profesionit në nivelin Sekondar I (dhe për prindërit e tyre), mbi mundësitë e ndryshme të zhvillimit të mëtutjeshëm pas një arsimimi profesional.

Modelimi i karrierës profesionale

Çfarë pas arsimimit bazë profesional?

Faqe

- 74 **Punësimi ose arsimimi?**
- 75 *Roswitha Burri, Zvicër, nëpunëse me referat për Sigurimin e Pleqërisë dhe të Trashëgimtarëve dhe Sigurimin e Invaliditetit*
«Mësim po – shkollë jo»
- 76 **Mësimi i shkurtuar pas Atestit Federal të Profesionit**
- 78 **Arsimimi i dytë bazë profesional**
- 79 *Nicole Fankhauser, Zvicër, mjeshtrë e hidraulike me diplomë federale*
«Profesioni i parë – jo pikërisht ai i duhuri»
- 80 **Matura pas mësimit të zanatit**
- 81 *Kim Lang, Zvicër, Shkolla e Maturës Profesionale 2*
«Të mësosh gjithmonë me kënaqësi»
- 82 **Shkollim i mëtejshëm, studimet**
- 83 **Provimi profesional dhe provimi i lartë profesional**
- 84 *Marius Pinsini, Itali, kopshtar i lartë me provim profesional, me ndërmarrje të vet të kopshtarisë*
«Të udhëheqësh ndërmarrjen tënde»
- 85 *Qendrim Elmazi, Kosovë, bashkëpunëtor komercial*
«Studimi me shumë praktikë»
- 86 **Shkolla e Lartë Profesionale**
- 87 *Evgeniya Schnidrig, Rusi, parapraktikë për Shkollën Profesionale të Hotelerisë*
«Unë dua përgjegjësi në profesion»
- 88 *Frank Vega Bonne, Kubë, Shkolla e Lartë Profesionale e Infermierisë*
«Rruga e gjatë për në cak»
- 89 **Shkolla e Lartë Universitare, Shkolla e Lartë Pedagogjike**
- 90 *Kaouther Mraïhi, Tunizi, praktikë për parapërgatit për studime në një Shkollë të Lartë Universitare*
«Të studiosh me korespondencë»
- 91 *Alicia Ledergerber, Zvicër / Spanjë, studimet e restaurimit në Shkollën e Lartë Universitare*
«Patjetër duhet lidhur teorinë me praktikën»
- 92 **Universiteti dhe Shkolla e Lartë Federale Teknike ETH/EPF**
- 93 *Roger Herrigel, Zvicër, gjeomatikë me Certifikatë Federale të Aftësimin, informatikë Shkolla e Lartë Universitare, fizikë ETH/EPF*
«Studimi në ETH/EPF si rrjedhë logjike»

Pas përfundimit të arsimimit bazë profesional me Atestin Federal të Profesionit ose me Certifikatën Federale të Aftësimit, ju keni disa mundësi të hapura: Një vend pune, një arsimim bazë profesional shtesë, marrja e mëvonshme e maturës profesionale, përgatitja për provimin profesional, studimet nënjë shkollë të lartë profesionale ose në shkollëtë lartë universitare.



FLETËPALOSJA NË INTERNET
shih faqe 2

Punësimi ose arsimimi?



MBLEDHJA E PËRVOJËS PRAKTIKE

Me sistemin aktual arsimor është më pak e rëndësishme se cilën rrugë të arsimimit ose cilin profesion keni zgjedhur. Shumë më me rëndësi është si i shfrytëzoni mundësitë dhe shanset e ofruara. Sa më mirë që jeni të arsimuar, aq më e qëndrueshme është pavarësia juaj financiare, aq më shpejt mund të arrini një baraspeshë optimale mes punës dhe jetës, aq më mirë mund të reagoni në fazat e vështira të jetës me sëmundje, papunësi ose ndarjes (divorcit).

Ndoshta dëshironi të punoni menjëherë pas arsimimit bazë profesional. Ju doni të fitoni të holla të mjaftueshme për të bërë një jetë të pavarur edhe në aspektin financiar. Ndoshta dëshironi – të paktën për momentin – të mos vijoni më shkollimin, dhe më me dëshirë doni të mblidhni përvoja praktike dhe të përgatiteni për karrierën tuaj profesionale.

APLIKIMET PËR NJË VEND PUNE

Për aplikim për një vend pune nuk ka receta universale. Bisedoni me miq, mikësja dhe të njohurit dhe tregoni atyre se çfarë pune jeni duke kërkuar dhe çka jeni duke planifikuar. Përdorni rrjetet tuaja. Shumë vende të lira të punës plotësohen në këtë mënyrë. Lidhjet edhe në këtë hap janë të dobishme. Në internet do të gjeni shumë këshilla të dobishme në lidhje me kërkimin e vendit të punës, tregun e punës dhe procesin e aplikimit.

NGRITJA E MËTEJSHME NË NDËRMARRJE

Pas arsimimit bazë profesional ju punoni. Në ndërmarrje ndiheni shumë mirë, punoni me kënaqësi me kolegët dhe kolegët e punës së bashku dhe detyrat tuaja janë interesante. Ju dëshironi të merrni më shumë përgjegjësi, por në këtë moment nuk dëshironi të ndiqni ndonjë ngritje të mëtejshme shkollore. Para së gjithash, kompanitë më të mëdha kanë oferta të brendshme të arsimimit të mëtejshëm. Pyetni në ndërmarrje, nëse mund të vijoni ndonjë ngritje të mëtejshme brenda ndërmarrjes ose nëse ekziston mundësia e kualifikimit në vendin e punës.

MBËSHTETJA E NDËRMARRJES PËR NGRITJE TË MËTEJSHME JASHTË NDËRMARRJES

Nëse thelloni ose zgjeroni përgatitjen tuaj profesionale me një ngritje të mëtejshme, nga kjo përfiton gjithashtu edhe punëdhënësi juaj. Sqaroheni me ndërmarrjen tuaj, nëse e mbështet këtë ngritje të mëtejshme financiarisht, ose duke ju mundësuar vijimin e arsimimit gjatë orarit të punës.

Mësim po – shkollë jo: «Edhe pse unë në të vërtetë nuk kisha ndonjë ide konkrete se çka më pret, vendosa të bëj një arsimim në degën komerciale KV të profilit E. ...»

Mësimin e zanatit e bëra në një ndërmarrje shoqërore, e cila angazhohet për riintegrimin e njerëzve të shtresës së dobët shoqërore. Zanati më pëlqente shumë, lëndët ishin me përmbajtje të gjerë dhe shumë interesante dhe ndieja se ndërmarrja ku mësoja zanatin bënte diçka shumë kuptimplote. Pas mbarimit të zanatit më është dashur disa kohë, derisa kam gjetur një punë. Është dashur shumë këmbëngulje derisa gjeta një ndërmarrje e cila ishte e gatshme t'i jepte një shans një personi të sosediplomuar dhe pa përvojë pune.

Unë punoja 100 për qind dhe çdo të shtune shkoja tetë orë në shkollë dhe ndiqja mësimin për Këshilltare të të Ushqyerit me Diplomë, të cilin unë e përfundova me sukses. Gjatë një udhëtimi gjysmëvjeçar nëpër Azi, kam menduar për të ardhmen time profesionale.

Dëshira ime është të punoj si këshilltare ushqimore në lëmin e parandalimit ose si mentore për të rinjtë e moshës madhore. Kështu mund ta paramendoja të ardhmen time profesionale. Gjatë qëndrimit në Azi kam menduar, që pas kthimit në Zvicër të filloj të punoj me orar të shkurtuar – sepse unë duhet të siguroj jetesën time – dhe njëkohësisht, si e pavarur të ofroj këshillime në lëmin e të ushqyerit.

Kur u ktheva, fillova të punoj 90 për qind si nëpunëse për shërbime shtesë të Sigurimit të Pleqërisë dhe të Trashëgimtarëve / Sigurimit Invalidor. Është një fushë interesante e punës, por unë është dashur të mësoj me shumë përkushtim për ligjet dhe kushtet për kualifikim për të drejtën e përfitimeve shtesë në këtë lëmi, që kërkonte nga unë shumë energji dhe përkushtim. Për të tjerat nuk mbeti shumë kohë dhe energji.

Por ëndrra ime ende është e gjallë. Me shumë kënaqësi dua të investoj në të ardhmen e njerëzve, si në lëmin e ushqimit ose në shoqërimin e të rinjve në rrugën e tyre për në botën e të rriturve. Rruga më e shpejtë për të arritur këtë qëllim do të ishte një shkollë e lartë universitare. Por mua nuk më pëlqen të shkoj në shkollë. Unë vuaj nga ADHS (çrregullim i mungesës së vëmendjes) dhe nuk mund të përqendrohem në arsimimin shkollor. Kjo rrugë do të më shkaktonte shumë vështirësi dhe unë nuk do të ndjehesha e lumtur.

Me punë vullnetare më afër qëllimit

Por ndoshta qëllimit do t'ia arrij edhe ndryshe, në një udhë më praktike. Për këtë arsye punoj si vullnetare në organizata të ndryshme, si mentore për mbështetje në arsimim, për një këshillimore kishtarë jam aktive në këshillim për përpilimin e buxhetit, si mentore private përcjell dhe përkrah të rinjtë në rrugën e tyre drejt pavarësisht. Unë investoj kohën time të lirë për mbledhjen e kompetencave profesionale, për ngritjen time të mëtutjeshme në mënyrë praktike. Njëkohësisht bëj atë që bëj me kënaqësi dhe kjo më ofron shumë kënaqësi jetësore.

Unë shpresoj se tregu i punës e shpërblen edhe këtë rrugë të ngritjes së mëtutjeshme dhe, ndoshta përvojat e mia praktike do të barazvlerësohen me diplomat shkollore. Në botën e punës kërkohen në rend të parë njerëz të cilët punojnë mirë dhe me kënaqësi, e unë e bëj këtë.»

ROSWITHA BURRI, ZVICËR
PROFILI KV E, NËPUNËSE
SHËRBIMET SHITESË PËR SIGURIMIT TË PLEQËRISË DHE
TË TRASHËGIMTARËVE / SIGURIMIT INVALIDOR



Një karrierë profesionale mund të realizoni hap pas hapi, duke u bazuar në arsimimin bazë profesional me Atest Federal të Profesionit. Pas përfundimit të Atestit Federal të Profesionit, doni të vazhdoni të mësoni. Ju vendosni të bëni një shkollim të shkurtuar për Certifikatën Federale të Aftësimit.

Mësimi i shkurtuar pas Atestit Federal të Profesionit

«E kam ditur gjithmonë, se pas shkollimit për Atestin Federal të Profesionit, do t'ia bashkëngjis edhe zanatin. Megjithatë, hyrja e rehatshme në botën e punës, me këtë zanat dyvjeçar, ka qenë shumë e drejtë.» Sonja




MËSIMI I SHKURTUAR I PROFESIONIT

Parimisht, të gjithë të interesuarit, të cilët kanë prirje praktike për profesionin e dëshiruar, mund të shfrytëzojnë mundësinë, që pas një arsimimi 2-vjeçar për Atestin Profesional (p.sh. si i/e punësuar në kuzhinë me Atest Federal të Profesionit), të shkurtojë mësimin e zanatit për Certifikatë Federale të Aftësimit (p.sh. kuzhinier/ kuzhinierë me Certifikatë Federale të Aftësimit), pra të kalojnë në vitin e 2-të të arsimimit për Certifikatë Federale të Aftësimit. Nuk ekzistojnë kërkesa të veçanta e as udhëzime për mësim të shkurtuar për Certifikatë Federale të Aftësimit. Kryesisht kjo mundësi sigurisht u dedikohet personave, të cilët kanë rezultate të mira gjatë shkollimit dhe, ekzistojnë profesione të veçanta, për të cilat një mënyrë e tillë e arsimimit të shkurtuar nuk është e mundur.

Zakonisht, në semestrin e 4-t për arsimimin për atest, kërkoni të bisedoni me personin përgjegjës në ndërmarrjen mësimore dhe me mësimdhënësin në shkollën profesionale. Nëse edhe këta janë të mendimit se jeni i përshtatshëm për të bërë mësim shtesë, atëherë përpiquni që para përfundimit të arsimimit për atest, të lidhni një kontratë të re për mësim të zanatit.

Enti për Arsimimin Profesional miraton këtë kontratë të re të mësimit të profesionit me kusht, që ju procedurën e kualifikimit për arsimin e parë për atestin profesional ta mbaroni me sukses.





Aleksandra Nikic, nëpunëse me Certifikatë Federale të Aftësimi

Thëllim i njohurive profesionale: «Pas mbarimit të arsimimit me Atest Federal të Profesionit për asistente-nëpunëse, kam mbaruar arsimimin e shkurtuar si nëpunëse me Certifikatë Federale të Aftësimi dhe tani punoj te një arkë e sigurimit shëndetësor. ...»

Me arsimimin shtesë si nëpunëse kam mundur të zgjeroj dhe thelloj njohuritë e mia në ekonomi, kontabilitet, anglisht dhe frëngjisht. Tani kam shanse më të mira në tregun e punës dhe më janë hapur mundësitë për shumë ngritje të mëtejshme. Patjetër dua të vazhdoj të ngrihem edhe më shumë.»



Luca Gallo, nëpunës me Certifikatë Federale të Aftësimi

Kontakte të shumta me klientë:

«Pas mbarimit të arsimimit me Atest Federal të Profesionit si asistent-nëpunës dhe pastaj të arsimimit për nëpunës me Certifikatë Federale të Aftësimi, punoj si deklarues i doganës në një ndërmarrje të shpedicionit dhe doganimit. ...»

Unë bëj doganimin e importeve dhe eksporteve dhe në rast të mungesës së dokumenteve bëj doganimin e përkohshëm, u përgjigjem pyetjeve të klientëve dhe përpunoj dërgesat-pranimet. Në punën time më pëlqen se është e shumëllojshme dhe e larmishme. Dhe kam shumë kontakte me klientë.»



Stephanie Hess, specialiste e shitjes me pakicë me Certifikatë Federale të Aftësimi

Ndryshimi i Departamentit:

«Më herët kam pasur vështirësi në shkollë. Mirëpo, arsimimi për asistente në shitje me pakicë me Atest Federal të Profesionit doli më i lehtë se e kam paramenduar. ...»

Dhe kështu e bëra edhe arsimimin për Certifikatën Federale të Aftësimi, si specialiste e shitjes me pakicë. Atëkohë punoja në repartin e luleve të një shpërndarësi-shitës i madh. Pas arsimimit të dytë ndërrova repartin: nga kozmetika në veshmbathje e deri te lojërat, kam të bëj me të gjitha mallrat e mundshme dhe kjo më pëlqen mua.»



Nathalie Laub, specialiste e shitjes me pakicë me Certifikatë Federale të Aftësimi

Dy diploma: «Pas diplomimit me Atest Federal të Profesionit për specialiste e shitjes me pakicë, kam bërë edhe arsimimin shtesë si specialiste e shitjes me pakicë me Certifikatë Federale të Aftësimi. ...»

Tash i kam dy diploma në xhep. Kjo u pëlqen edhe punëdhënësve. Fillimisht kam punuar në shitore të letrës për zyrë. Në departamentin e punëdores kam mundur t'i këshilloj klientët në mënyrë kreative. Kjo ishte kënaqësi. Mirëpo, pastaj desha të bëja diçka tjetër dhe fillova të punoj në mishtore.»

Arsimimi i dytë bazë profesional

Ndoshta gjatë arsimimit bazë profesional keni kuptuar se keni zgjedhur profesionin e gabuar. Ndoshta në moshën 16-vjeçare ju nuk keni pasur vetëbesim për profesionin e ëndërruar. Ndoshta gjatë viteve të fundit kanë ndryshuar dhe janë zhvilluar interesat tuaja në mënyrë të konsiderueshme, ju kanë shtyrë t'i jepni një drejtim krejt tjetër karrierës suaj profesionale. Prandaj keni vendosur për një mësim të dytë profesional.



MËSIMI I DYTË I PROFESIONIT

Parakusht për çdo mësim të profesionit shtesë është përfundimi me sukses i provimit përfundimtar të zanatit. Pastaj i keni dyert e hapura për të gjitha arsimimet bazë profesionale. Si floktare me Certifikatë Federale të Aftësisimit ju mund të mësoni edhe profesionin e një specialiste shëndetësore, ose si maturante të mësoni profesionin e informatikës me Certifikatë Federale të Aftësisimit. Krejt çfarë ju duhet është një ndërmarrje, e cila pranon t'ju arsimojë në profesion.

Nëse keni gjetur ndërmarrjen për mësim të zanatit, atëherë bisedoni me të gjithë përgjegjësit (në ndërmarrje dhe në Entin për Arsimim Profesional të Kantonit tuaj), nëse mund të shkurtoni këtë shkollim profesional për një vit. Ligjëratat e arsimimit gjithpërfshirës do t'ju lejohen, megjithatë vijoni shkollën profesionale një ditë në javë. Nëse e shkurtoni zanatin nga gjashtë në katër semestra atëherë ju pjesërisht do të vijoni mësimin e lëndëve profesionale të dy semestrave njëkohësisht. Nëse hiqni dorë nga shkolla profesionale, atëherë mund

të mësoni lëndët profesionale të profesionit të dytë në mënyrë të pavarur. Kjo mund të jetë shumë interesante për ju në aspektin e pagës, sepse si i punësuar fitoni më shumë se një shegert.

Nëse e zgjedhni këtë rrugë, çdo shkollë profesionale mund t'ju informojë për librat dhe tekstet përkatës shkollorë.

«Qysh gjatë mësimimit të zanatit të parë kam vërejtur se nuk është profesioni i duhur për mua. Por unë e kam çuar deri në fund. Mirëpo, në vitin e fundit të mësimimit të zanatit kam kërkuar dhe kam gjetur një vend për mësim të profesionit tim të dëshiruar.» Willi

Profesioni i parë – jo pikërisht ai i duhuri: «Sa isha në nivelin e dytë të lartë, desha të fitoja para për të blerë një biçikletë të re dhe gjeta një punë gjatë pushimit në një ndërmarrje hidraulike, e cila i përkiste babait të koleges sime më të mirë në shkollë. ...

Gjatë këtyre dy javëve, kam fituar jo vetëm para, por po ashtu u njoftova me një profesion, i cili përshtatej me aftësitë dhe interesat e mia. Mirëpo, unë nuk pata guxim në atë kohë, si e vetmja femër, për të mësuar zanatin e hidraulikes. Unë mësova profesionin e shitëses me pakicë. Mirëpo, sose diplomova në degën e tregtisë, kalova dhe bëra një zanat të dytë si hidraulike me Certifikatë Federale të Aftësimit.

Në shkollën profesionale kam qenë femra e parë në përgjithësi. Meqë isha pak më e vjetër dhe kisha bërë përvojat profesionale si shitëse, munda t'i përballoja sfidat, si dhe fjalët dhe sjelljet e pagdhendura në kantier. Unë isha e kënaqur, që më në fund munda të bëja atë që më pëlqente, të punoja

me metale. Dhe, të shihja për çdo mbrëmje frytet e punës time ditore.

«Profesioni i duhur për mua»

Profesioni i hidraulikes ishte profesioni i duhur për mua. Pasi isha e gatshme të merrja përgjegjësi, shumë shpejt pas diplomimit kisha mundësinë për të udhëhequr punimet nëpër kantiere të vogla të ndërtimit dhe pastaj – pas një përvoje pak më të madhe – të trajnoja shëgertët e rinj dhe të udhëhiqja një ekip të montimit.

Prandaj, pas disa vjetësh përvoje profesionale fillova përgatitjen rreth dy- vjeçare për Provimin e Lartë Profesional. Unë vazhdoja të punoja 100 për qind, njëkohësisht ndiqja bllok-kurset dy-tri javore, ku thelloja atë që kisha mësuar në studimin e pavarur intensiv, për të cilën kam shpenzuar dy herë më shumë kohë sesa për kurset përgatitore.

Menaxhimi i kohës i vështirë

Mësova procedurat e komplikuar të normave të degës, bazat e llogaritjeve dhe të kontabilitetit ose përpiloja me kompjuter programe të vizatimit për plane të komplikuar të montimit. Me pak fjalë, mësoja gjithçka që ishte e nevojshme për të menaxhuar një ndërmarrje. Sigurisht se menaxhimi i kohës nuk ishte gjithmonë i lehtë, sepse në ndërmarrje mora më shumë përgjegjësi, por patjetër duhej gjetur kohë edhe për të mësuar.

Sot jam e gjithanshme. Unë jam përgjegjëse për administratën, bëj oferta normale dhe për tenderë me planet e detajuara të punimeve të montimit dhe jam përgjegjëse për kontabilitetin, pagat, për debitorët dhe kreditorët, mbikëqyr reklamat dhe brenda ndërmarrjes jam përgjegjëse për siguri. Po ashtu kujdesem për shëgertët, të cilët e mësojnë profesionin e hidraulikut dhe jam e përkushtuar që hidrauliket dhe hidraulikët e ardhshëm të kenë një përgatitje të fortë profesionale në ndërmarrjen tonë. Në kohën time të lirë angazhohem edhe në shoqatën e zejtarëve.»

NICOLE FANKHAUSER, ZVICËR
MJESHTRË E HIDRAULIKE ME DIPLOMË FEDERALE



Ju me hapin e parë jeni përqendruar në shkollimin profesional. Pas përfundimit të suksesshëm të provimit, megjithatë të mësuarit duhet të vazhdojë. Ju prandaj doni të bëni maturën profesionale, në mënyrë që të mund të studioni në një shkollë të lartë universitare. Ose të bëni maturën e gjimnazit, që të mund të studioni nënndonjë universitet.

Matura pas mësimit të profesionit



MATURA PROFESIONALE SI I RRRITUR

Ju përqendrohni së pari në arsimimin bazë profesional dhe bëni maturën e dytë profesionale, pas provimit përfundimtar të profesionit.

Maturën e dytë profesionale mund ta bëni me korrespondencë, sa jeni duke punuar (4 deri në 6 semestra) ose në një shkollë me orar të plotë (1 vit). Kushtet për praninë në këtë arsimim janë të ndryshme. Disa kantone kërkojnë vetëm një notë minimale mesatare në dëftesën e shkollës, kantonet e tjera kërkojnë provime pranuese (zakonisht në gjuhë dhe matematikë) dhe një bisedë plotësuese. Në shumicën e shkollave të maturës profesionale ekzistojnë kurse përgatitore për provimin pranues.

MATURA E GJIMNAZIT PËR TË RRRITUR

Si i rritur ju mund të bëni edhe një maturë të gjimnazit. Në këtë rast vlejnjë kushte të ngjashme sikurse edhe për maturën profesionale (shih më lart).

KOSTOJA PËR MATURËN E DYTË PROFESIONALE DHE MATURËN E GJIMNAZIT

Nëse si i rritur doni të mbaroni maturën profesionale ose maturën e gjimnazit, atëherë këtë mund ta bëni me orar të plotë ose duke punuar. Të dy rrugët kërkojnë përkushtim dhe shumë qëndrueshmëri.

Ekzistojnë ofrues publikë dhe privatë të arsimimit me maturë. Ofruesit publikë kërkojnë që ju të kaloni me sukses procedurat e pranimit; në këtë rast, arsimimi për personat të cilët banojnë së paku dy vjet në kanton, zakonisht është falas. Personat e interesuar, të cilët jetojnë jashtë kantonit përkatës, si dhe të gjithë ata të cilët maturën e kryejnë të një ofrues privat, duhet të llogarisin përafërsisht me shpenzime prej 10'000 deri në 20'000 franga në vit.

Sidoqoftë, ia vlen të sqaroni saktësisht se cilat mundësi janë të hapura për ju. Në Qendrën Informative për Profesionet të rajonit tuaj gjeni informacionet për maturat federale për të rritur, mbi shkollat e maturës profesionale, për maturën e dytë profesionale, si dhe mbi shkollat përgatitore në rajonin tuaj.

Të mësosh gjithmonë me kënaqësi: «Fillimi i karrierës sime profesionale ka qenë i lidhur ngushtë me sportin, sepse unë kam ndjekur United School of Sports në Cyrih. ...

Në dy vjetët e para të arsimimit tim si nëpunëse kam qenë në gjendje të lidh në mënyrë optimale shkollën me volejboll, ndërsa në dy vjetët e fundit me një praktikë prej 60 për qind. Kjo ishte një kohë intensive. Unë jo vetëm jam angazhuar për arsimimin tim profesional, por njëkohësisht kalova nga një klub i ligës së tretë në Ligën Nacionale B dhe kam rritur programin tim të stërvitjeve jashtëzakonisht shumë. Në moshën 18-vjeçare jam ndarë nga familja ime që më ka mbështetur shumë. Tash gjendem në një banesë të përbashkët me lojtare të tjera të volejbollit dhe më duhet të përballem me këtë situatë.

KIM LANG, ZVICËR
SHKOLLA E MATURËS PROFESIONALE 2
NËPUNËSE



Praktikën time për nëpunëse, pas dy vjetëve shkollim, me gjithë dëshirë do ta kisha bërë në televizion, gazetën Tages Anzeiger ose në revistën Annabelle. Për fat të keq, unë mora vetëm refuzime. Përgjegjësit e United School of Sports më rekomanduan të bëja një praktikë në një bankë. Për mua kjo ishte një sfidë, sepse atë kohë unë interesohesha shumë pak për ekonominë. Ishte një vendim i drejtë, unë mësova shumë dhe kisha përkrahje të përkryer.

Kam punuar 60 për qind në bankë, njëkohësisht isha anëtare e skuadrës A të Voleros, stërvisja dhjetë herë në javë dhe nga bashkëjetesa me koleget e mia volejbolliste kam mësuar si funksionon sporti profesional. Isha vetë përgjegjëse për menaxhimin e kohës sime, për ndryshimin e vazhdueshëm midis sportit profesional dhe nevojave private. Natyrisht, këtu nuk mbetej shumë kohë për familjen time, për shoqet dhe shokët e mi.

Pas provimit të fundit profesional kam bërë një analizë të situatës personale. Sporti më ka dhënë shumë, kam fituar kompetenca shoqërore, unë mund të organizoj dhe menaxhoj veten dhe kohën time, unë mund të pushoj edhe kur stresi është i lartë dhe kam mësuar shumë për të ushqyerit dhe për trupin tim. Me ekipin kam mësuar që t'i formuloj objektivat dhe së bashku për t'i arritur ato, të kesh sukses, të luash përpara një publiku entuziast dhe mbështetës. Këto janë ndër gjërat më të bukura që kam përjetuar. Megjithatë, përditshmëria e sportit profesional ishte e vështirë, ndryshimi i vazhdueshëm midis stërvitjeve intensive dhe fazave të regjenerimit nuk më përshtatej. Edhe fakti, se unë në çdo kohë mund të lëndohesha ndikoi në vendimin tim.

E hapur për rrugë të reja

Unë zgjodha rrugën e karrierës profesionale dhe vendosa të bëja maturën profesionale. Pasi që në provimin e fundit të diplomës kisha notë të mirë, u pranova në maturë pa provim pranues. Njëkohësisht banka më ofroi një punë të përhershme.

Që në dy muajt e parë pashë se isha në vendin e gabuar. Dhe përsëri fillova të kërkoja punë në fushën e publicistikës dhe këtë herë isha me fat. Unë punoj 60 për qind dhe shkoj dy ditë në shkollë. Edhe njëherë më shumë janë zhvilluar dhe ndryshuar interesat e mia. Ndoshta në këtë fushë i detyrohem sportit, unë jam gjithmonë e hapur për rrugë të reja, jam në gjendje të mendoj edhe jashtë kornizave të zakonshme dhe nuk jam e detyruar që gjithmonë të qëndroj në rrugën e njëjtë, por unë jam e fokusuar dhe në mënyrë ambicioze mund të angazhohem për planet e mia.

Unë me kënaqësi do të studioja arkitekturë, dizajn ose komunikim ndërkombëtar, e kjo nuk është e mundur me maturë profesionale nëpunësie. Prandaj unë e bëra provimin pranues në shkollën e maturës profesionale për krijuese dhe filloj mësimin këtë verë.»

Pas arsimimit bazë profesional, me ose pa maturë profesionale, ju keni mundësi të ndryshme të hapura për arsimim të mëtejshëm ose studime. Nëse i përmbushni kushtet, pas disa vjetësh përvoja profesionale, ju mund të filloni një arsimim të mëtejshëm më sfidues.

Shkollim i mëtejshëm, studimet

Oferta e arsimimit të mëtejshëm në nivelin terciar është e shumëllojshme:

Provimet profesionale me Certifikatë Federale të Profesionit

Thellim i njohurive profesionale në profesion dhe përgatitja për detyra drejtuese.

Provimet e larta profesionale me diplomë federale

Kualifikimi për kuadro në pozita drejtuese ose për udhëheqjen e ndërmarrjes suaj.

Shkollat e larta profesionale

Njohuri teorike dhe praktike për një pozicion për kuadro të ulët.

Shkollat e larta universitare dhe shkollat e larta pedagogjike

Përfundimi me Bachelor (pas 3 vjetësh vjetësh), Master (pas 2 vjetësh shtesë)

Universitetet, Shkolla e Lartë Teknike Federale ETH/EPF

Përfundimi me Bachelor (pas 3 vjetësh), Master (pas 2 vjetësh shtesë)



SI DUHET TË VEPRONI GJATË PLANIFIKIMIT?

Merrni kohë për të vendosur në cilin institucion arsimor dëshironi të bëni ngritjen dhe arsimimin e mëtejshëm dhe përgatituni për këtë:

- Shiko saktësisht broshurat informative të institucioneve arsimore, dokumentet, paraqitjen në internet.
- Vizito tubimet informative.
- Vizito leksionet provuese. Kështu njohoheni me mësimdhënësin dhe kualifikimet e tyre, diskutoni me pjesëmarrësit, nëse dokumentet dhe infrastruktura janë adekuate.
- Pyetni shoqet, shokët, të njohurit nëse ata i njohin institucionet arsimore, dhe çka mendojnë për to.
- Pyetni institucionin arsimor për referenca. Telefononi me absolventet dhe absolventët e mëhershëm: pyetni ata nëse u ka ndihmuar profesionalisht dhe personalisht ky arsimim i mëtejshëm? A do të zgjidhnin sërish këtë drejtim të studimeve ose këtë kurs?
- Sqaroni nëse për arsimim ose ngritjen e mëtejshme mund të kërkohen bursa.

Provimi profesional dhe provimi i lartë profesional

Ofrohen më shumë se 400 provime të ndryshme profesionale ose provime të larta profesionale. Provimi profesional përmbillet me një Certifikatë Federale të Profesionit, provimi i lartë profesional me një Diplomë Federale.



ÇFARË ARRINI JU ME NJË PROVIM PROFESIONAL OSE ME NJË PROVIM TË LARTË PROFESIONAL?

Provimi profesional kombinon përvojën e mirëfilltë praktike me njohuri teorike dhe gëzon një reputacion të shkëlqyer në ekonomi. Natyrisht se ky angazhim shpaguehet edhe financiarisht: të diplomuarat dhe të diplomuarit e suksesshëm të provimeve profesionale mund të kërkojnë një pagë më të lartë, sepse me përgatitjen për këto provime, kualifikohen për detyra më të vështira dhe me më shumë përgjegjësi. Për shembull,

- Për funksione kuadrosh, në të cilat ata udhëheqin bashkëpunëtorë,
- Për detyra në arsimimin e nxënësve në profesion,
- Për detyrat që kanë të bëjnë me menaxhimin e ndërmarrjes.

Një tjetër hap ju e bëni kur të përgatiteni për provimin e lartë profesional. Edhe për këtë provim federal kërkohen disa vjet përvojë pune. Provimi i lartë profesional, me plot të drejtë, është i njohur sidomos në mjedisin artizanal, si «provim për mjeshtër» dhe po ashtu shpërblehet me një kompensim përkatës financiar. Me provimin e lartë profesional arrihen kualifikime, të cilat bëjnë të mundshëm të:

- drejtoni ndërmarrjen e themeluar nga ju vetë,
- arsimoni nxënës zanati në mënyrë pavarur,
- «merrni» përsipër detyra në nivelin e menaxhmentit të mesëm në ndërmarrje më të mëdha.

ÇFARË PROVIMI PROFESIONAL OSE PROVIM TË LARTË PROFESIONAL SILLNI JU?

Kurset përgatitore me korrespondencë (krahas punës), të cilat zakonisht organizohen nga organizata punuese, shkollat profesionale ose institucionet e tjera arsimore, bëhen në baza vullnetare, por për përfundimin me sukses të provimeve federale zakonisht janë të domosdoshme.

Si parakusht për të hyrë në këto provime, zakonisht kërkohet një Certifikatë Federale e Aftësisimit, një diplomë e një shkolle të përgjithshme ose një kualifikim ekuivalent si dhe disa vite përvojë profesionale.

Provimet profesionale dhe provimet e larta profesionale janë kualifikime të mëtejshme të popullarizuara: çdo vit ndahen 14'000 certifikata profesionale përkatësisht 3'000 Diploma.

*Të udhëheqësh
ndërmarrjen tënde:
«Babai im më ka motivuar
të mësoj. Ai ka ardhur në
fillim të viteve të 60-ta
në Zvicër dhe ka punuar si
ndihmëspunëtor. ...*

MARIUS PINSINI, ITALI

KOPSHTAR I LARTË

**ME PROVIM PROFESIONAL, NDËRMARRJE TË VETEN TË KOPSHTARISË
ME 8 PUNONJËS DHE 2 NXËNËS**



Situata profesionale nuk e ka kënaqur kurrë atë dhe gjithnjë më thoshte: «Bëje më mirë se unë, mos puno gjithmonë për të tjerët!». Kjo ka ndikuar tek unë.

Kënaqësia në profesion erdhi me përvojën. Sa më shumë që mësoja, aq më shumë dëshiroja të dija për kopshtarinë. Pas diplomimit kam punuar 4 vjet si kopshtar dhe pastaj, krahas punës, kam bërë arsimimin dyvjeçar për kopshtar të lartë. Unë kam punuar 80% dhe të premten e të shtunën kam shkuar në shkollë. Të dielën studioja me kolegët e mi në shkollën e pemëmbjelljes së 3'000 bimëve të cilat duhej t'i dinim për provim. Mësimi më jepte kënaqësi.

Pavarësimi si qëllim u arrit

Përgatitja për provimin profesional më ka kushtuar rreth 12'000 franga. Njëkohësisht kam fituar më pak, sepse e kisha shkurtuar orarin e punës. Ka ndërmarrje të cilat ua paguajnë punonjësve të vetnjë pjesë të arsimimit të mëtutjeshëm. Pastaj pas provimit profesional mbeten në ndërmarrje. Këtë nuk e kam dashur. Nga njëra anë do të rritej presioni, – në vitin tim shkollor 59 për qind e pjesëmarrësve kanë rënë në provim – nga ana tjetër dëshiroja që pas provim profesional të vetëvendosja i lirë.

Kënaqësia në punë është rritur me zgjerimin e njohurive profesionale. Përveç kësaj, unë e kam arritur qëllimin tim për të qenë i pavarur: unë kam ndërmarrjen time. Natyrisht që punoj më shumë, zakonisht rreth 50, 60 orë në javë. Mirëpo, puna ime tani është kreative. Unë mund të zhvilloj ide të reja, t'i realizoj ato dhe vazhdimisht të krijoj kopshte të reja.»



QENDRIM ELMAZI, KOSOVË
BASHKËPUNËTOR KOMERCIAL

Studimi me shumë praktikë: «Profesioni im i ëndërruar përherë ka qenë ekonomia e ndërmarrjes, financat dhe kontabiliteti që më kanë fascinuar që nga rinia. Pas mbarimit të maturës në Kosovë, erdha te familja ime në Zvicër. ...

Kjo ishte një fazë e vështirë kalimtare, të cilën e kam përballuar vetëm falë mbështetjes së familjes sime. Në Kosovë kam qenë një nxënës i mirë, këtu në Zvicër nuk e njihja madje as gjuhën. Kam mësuar gjuhën, së pari në kurse, pastaj në një kurs intensiv të integritimit, të cilin e mbarova me një certifikatë të nivelit C1. Gjatë vitit shkollor jam informuar për mundësinë e realizimit të ëndrrës sime për të studiuar ekonomi të ndërmarrjes.

Kërkesat e larta

Kërkesat e Shkollës së Lartë Universitare në Winterthur ishin të larta; matura e gjimnazit dhe regjistrimi në një universitet në Kosovë dhe niveli C1 i gjuhës vendore, niveli B2 i gjuhës angleze, një praktikë njëvjeçare në lëmin komercial si dhe njohuri themelore në kontabilitet.

Bashkë me mentorin tim hartuam një plan kohor. Shumë nga këto parakushte i plotësova relativisht shpejt. I përktheva të gjitha dokumentet e mia nga Kosova dhe e bëra certifikatën e nivelit C1. Për kontabilitetin kam ndjekur një kurs në shkollën profesionale.

Por, praktika ka qenë një pengesë e madhe, sepse kam marrë shumë refuzime, derisa mentorin im nuk më ka ndihmuar për të gjetur një vend. Edhe me certifikatën B2 të gjuhës angleze kishte vështirësi, sepse kurset intensive anuloheshin vazhdimisht për shkak të mungesës së pjesëmarrësve. Me një qëndrim për mësim të gjuhës në Londër e zgjidha edhe këtë problem.

Provimi i lartë profesional në vend të Shkollës së Lartë Universitare

Tani gati tre vjet jam duke punuar në ndërmarrjen ku kam bërë praktikën. Meqenëse në ndërkohë kam bërë një ngritje të mëtejme si nëpunës në lëmin e kontabilitetit, sot si bashkëpunëtor komercial në kontabilitet, jam përgjegjës për debitorët, kreditorët dhe kontratat. Prandaj në vjeshtë mund të filloj përgatitjet për provimin profesional në lëmin e financave dhe kontabilitetit.

Edhe pse tani mund të regjistrohem në Shkollën e Lartë Universitare, nuk jam edhe aq i sigurt nëse kjo është rruga e drejtë për mua. Unë po ashtu mund ta paramendoj që të vendos për të bërë provimin e lartë profesional në kontabilitet dhe controlling.»

Kurset e shkollave të larta profesionale kryesisht bazohen në një shkollim të përfunduar profesional. Në shkollat e larta profesionale, profesionistët epunësuar thellojnë njohuritë e tyre tëpërgjithshme, bëjnë freskimin e njohurive të tyre profesionale dhekualifikohen përdetyrat udhëheqëse dhe menaxhuese. Shkollat e larta universitare ofrojnë njohuri teorike dhe praktike për profesionistët e specializuar dhe kuadro të mesme.

Shkolla e Lartë Profesionale



ÇFARË SHKOLLE TË LARTË PROFESIONALE SILLNI JU?

Për pranim në një shkollë të lartë profesionale zakonisht kërkohet Certifikata Federale e Aftësisimit në profesionin përkatës, ose një kualifikim ekuivalent si matura e gjimnazit ose matura speciale. Drejtimet e ndryshme të studimeve, sidomos ato në degën e shëndetësisë, kërkojnë provimin pranues dhe / ose një deklaratë të përshtatshmërisë. Arsimimi me orar të plotë në një shkollë të lartë universitare zgjat – përfshirë edhe praktikën – të paktën 2 deri 3 vjet, ndërsa arsimimi me korrespondencë 3 deri 4 vjet. Për programet arsimore me korrespondencë, absolventet dhe absolventët duhet të punojnë së paku 50 për qind në profesionin e tyre përkatës.

Programet arsimore ofrohen në fushat e mëposhtme:

- Teknikë (ndërtimtari, elektro, dru, informatikë, lëndë ushqimore, ndërtim i makinave, mikroteknikë, tekstil)
- Gastronomi, turizëm dhe ekonomi shtëpiake
- Transport dhe trafik
- Ekonomi
- Bujqësi dhe pylltari
- Shëndetësi
- Çështje sociale dhe arsimim të të rriturve
- Art dhe krijimtari

ÇKA ARRINI ME NJË SHKOLLË TË LARTË PROFESIONALE?

Në qendër të shkollimit qëndrojnë problemet konkrete nga mjedisi përkatës i punës. Si i diplomuar i shkollave të larta profesionale mësoni të mendoni në kontekste komplekse, të veproni si duhet nën presionin e kohës, të silleni si duhet me rastet kur synimet janë në konflikt njëri me tjetrin dhe të sillni vendime sipërmarrëse me ndikim të gjerë. Shkollat e larta profesionale ndërmjetësojnë kualifikime të thelluara profesionale dhe ju përgatisin për funksionet profesionale ose menaxhuese. Si person i kualifikuar, i orientuar drejt zbatimit, mund të merrni një funksion me shumë përgjegjësi në një kompani dhe të kërkoni për një pagë të përshtatshme ose gjegjëse.



EVGENIYA SCHNIDRIG, RUSI
PRAKTIKË PARAPRAKE PËR SHKOLLËN
PROFESIONALE TË HOTELERISË NË CYRIH

Unë dua përgjegjësi në profesion: «Në profesionin tim kam nevojë për kontakte me njerëzit. Prandaj turizmi ose hoteleria ishin dy fushat të cilat më interesonin më së shumti. ...»

Kam vëzhguar institucione të ndryshme të arsimit me saktësi, i kam vizituar tubimet informative, kam biseduar me përgjegjësit dhe pastaj jam përcaktuar për Shkollën Profesionale të Hotelierisë në Cyrih. Për zgjedhjen e arsimit tim, i kam lënë vetes shumë kohë në disponim. Shkollimi më ka kushtuar rreth 32'000 franga.

Bashkëpunimi midis njerëzve të ndryshëm

Unë e kam mbaruar maturën. Mirëpo, mua më mungon arsimimi bazë profesional në gastronomi. Prandaj dhe jam momentalisht në një hotel me 5 yje për një parapraktikë 10-mujore, të cilën e kërkon shkolla. Gjatë kësaj kohe kam mësuar shumë. Unë e kam parë se si funksionon një hotel, se si funksionon bashkëpunimi midis aq shumë njerëzve të ndryshëm, sesa e tendosur dhe me stres mund të jetë puna në një hotel. Por unë kam mësuar po ashtu, se pikërisht kjo është puna që unë dëshiroj ta bëj.

Përveç parapraktikës, meqenëse unë jam migrante, shkolla kërkonte edhe një test pranimit për gjermanisht. Ai ishte shumë i vështirë. Mes tjerash më është dashur të interpretoj dhe shpjegoj fjalë të urta si «Ai zien po ashtu vetëm me ujë». Tani do t'ia filloj hapit të parë në karrierën time profesionale, Shkollës Profesionale të Hotelierisë. Pas shkollës dua të punoj si Guest Relation menaxhere, me shumë dëshirë në një Wellness-Hotel, në të cilin mysafirët vijnë për t'u relaksuar.»

Rruga e gjatë për në cak: «Në Kubë kam studiuar pedagogjinë e vallëzimit dhe kam dhënë mësim të vallëzimit në klasat fillore. Kur erdha në Zvicër, fillova pothuajse përsëri gati prej fillimit. ...

Mësimi i gjuhës ishte gjëja e parë. Gjatë dy vjetve kam vizituar kurse të gjuhës dhe të integritimit dhe gjatë kësaj kohe po ashtu kam menduar se si do të vazhdonte jeta ime në fushën e profesionit. Unë jam njoftuar me sistemin arsimor të Zvicrës dhe rrugët e ndryshme të arsimimit dhe gjatë kësaj kohe kam hasur në një ekspert aktivizues. Edhe pse unë si person, për shkak të përvojës time të mëparshme, si pedagog i vallëzimit, isha i përshtatshëm për këtë profesion, kam dështuar në intervistë. Nga njëra anë, për arsye se gjatë provimeve jam shumë i shqetësuar, nga ana tjetër edhe njohuritë e mia të gjuhës gjermane nuk ishin të mjaftueshme.

Kështu u kthyeva në kurs të gjuhës gjermane. Dhe këtë afat e kam shfrytëzuar. Kam punuar si kamarier në shërbim. Edhe njëherë kam menduar si ta bëj karrierën time, cilin profesion ta mësoj, cilat arsimime profesionale do të vinin në shprehje për mua ose a të shfrytëzoj shansin e dytë në intervistë. Kam hulumtuar, kam diskutuar, sidomos me partneren time dhe në të njëjtën kohë kam punuar me një këshilltar në lidhje me mënyrën se si mund të kapërcej frikën time përpara dhe gjatë provimeve, si mund të flas më ngadalë dhe si mund t'i organizoj më mirë idetë e mia në kokë.

Ndërlidhja e interesave dhe e aftësive

Gjatë kësaj faze unë përsëri i jam kthyer rrënjëve të mia. Psikologjia më ka interesuar gjithmonë, por në të njëjtën kohë unë doja të punoja praktikisht me njerëz dhe të lëviz. Kështu më ka lindur ideja për infermier të përkujdesjes me përqendrim në psikiatri. Ky arsimim profesional, kjo punë, kombinon interesat dhe aftësitë e mia në mënyrë optimale. Dhe më kujtohet shumë mirë, se me çfarë intensiteti jam përgatitur për intervistë dhe sa mirë kam paraqitur motivet e mia për këtë profesion. Më kujtohet mirë edhe gëzimi i madh kur u pranova në shkollë.

Pranimi i ndihmës

Pjesën teorike të arsimimit tim profesional jam duke e bërë në Qendrën për Trajnim në Shëndetësi, ndërsa pjesën praktike në Klinikën Universitare të Psikiatrisë. Sigurisht se gjuha në këtë nivel të arsimimit profesional është e vështirë dhe më shkakton ende probleme.

Por me mbështetjen e mësuesve, kolegëve dhe kolegeve dhe partneres sime, deri tani e kam përballuar mirë këtë pengesë. Në vjetët e fundit kam mësuar si mund të marr shumë mbështetje, në qoftë se e pranoj ndihmën e ofruar. Unë dua të shfrytëzoj këtë mundësi duke mësuar me angazhim dhe me përkushtim. Nëse kjo nuk funksionon, unë mund të them: Nuk ia dola, mirëpo e kam provuar.»

FRANK VEGA BONNE, KUBË
SHKOLLA E LARTË PROFESIONALE E INFERMIERISË,
FOKUSIMI NË PSIKIATRI



Shkolla e Lartë Universitare, Shkolla e Lartë Pedagogjike

«Të barasvlershme, por të ndryshme», – me këtë moto shkollat e larta universitare dhe atopedagogjike ofrojnë arsimim praktik në nivel të shkollimit të lartë. Për një arsimim me orar të plotë për diplomë Bachelor duhet llogaritur 3 vjet, ndërsa për studime me korrespondencë 4 ose 5 vjet. Për studimet e mëtejshme për përfundimin e Master-it edhe 2 vjet shtesë.



DREJTIMET E STUDIMEVE PRAKTIKE

Shkollat e larta universitare dhe shkollat e larta pedagogjike ofrojnë drejtime studimi dhe kurse praktike të ngritjes së mëtejshme në nivel universitar. Më shumë se 200 drejtime studimesh kryhen zakonisht me një Bachelor. Profesionistët me një Bachelor janë specialiste dhe specialistë shumë të kualifikuar dhe në këtë kuptim edhe të kërkuar. Ata punojnë në të gjitha nivelet e menaxhmentit, ndërkohë, shkollat e larta ofrojnë rreth 80 arsimime me Master. Për shembull, për mësues të nivelit sekondar I kërkohet si kusht diplomimi me Master. Në shkollat e larta universitare publike, tarifa e semestrit arrin nga 500 deri në 1500 franga, kurse në institucionet private arsimore nga 3500 deri në 5000 franga.

KUSHTET PËR STUDIME NË SHKOLLË TË LARTË UNIVERSITARE

Disa drejtime të studimeve, përveç një arsimimi të caktuar, kërkojnë edhe sqarime të caktuara të përshtatshmërisë, teste ose biseda pranuese.

Arsimimi bazë profesional dhe matura profesionale:

Nëse keni kombinuar arsimimin bazë profesional me maturën profesionale, atëherë në parim keni të drejtë për studime për Bachelor. Në qoftë se i plotësoni këto kushte, por dëshironi të ndryshoni degën e studimeve – për shembull prej komercialistit

në punëtor social – ju do të pranoheni në studime, nëse dëshmoni se keni përvojë pune në fushën e zgjedhur të studimit.

Shkolla e mesme speciale me maturën speciale:

Parimisht, me një maturë speciale ju keni të drejtë të studioni në një shkollë të lartë universitare në degët shëndetësi, arsim, çështje sociale, komunikim dhe psikologji, varësisht nga drejtimi që keni përfunduar në shkollën e mesme speciale. Për drejtimet e tjera duhet të bëni një praktikë paraprake. Për studimet në degët matematikë dhe shkenca natyrore, mund të përgatiteni me kurse paraprake, të cilat i ofrojnë shkollat e larta universitare.

Matura e gjimnazit:

Nëse ju keni maturë gjimnazi, ju mund të studioni në një shkollë të lartë universitare. Kusht është një përvojë pune 1-vjeçare, mundësisht në fushën e drejtimit të zgjedhur të studimit.

Kualifikimet e tjera:

Shkollat e larta universitare dhe shkollat e larta pedagogjike mund të lejojnë kërkesa pranimi edhe me kualifikime të tjera paraprake. Për këtë arsye shkollat e larta universitare dhe shkollat e larta pedagogjike e studiojnë dosjen e aplikimit dhe kërkojnë teste të veçanta të përshtatshmërisë ose provime pranuese.

Të studiosh me korrespondencë: «Unë gjithnjë kam dashur të punoj në fushën profesionale të medicinës. Në Tunizi kam mbaruar maturën në shkencat natyrore dhe kam filluar studimet në teknologjinë mjekësore. ...

KAOUTHER MRAIHI, TUNIZI
PRAKTIKË PËR PARAPËRGATITJE PËR STUDIME
NË NJË SHKOLLË TË LARTË UNIVERSITARE



Pas martesës, para dy vjetësh kam ardhur në Zvicër dhe kam lindur një vajzë. Kjo përvojë për mua ka edhe një rëndësi profesionale: unë dua të bëhem mami. Jam e bindur që si mami mund të kontribuojë shumë që gratë nga rrethi im kulturor gjatë lindjes të ndihen mirë.

Lindja është në fakt një akt natyror, por ka gjithnjë momente të cilat ne grave na bëjnë të pasigurta. Nga përvoja ime e di sesa e rëndësishme është që në këto momente të flasësh në gjuhën amtare. Ne e kuptojmë se çka po ndodh dhe e ndiejmë veten të sigurt.

Të ruash gjuhën amëtare

Për mua ruajtja e gjuhës amtare është shumë e rëndësishme. Prandaj dhe ua mësoj, në kohën e lirë, gjuhën arabe fëmijëve dhe të rinjve. Për t'i realizuar planet e mia profesionale, së pari kam kërkuar njohjen e maturës dhe fillimin e studimeve në shkollën e lartë universitare. Tani po përgatitem me një praktikë për lindjet dhe me kurse të gjermanishtes për provimin pranues në shkollën e lartë universitare.»



ALICIA LEDERGERBER, ZVICËR/SPANJË
STUDIMET E RESTAURIMIT
SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE

*Patjetër duhet lidhur teorinë me praktikën:
«Pas maturës në degën e artit, fillova studimin komunikimit vizual në një shkollë të lartë universitare në Spanjë. Mirëpo shpejt e kuptova, se kjo nuk ishte ajo që duhej për mua. ...*

Unë nuk jam personi më kreativ dhe nuk dua të merrem vetëm me tema teorike, por patjetër dua të punoj me duar. Këtë e kam kuptuar kur për një projekt kam përgatitur imazhin e skenës. Prandaj u detyrova të riorientohej.

Nëna ime dhe sidomos motra ime, e cila që shumë vjet jeton në Zvicër, më kanë propozuar të vija në Zvicër. Unë gjithmonë e kam ditur se nuk kam dashur që tërë jetën time të qëndroj në Spanjë, sepse kam shumë dëshirë të mësoj gjuhë të reja, të njoh botë të reja. Kështu që eshfrytëzova këtë shans. Kam ardhur në Zvicër dhe shpejt e kam mësuar gjermanishten, ndoshta edhe për shkak se unë gjithmonë kam punuar. Gjatë punës

sime në një restorant jo vetëm që njihem me shumë njerëz, por po ashtu mësoj gjermanishten dhe gjermanishten zvicerane.

«Diçka ka munguar»

Njëkohësisht, në kursin e integritit kam shqyrtuar profesione të ndryshme dhe kam bërë punë provuese si marangoze dhe kopshtare, por fatkeqësisht si piktore e teatrit nuk ecte. Gjithmonë ka munguar diçka. Kam mundur të paramendoj të punoj si arkitekte e mjedisit, por për fat të keq shkolla e lartë universitare nuk ka pranuar maturën time.

Natyrisht që isha e zhgënjyer. Por unë vazhdimisht kam biseduar me shumë njerëz, me të afërmit dhe me miqtë, rreth zgjedhjes së profesionit dhe shkollimit tim, kam mbledhur ide, i kam krahasuar, i kam hedhur poshtë, deri sa më ka mbetur profesioni i restaurueses si favorit imi. Dhe këtë herë kisha fat: Shkolla e Lartë e Arteve e pranoi maturën time, jam lejuar të bëj procedurën e pranimit, dhe po testohet përshtatshmëria ime për këtë profesion.

«Interesat e mia ndryshojnë dhe zhvillohen»

Por dua t'i lë vetes kohë, unë do të dëshiroja të bëj një vit praktikë për t'u njohur mundësisht me shumë fusha të restaurimit. Në këtë moment unë e di vetëm se nuk dua të bëj restaurimin e pikturave, sepse këtu kërkohen aftësi të mëdha motorike. Restaurimi i mobileve është një mundësi, gjithashtu edhe punime me gurë, ruajtja e monumenteve, ndoshta edhe e librave, dokumentet dhe fotografitë.

Më duket shumë vështirë në qoftë se vendos për një arsimim, sepse interesat e mia ndryshojnë dhe zhvillohen vazhdimisht. Por unë e di se studimi në një shkollë të lartë universitare do të ishte bazë e mirë, fillimi i karrierës sime, pa marrë parasysh ku më shpie ajo.»

Pas përfundimit të suksesshëm të arsimimit bazë profesional me maturë profesionale, ju po ashtu mund të synoni të studioni në universitet ose në Shkollën e Lartë Teknike Federale ETH/EPF. Ose përgatiteni me kursin përgaditor «Passerelle» 2 semestra për provim shtesë, që ju mundëson praninë në shkollat e larta universitare. Ose fitoni të drejtën për studim në universitet nëpërmjet një studimi në një shkollë të lartë universitare dhe një diplome në shkollë të lartë universitare.

Universiteti dhe Shkollat e Larta Teknike Federale



«PASSERELLE»

Nëse keni kombinuar arsimimin bazë profesional me një maturë profesionale, nëpërmjet «Passerelle» mund të përgatiteni për provim plotësues, sipas udhëzimeve të Komisionit Zviceran të Maturës. Shkollimi me «Passerelle» përbëhet nga një vetëstudim dhe mësim i drejtpërdrejtë (frontal) dhe zgjat 30 javë (2 semestra). Degët profesionale përmbajnë: gjermanisht, anglisht, matematikë; Shkencat natyrore (biologji, kimi, fizikë), shkencat humane dhe sociale, gjeografia dhe historia. Kalimi me sukses i provimit shtesë ju jep të drejtën për Shkollën e Lartë Teknike Federale ETH/EPF, në provimet federale të mjekësisë, në universitetet kantonale dhe në shkollat e larta pedagogjike.

atëherë keni të hapur mundësinë të ndiqni drejtime të caktuara të studimeve në të njëjtën fushë ose fusha të ngjashme studimi në universitetet kantonale ose në Shkollën e Lartë Teknike Federale. E ashtuquajtura «lista e konkordancës (harmonizimit)» ofron informacione për rrugët e mundshme, por universitetet vendosin në mënyrë autonome dhe përfundimtare për praninë (shih www.swissuniversities.ch > publikimet > rregulloret > rekomandimet).

STUDIMI NË SHKOLLË TË LARTË UNIVERSITARE

Nëse keni kombinuar arsimimin bazë profesional me një maturë profesionale, atëherë ju keni të drejtë të studimeve për Bachelor në shkollat e larta universitare, varësisht nga drejtimi i zgjedhur, pa provim pranues dhe procedurë pranimi. Pas përfundimit të suksesshëm të studimeve 3-vjeçare për Bachelor

Studimi në Shkollën e Lartë Teknike Federale si rjedhojë logjike: «Si 16-vjeçar nuk kam qenë nxënës edhe aq i zellshëm. Prandaj kam vendosur për arsimimin profesional në degën e gjeomatikës me Certifikatë Federale të Aftësimit dhe këtë arsimim ta kombinoj me shkollën e maturës profesionale. ...

Atëkohë, ky sigurisht nuk ka qenë vendimi më i keq, sepse ky arsimim për mua nuk ishte i vështirë dhe e kam përfunduar pa përpjekje të mëdha.

Pas provimit përfundimtar kam shkuar në shërbim ushtarak dhe njëkohësisht kam filluar studimin e informatikës në shkollën e lartë universitare. Këtë studim të rregullt kam mundur ta përballoj, sepse gjatë mësimit të profesionit kam kursyer pak para. Unë mund të jetoja në shtëpi të prindërve dhe nuk isha i detyruar të kontribuoja financiarisht për këtë. Përveç kësaj, unë gjithmonë kam qenë njeri i kursimtar, i cili kurrë nuk ka pasur jetë të shtrenjtë. Në atë kohë nuk kam pasur makinë dhe në kohën e lirë nuk kam shpenzuar shumë para.

Gjatë studimeve në shkollën e lartë universitare kam filluar të interesohem për fizikë. Sigurisht edhe për shkak se kishim një docent të shkëlqyeshëm. Vendosa të studioja fizikën në Shkollën e Lartë Teknike Federale, dhe atë menjëherë pas shkollës së lartë. Në Shkollën e Lartë Teknike Federale kam filluar sërish nga semestri i parë. Kërkesat janë shumë të larta, sidomos në matematikë dhe, do të ishte e pakuptimtë për të filluar studimet drejtpërsëdrejti në vitin e dytë.

Të njihesh me botën e punës

Natyrisht se rruga për arritjen e qëllimit tim në karrierë do të ishte më e lehtë, dhe para së gjithash më e shkurtër, sikur unë të kisha ndjekur gjimnazin dhe pastaj të studioja. Mirëpo, ky rrugëtim imi në karrierë ka edhe përparësitë e veta, sepse nga përgatitja ime si gjeomatik, e njoh botën e punës dhe e di se çka kërkohet në një vend pune. Studimi në shkollën e lartë universitare më ka ofruar njohuri thelbësore në informatikë, të cilat mund t'i shfrytëzoj në jetën profesionale dhe atë private.

Kënaqësia për mësim mbeti

Pavarësisht rrugës së gjatë, vullnetin për të mësuar e kam ruajtur. Dhe këtë kënaqësi dua ta bartë edhe te nxënësit e nxënëset e mia. Tash jap mësim në degën e fizikës në një gjimnaz në Winterthur dhe me korrespondencë kam bërë diplomën për mësimdhënës. Edhe gjatë mësimit të profesionit kam ndier kënaqësi, kur ua kam përcjellë njohuritë e mia nxënësve të rinj, e ligjërimit edhe sot është kënaqësi.

Fizika nuk është një lëndë e lehtë, sidomos formulat e shumta e bëjnë të vështirë. Megjithatë, përmes shembujve interesantë nga natyra dhe teknika, nxënësit duhet të ndiejnë kënaqësi për fizikën.»

**ROGER HERRIGEL, ZVICËR
GJEOMATIK ME MATURË PROFESIONALE,
INFORMATIKË, FIZIKË ETH/EPF**



Me certifikatën e shkollës së mesme speciale, maturës profesionale ose gjimnazit në xhepin tuaj, është bërë një etapë e parë e rëndësishme në karrierën tuaj arsimore, ju gjendeni në fazën kalimtare nga një shkollë e arsimit të përgjithshëm në një studim. Detyra tani është thellimi i asaj që keni mësuar në një shkollë të lartë profesionale, në shkollë të lartë universitare, në një shkollë të lartë pedagogjike ose në një universitet/Shkollën e Lartë Teknike Federale dhe nga kjo të krijoni një perspektivë profesionale. Ky hap duhet përgatitur mirë.

Ky kapitull u dedikohet të huajve dhe të huajave në shkollën e mesme (dhe prindërve të tyre), ose të gjithë atyre, që synojnë të bëjnë një arsimim të tillë në Zvicër për vete ose për fëmijët e tyre. Informon se si duhet të bëhet kalimi nga gjimnazi për studime në një shkollë të lartë dhe cilat programe studimore dhe diploma ofrojnë shkollat e larta dhe universitetet në Zvicër.

Planifikimi dhe jetësimi i studimeve

Si më tutje, pas gjimnazit ose shkollës së mesme speciale?

Faqe

96	Arsimimi në nivel terciar
97	Pasqyrë përmbledhëse
98	Fushat e studimit
100	Pas maturës speciale
101	<i>Robin Stauffer, Zvicër, Bachelor në Psikologji Aplikative</i> «Përgatitja për një profesion social»
102	Pas maturës së gjimnazit
103	<i>Marc Moran, Zvicër, Mësues i shkollës fillore primare</i> «Pothuajse klasike – matura dhe studimet»
104	<i>Gul Afroz Haidari, Afganistan, specialiste për radiologji mjekësore-teknike</i> «Në ditën e dyerve të hapura diçka bëri klik»
105	<i>Nicolas Egli, Zvicër, nëpunës trusti</i> «Arsimimi në ekonomi pas maturës si zgjidhje e përsosur»

Si më tutje, pas gjimnazit oshkollës së mesme speciale?

Sistemi i shkollimit të lartë është i ndarë në 11 fusha studimi me më shumë se 120 drejtime të studimeve (shihet tabelën në faqet 98/99). Studimet e larta ofrohen nga 10 universitete kantonale, 2 shkolla të larta teknike federale ETH/EPF, 9 shkolla të larta universitare dhe 16 shkolla të larta pedagogjike. Këtyre u bashkëngjitet nga një universitet me korrespondencë (studimi në distancë) dhe shkolla e lartë universitare e studimit në distancë dhe institucionet e tjera në fushën pedagogjike.


Arsimimi në nivel terciar

Programet studimore të shkollave të larta universitare dhe shkollave të larta teknike federale ETH/EPF janë të përqendruara kryesisht në kërkime bazë akademike, ndërsa shkollat e larta universitare kryesisht në drejtim të aplikimit me bazë më të fortë në zbatimin praktik. Periudha e studimit në shkollat e larta universitare dhe në shkollat e larta teknike federale ETH/EPF, është e paraparë për studime me kohë të plotë dhe zgjat zakonisht 4 ½ deri në 5 vjet, në shkollat e larta universitare 3 vjet.


Në shkollat e larta universitare, studimet zakonisht mbarojnë me Bachelor (pas 3 vjetësh). Në disa degë studimi mund të bëhet edhe një studim Master, i cili përfundon me një diplomë Master (pas 2 vjetësh shtesë).

Varësisht nga niveli shkollor, në të cilin ju dëshironi të ligjëroni më vonë, e përfundoni shkollën e lartë pedagogjike me Bachelor pas 3 vjetësh, ose pas 2 vjetësh shtesë me Master.

Edhe në universitete dhe shkollat e larta teknike federale ETH/EPF, pas përfundimit me sukses të studimeve merrni diplomë në Bachelor (pas 3 vjetësh); megjithatë, shkalla standarde e mbarimit të studimeve në këto institucione është Master (pas 2 vjetësh shtesë). Po ashtu ekziston edhe mundësia të vazhdoni studimet dhe në tre vjetët e ardhshme të mbaroni me një PhD (doktoraturë), ose në vazhdim edhe me një Habilitacion, për titullin profesor në një shkollë të lartë.



Pasqyrë përmbledhëse



Rrugët e depërtueshme

Të gjitha llojet e arsimit në nivelin Sekondar II mund të shpëjnë në studime në nivel terciar.

Si më tutje, pas gjimnazit
oseshkollës së mesme
speciale?

Fushat e studimit

Grupet e lëndëve	Fushat e studimeve Shkollat e larta universitare / Shkollat e larta teknike federale	Fushat e studimeve Shkollat e larta profesionale
Teologji dhe shkencat religjioze	<ul style="list-style-type: none"> - Teologjia - Shkencat religjioze 	
Shkencat juridike dhe ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> - Shkencat ekonomike - Shkencat juridike - Shkencat kriminalistike 	<ul style="list-style-type: none"> - Shkencat ekonomike - Turizmi, menaxhment hotelier, - Menaxhment i objekteve
Shëndetësia	<ul style="list-style-type: none"> - Mjekësi humane/kiropraktika - Shkenca e kujdesit - Mjekësi e dhëmbëve - Veterinari - Shkencat e lëvizjes dhe sporti 	<ul style="list-style-type: none"> - Kujdesi - Profesionet medicinale - terapeutike - Profesionet medicinale - teknike - Shkencat e lëvizjes dhe sporti
Shkencat sociale	<ul style="list-style-type: none"> - Sociologji - Shkenca politike, marrëdhënie ndërkombëtare - Psikologji - Shkencat e edukimit - Punë sociale 	<ul style="list-style-type: none"> - Psikologji - Shkencat e edukimit > Shkolla e Lartë Pedagogjike - Punë sociale
Shkencat gjuhësore dhe literaturë/komunikimi	<ul style="list-style-type: none"> - Filologji klasike - Gjermanistika/anglistika/romanistika - Lëndë tjera gjuhësore - Shkencat e përgjithshme/krahasimtare për gjuhë dhe letërsi - Përkthim/interpretim - Shkencat e komunikimit dhe mediave (gazetari) 	<ul style="list-style-type: none"> - Shkenca e informimit/dokumentacioni - Përkthim/interpretim - Shkencat e komunikimit dhe mediave gazetari
Shkencat historike dhe kulturore	<ul style="list-style-type: none"> - Filozofi - Histori - Shkencat e lashtësisë - Etnologji/antropologji kulturore - Studimet e Evropës Lindore - Shkenca e studimeve islamike 	
Art,muzikë, dizajn	<ul style="list-style-type: none"> - Shkenca e muzikës - Shkencat teatrore/shkenca e vallëzimit - Shkenca e filmit - Shkenca e artit 	<ul style="list-style-type: none"> - Musikë - Teatër - Shkenca e filmit, filmi - Komunikimi vizual - Dizajni industrial dhe i produkteve - Arkitektura e brendshme - Konzervimi/restaurimi - Arti vizual (pamor) - Shkrimi letrar
Matematikë, informatikë	<ul style="list-style-type: none"> - Matematikë - Informatikë - Shkencat kompjuterike 	<ul style="list-style-type: none"> - Informatikë

Grupet e lëndëve	Fushat e studimeve Shkollat e larta universitare / Shkollat e larta teknike federale	Fushat e studimeve Shkollat e larta profesionale
Matematikë, informatikë	<ul style="list-style-type: none"> - Matematikë - Informatikë - Shkencat kompjuterike 	<ul style="list-style-type: none"> - Informatikë
Shkencat natyrore dhe të ambientit	<ul style="list-style-type: none"> - Fizikë - Kimi/shkencat e kimisë inxhenerike - Biokimi - Biologji - Shkencat e jetës/shkencat natyrore Interdisciplinare - Shkencat farmakologjike - Shkencat e ambientit/shkencat e inxhenerisë së ambientit - Shkencat e tokës/gjeologji - Gjeografi 	<ul style="list-style-type: none"> - Kimi/shkencat e kimisë inxhenerike - Shkencat e jetës / shkencat natyrore Interdisciplinare - Shkencat e ambientit/shkencat e inxhenerisë së ambientit
Shkencat teknike	<ul style="list-style-type: none"> - Arkitektura - Ndërtimtaria/gjeomatikë dhe planifikim - Makineri dhe teknikë inxhenerike interdisciplinare - Mikroteknikë dhe nanoteknikë - Elektroteknikë dhe teknologji inormative - Shkenca të materialit - Shkencat bujqësore, teknologjia ushqimore, shkencat e pylltarisë 	<ul style="list-style-type: none"> - Arkitektura / arkitekturë ambientale - Ndërtimtaria/gjeomatikë dhe planifikim - Makineri dhe teknikë inxhenerike interdisciplinare - Mikroteknikë dhe nanoteknikë - Elektroteknikë dhe teknologji inormative - Shkencat bujqësore, teknologjia ushqimore, shkencat e pylltarisë

Grupet e lëndëve	Fushat e studimeve Shkollat e larta universitare / Shkollat e larta teknike federale	Fushat e studimeve Shkollat e larta pedagogjike
Profesionet, Mësimi	<ul style="list-style-type: none"> - Parashkollor dhe Shkollë e ulët fillore - Niveli Sekondar I dhe II - Pedagogji kurative (shëruese) - Logopedi (shkenca e të folurit) 	<ul style="list-style-type: none"> - Parashkollor dhe shkollë e ulët fillore - Niveli Sekondar I dhe II - Arti vizual (pamor) - Muzikë dhe lëvizje, pedagogji muzikore/muzikë shkollore - Pedagogji kurative (shëruese) - Logopedi - Terapi psikomotorike

Si më tutje, pas gjimnazit oseshkollës së mesme speciale?

Certifikata e shkollës së mesme speciale ose matura speciale ju hapin mundësi të ndryshme të arsimimit dhe të ngritjes së mëtejshme në shkollat e larta profesionale, në shkollat e larta universitare dhe në shkollat elarta pedagogjike.

Pas Maturës Speciale



SHKOLLAT LARTA PROFESIONALE

Me certifikatën e shkollës së mesme speciale, ju zakonisht mund të ndiqni një shkollë të lartë profesionale në degët e shëndetësisë, pedagogjisë dhe punës sociale, nëse mund të dëshmoni përvojë profesionale në fushën përkatëse. Shkollat e ndryshme të larta profesionale kërkojnë po ashtu një sqarim shtesë ose test të përshtatshmërisë.

SHKOLLAT E LARTA UNIVERSITARE

Me maturë speciale në shëndetësi, çështje sociale, art, komunikim dhe informim, lejoheni të merrni pjesë në procedurat e regjistrimit në degët përkatëse të shkollës së lartë universitare, nëse mund të dëshmoni se keni përvojë praktike 1-vjeçare në këto lëmi. Në drejtimet e studimit, të cilat nuk i përgjigjen maturës suaj speciale, mund të përgatiteni në mënyrë të posaçme.

SHKOLLAT E LARTA PEDAGOGJIKE

Me një maturë speciale të degës pedagogjike, zakonisht pranoheni pa provim pranues për studime në fushën e studimeve «Kopshtii fëmijëve - niveli i ulët» dhe «shkalla primare». Për programin e studimit «Kopshti i fëmijëve» zakonisht mjafton një diplomë 3-vjeçare e shkollës së mesme speciale, për t'u pranuar pa provim pranues në shkollën e lartë pedagogjike. Në kornizat e procedurës së pranimit testohet nëse posedoni arsimimin e përgjithshëm për degën e synuar. Disa shkolla të larta pedagogjike organizojnë provime pranuese dhe/ose ofrojnë kurse përgatitore për përvetësimin e njohurive të kërkuara.



ROBIN STAUFER, ZVICËR
MATURA SPECIALE
BACHELOR NË PSIKOLOGJI APLIKATIVE

Përgatitja për një profesion social: «Nuk kisha asnjë plan se çfarë të bëja, kur si nxënës i klasës së tretë të sekondares shkova te këshillimorja për profesione. ...»

Kam bërë teste të ndryshme dhe gjithmonë si rezultat dilnin profesione për të cilat, si parakusht, nevojitej një shkollë e mëtejshme. Unë në atë kohë isha i «mërzitur nga shkolla» dhe nuk dëshiroja të shkoja edhe katër vjet të tjera në gjimnaz. Kur këshilltarja për profesione më propozoi shkollën e mesme speciale, e cila në fund të fundit zgjaste një vit më pak, bëra provimin pranues dhe kalova. Provimi ishte i ngjashëm me atë të gjimnazit, por kërkesat në matematikë, gjermanisht dhe frëngjisht ishin pak më të vogla.

Shkolla e mesme speciale ishte ok, komode. Shumë gjëra ishin të ngjashme me shkollën fqinje kantonale, pjesërisht kishim madje edhe të njëjtit mësimdhënës. Nuk kishte lëndë zgjedhore dhe fatkeqësisht nuk kishte mundësi për të bërë një udhëtim gjuhësor. Më kanë pëlqyer tri fushat e specializimit; drejtimi social, që unë kam zgjedhur, kishte një fokus të fortë në ekonomi. Sigurisht që kam mësuar diçka në shkollën e mesme speciale, së paku atë që më ka interesuar mua.

Përvoja e parë praktike

Viti i fundit i maturës speciale më ka pëlqyer shumë - më në fund përfundonte shkolla, por fillonte koha e mbledhjes së përvojës praktike. Puna e përditshme me fëmijët e një shkolle pedagogjike shëruese, më ka pëlqyer, ndërsa kampet klasore nuk ishin sipas dëshirës sime. Punimi i maturës speciale ishte relativisht i lehtë.

Në këtë vit, te unë është pjekur bindja për të studiuar psikologjinë, ide kjo e cila më ka përcjellur që nga shkolla fillore. Profesionin e terapistit mund ta paramendoja. Për pranimin në shkollën e lartë universitare kishte një proces përzgjedhjeje. 45 persona morën pjesë; unë isha në mesin e më të rinjve. Ka pasur 25 vende studimi, dhe kur unë në provim arrita numrin rendor 30 mendova se shanset për të studiuar u zhdukën. Pesë ditë para fillimit të studimeve më erdhi befas një thirrje telefonike se ka një vend të lirë studimi për mua. M'u desh të gjendesha në këtë situatë, por pasi nuk kisha një plan B, isha i lumtur.

Përfundimisht studimet i mbarova me sukses dhe me nota të mira. Por, gjithnjë e më shumë kuptoja se me një Bachelor në psikologjinë aplikative nuk mund të bëja shumë. Për të qenë një terapist i mirë, duhej një mastër dhe një trajnim në terapi, në përgjithësi katër deri gjashtë vjet shtesë, të shoqëruara nga një punë me orar të shkurtuar dhe me pagë të dobët. Këtë as mund ta imagjinoj dhe as ta përballoj tani.

Fillimi i ri

Fillova të mendoj nëse duhet të orientohej në turizëm, hoteleri, sidomos pasi që unë prej përfundimit të shkollës, krahas arsimimit, kam punuar në gastronomi dhe në këtë fushë kisha fituar disa aftësi dhe kompetenca. Mirëpo, befas më pat rënë në sy një shpallje për vend pune për një punëtor me të rinj dhe fëmijë. Aplikova dhe për habinë time u pranova në punë. Kjo është mirë, sepse kam nevojë për një fillim të ri, po e provoj.»

Si më tutje, pas gjimnazit oseshkollës së mesme speciale?

Me Maturë të gjimnazit, ju i keni shumë rrugë të hapura: studimi në universitetet kantonale, në shkollat e larta federale teknike, studime në shkolla të larta universitare pas një praktike profesionale, më sëpaku një vit, ose një arsimim në ekonomi pas maturës.

Pas maturës së gjimnazit



SSTUDIMET NË UNIVERSITETE DHE SHKOLLAT E LARTATEKNIKE FEDERALE

Me një certifikatë të njohur federale të maturës, keni të drejtë studimi. Nëse keni një certifikatë të huaj të maturës, atëherë sqaroni nën www.swissuniversities.ch nëse kjo pranohet nga universitetet zvicerane dhe shkollat e larta teknike federale dhe se a duhet të bëni provim të veçantë pranues.

Universitetet zvicerane zakonisht heqin dorë nga kufizimet për pranim në studime. Përjashtimet e vetme janë studimet e medicinës dhe pjesërisht ato të shkencave të sportit: varësisht nga numri i aplikimeve, bëhet një provim pranues për studentë zviceranë. Në këtë provim lejohen edhe migrantët e migrantet, në qoftë se prindërit e tyre kanë leje të përhershme qëndrimi.

Studimi universitar është dyshkallësh: për titullin e parë akademik – Bachelor – ju duhen 180 pikë kredie, që korrespondon me 3 vjet të studimit me orar të plotë. Për shkallën e dytë akademike – Master – ju duhen 90-120 pikë shtesë kredie ose edhe 2 vjet të tjera. Për Master parakusht i domosdoshëm është një Bachelor.

Tarifat e studimeve për një vit në universitetet zvicerane ose në shkollat e larta teknike federale ndryshojnë dukshëm: varësisht shkolla e lartë / universiteti ju duhet të llogaritni me shuma prej 1000 deri në 4000 franga. Studentët e huaj, në disa nga shkollat e larta, duhet të

paguajnë tarifa dukshëm më të larta.

Pas një Masteri keni mundësi të ndryshme të hapura të ngritjes së mëturjes, orientimi për hulumtime shkencore në universitete dhe shkollat e larta teknike federale (doktoraturë, habilitim) ose drejtime të studimeve me kohëzgjatje të ndryshme me certifikata profesionale dhe diploma (Certifikata e Studimeve të Avancuara CAS, Diploma e Studimeve të Avancuara DAS, Master për Studime të Avancuara MAS). Po ashtu, është i mundshëm edhe një arsimim pedagogjik, didaktik dhe për mësimdhënie praktike (p.sh. diploma e mësimdhënies për shkollat e maturës).

STUDIMI NË SHKOLLAT E LARTA UNIVERSITARE

Me një maturë të gjimnazit, ju gjithashtu mund të studioni në shkollat e larta universitare, në qoftë se ju keni punuar 1 vit dhe në këtë mënyrë mund të dëshmoni përvojën e nevojshme në botën e punës.

Për studentët me një certifikatë të huaj të maturës, vlen e njëjta listë zyrtare e kriterëve për pranim si për shkollat e larta federale teknike dhe për universitetet.

Tarifat për studime në shkollat e larta universitare sillen – varësisht prej drejtimin të studimeve - prej 1000 deri 2000 franga në vit. Për studentët e huaj këto tarifa mund të jenë më të larta.

*Pothuajse klasike –
Matura dhe studimet:
«Në gjimnaz - fillova
gjimnazinafatgjatë në profilin
e gjuhëve tëlashta – nuk shkonte
gjithçka si duhet. Pas vitit
të dytë unë utransferova vetëm
përkohësisht. ...*

Mësuesja ime më sugjeroi që vitin e tretë ta përfundoja në Gjenevë, në vend të përsëritjes së vitit në Cyrih. Natyrisht që kjo nuk ishte e lehtë, gjuha e shkollimit ishte frengjishtja dhe për herë ë parë jetoja pa familjen time. Mirëpo, mund të jetoja te një hallë/teze imja në Gjenevë dhe kjo e bëri më të lehtë gjendjen. Pas kthimit në Cyrih kalova provimin pranues për gjimnazin afatshkurtër, këtë herë në profilin e gjuhëve të reja me anglishten, gjermanishten, frengjishten dhe spanjishten.

MARC MORAN, ZVICËR
MËSUES I SHKOLLËS FILLORE PRIMARE



Ky profil më përshtatej mua dhe aftësive të mia, për shkak se prindërit e mi vijnë nga Spanja dhe Italia dhe ne në shtëpi flasim katalanishten.

Mungesa e kontakteve sociale

Qysh si 12, 13-vjeçar isha i sigurtë se ndonjëherë do të punoja si mësues. Pas maturës, për arsye të ndryshme, vendosa të studioja shkencën e materialeve në Shkollën e Lartë Teknike Federale ETH/EPF. Ne ishim një degë e vogël e studimit, me vetëm rreth 60 studentë, dhe rreth gjysma e studimeve kishte lidhje me matematikë. Shumë shpejt doli në pah se studentët e tjerë ishin shumë më të mirë se unë dhe unë shumë shpejt e vërejtja se nuk mund t'i përcillja. Edhe pse tema më dukej shumë interesante – për shembull, një profesor bëri për dhjetë vjet kërkime, për të zbuluar se si mund të optimohej afati i kohës së shpueses së dheut – mirëpo gjatë punës në hulumtime dhe laborator më mungonin kontaktet sociale.

I ndërpreva studimet. Gjatë këtij viti, së pari punova si kamerier në Flumserbergen dhe pastaj në Cyrih. Jo vetëm se i përmirësova aftësitë e mia të llogaritjes mendore, por mësova edhe si të sillem me njerëz më të ndryshëm.

Pastaj iu ktheva planit tim të vjetër, shkollës së lartë pedagogjike. Në ditët e punës provuese kam kuptuar se unë ndoshta kam më pak durim për klasat e ulëta, por që puna me nxënësit dhe nxënëset e klasave të mesme më përshtatej. Klasa jonë e studimit ishte me fat. Për shkak të mungesës së personelit mësimdhënës, ne që në vitin e tretë kemi filluar të japim mësim. Kjo ka qenë e dobishme, sepse kështu kam mundur që atë që kisha mësuar në teori ta zbatoja drejtpërdrejt në praktikë. Dhe kjo punë më ka mundur të fitoj mjaft para për një udhëtim të planifikuar shumë kohë më parë.

Zhvillim i mrekullueshëm

Pas përfundimit të studimeve dhe udhëtimit, fillova punën time si mësues. Zhvillimi i nxënësve dhe nxënësve në këtë fazë të jetës është magjepsës. Në klasën e 4-tërt ata janë ende lozonjarë, por pastaj gjejnë rrugën e tyre; mësojnë që problemet dhe zgjidhjet t'i shqyrtojnë në mënyrë kritike, të krijojnë mendimin e tyre dhe të mendojnë të pavarur.

Me punën time unë dua t'ua ruaj atyre kënaqësinë për shkollën dhe për të mësuarit. Unë u tregoj atyre, për shembull, se si mund të bëjnë ndarjen e mësimëve, që të mos e bëjnë tërë mësimin për një ditë ose në minutën e fundit, se të mësuarit mund të ofrojë shumë kënaqësi.»



GUL AFROZ HAIDARI, AFGANISTAN
SHKOLLIM I PLANIFIKUAR SI SPECIALISTE E
DIPLOMUAR PËR RADIOLOGJI MJEKËSORE-TEKNIKEE

Në ditën e dymë të hapura diçka bëri klik: «Unë vij nga Afganistani, por së bashku me familjen time gjithmonë kemi jetuar në Iran ku edhe kam ndjekur gjimnazin me fokus në matematikë dhe fizikë, për t'u bërë elektroinxhinierë. ...»

Babai im më shumë kishte dëshirë që unë të kisha vendosur për të zgjedhur biologjinë dhe kiminë dhe pastaj për të studiuar mjekësinë. Me studimet nuk ka funksionuar, sepse unë tani gati tri vjet më parë jam martuar dhe tash jetoj me bashkëshortin tim në Zvicër. Fillimi nuk ishte edhe aq i lehtë, por

unë kam mësuar shpejt dhe në mënyrë intensive gjuhën dhe kam menduar gjerë e gjatë për të ardhmen time profesionale. Për mua si një grua myslimane, është shumë e rëndësishme të dëshmoj se dua të jem e punësuar dhe se dua të fitoj parat vetë. Unë nuk dua të qëndroj thjesht në shtëpi dhe të bëjë punët e familjes. Universiteti ose shkolla e lartë teknike federale me siguri do të ishin një mundësi e mirë, por vetëm studimi teorik nuk më pëlqen, sepse më pëlqen që mësimin teorik ta zbatoj në praktikë me duart e mia.

Kombinimi i shkollës dhe i zbatimit praktik

Për këtë arsye më pëlqen sistemi dual në Zvicër, ky kombinim i shkollës me zbatimin praktik në një ndërmarrje. Së pari kam kërkuar një vend për të mësuar profesionin e polimekanikes. Një profesion i cili në mënyrë ideale ndërlidh punën praktike, teorinë dhe imagjinatën teknike.

Në ditët e punës provuese ky profesion më ka pëlqyer shumë. Por, për fat të keq, përgjegjësit menduan se unë jam shumë delikate dhe se forca ime fizike nuk është e mjaftueshme për këtë profesion. Kjo më ka zhgënjyer shumë. Dhe nganjëherë e pyes veten, se mos ata kanë menduar se unë për shkak se mbaj shami në kokë nuk do të përshtatesha në ndërmarrjen e tyre. Unë mbaj shami që kur isha vajzë e vogël, kjo është një pjesë e kulturës sonë tradicionale. Për mua kjo është më shumë, për mua bartja e shamisë është gjithashtu një pjesë e religjionit tim. Po të dilja në rrugë pa shami, atë unë do ta përjetoja si një lloj mëkati. Dhe këtë nuk do të mund ta bëja pa arsye.

Profesioni i përshtatshëm

Unë edhe njëherë kam rishqyrtuar zgjedhjen time të profesionit. Edhe njëherë kam lexuar shumë dhe kam shikuar filma mbi profesionet e mundshme. Në një ditë të dymë të hapura në Shkollën e Lartë Profesionale për profesionet shëndetësore, kam vërejtur se profesioni i specialistes në radiologjinë medicinale-teknike, është profesioni që u përshtatet më së miri aftësive dhe interesave të mia.

Në një praktikë pranë një klinike rehabilitimi, unë tash mund të përgatitem në mënyrë veçantë për arsimin në shkollën e lartë profesionale. Unë punoj në stacionin e monitorimit. Këtu vijnë pacientët dhe pacientet nga spitali, për rehabilitim. Natyrisht se në këtë repart ekzistojnë rregulla rigorozë në lidhje me pastërtinë dhe sterilitetin. Mikrobet mund të jenë të rrezikshme për njerëzit e sëmurë ose të lënduar. Po të mbaja në kokë të njëjtën shami që mbaj në rrugë, pacientët do t'u ekspozoheshin të pambrojtur këtyre mikrobeve. Për të punuar në këtë pjesë të stacionit, unë heq dorë nga bartja e shamisë gjatë orarit të punës, të cilën e mbaj në kokë në jetën time të përditshme private.»

Si më tutje, pas gjimnazit oshkollës së mesme speciale?

Arsimimi në ekonomi pas maturës si zgjidhje e përsosur: «Sporti, tenisi, squashi (skvosh) ose puna ime si trajner i volejbollit, gjithmonë kanë qenë një pjesë e rëndësishme e jetës sime. ...

Pas gjimnazit muzikor kam dashur të studioj sportin dhe vendosa të studioj shkencat e lëvizjes në Shkollën e Lartë Teknike Federale. Një studim me degët kryesore në matematikë, fizikë dhe kimi, që pak kishte të bëjë me sport. Pas shtatë semestrave nuk munda të jepja një provim për herë të dytë. Natyrisht që isha i pikëlluar, por edhe i arsyeshem. Për këtë provim kisha mësuar shtatë javë në mënyrë intensive dhe isha i pasuksesshem. Diçka nuk ishte në rregull, unë duhej të riorientohesha dhe vendosa për ekonominë, një lëndë të cilën e pëlqoja edhe në gjimnaz.

NICOLAS EGLI, ZVICËR

NËPUNËS NË PATUNDSHMËRI, PËRGATITJA PËR CERTIFIKATËN PROFESIONALE FEDERALE PËR PATUNDSHMËRI



Pas një semestri në universitet, që ishte i bezdisshëm, një gjysmë viti punova si praktikant te një elektrikist. Punoja fizikisht, njihesha me njerëz të rinj, fitoja para dhe kisha kohë për të menduar. Rezultati?

U lajmërova për arsimimin ekonomik pas-maturës, një arsimim ku gjatë një blloku shkollor prej 6 muajsh ofrohen njohuritë themelore profesionale, të cilat përfundojnë me një provim, të cilat pastaj thellohen me një praktikë 18-mujore.

Për shumë pak kohë gjeta një vend të domosdoshëm për praktikë, bëra arsimimin ekonomik pas-maturës për nëpunës në patundshmëri. Ky model arsimimi për ndërmarrjen time ishte aq i suksesshem sa ne ende punojmë me praktikantë për arsimimin ekonomik pas-maturës. Këta praktikantë janë më të moshuar se shegertët, janë më të pavarur, me më shumë vetëbesim dhe, për shembull, mund të bëjnë kontaktet fillestare profesionale në telefon.

Për mua, ky lloj i shkollimit, i orientuar në praktikë, është plotësisht i përshtatshëm. Ne bëjmë deklarime të tatimeve dhe menaxhojmë raste të ndërlikuara për klientët dhe klientet me patundshmëri ose letra me vlerë, për klientë të futur në borxhe ose ata që u janë shmangur tatimeve dhe të cilët duan të përgatiten për vetëdenoncim. Ne bëjmë kontabilitetin ose administrimin e pagave për ndërmarrje të qëndrueshme dhe menaxhojmë personelin e tyre prej momentit të punësimit e deri te dalja në pension. Ne gjithashtu i shoqërojmë ndërmarrësit gjatë procesit të themelimit të ndërmarrjes së tyre, në një ose dy vjetët e para – ndoshta kur punojnë ende me humbje – ose bëjmë për ta, si kompani e pavarur e patundshmërive, revizionet vjetore të kërkuara me ligj.

Kontakti i përhershëm me klientë

E gjithë kjo tingëllon pak sikur të ishte një punë ku unë para së gjithash jam i ulur para kompjuterit dhe merrem vetëm me numra duke i shtyrë andejkëndej Kurrresi. Unë jam në kontakt të vazhdueshëm personal me klientet dhe klientët, bisedoj me ta dhe i këshilloj ata. Meqenëse ne kemi rreth 50 për qind të klienteve dhe të klientëve të huaj, unë mund të përdor njohuritë e mia të gjuhëve të huaja, unë flas rregullisht me autoritetet tatimore të vendeve të tjera, për shembull të Britanisë së Madhe ose të Francës. Dhe unë punoj në një ekip ndërkombëtar, asnjëri nuk ka prejardhje zvicerane. Përveç gjuhës gjermane dhe anglishtes ne flasim edhe frëngjisht, italisht, portugalisht, kroatisht ose spanjisht. Edhe kjo është gjithashtu shumë e vlefshme.

Shkollimi dhe puna e përditshme në zyrën e patundshmërive më ka hapur një botë shumë interesante. Jam i pasionuar për marrëdhëniet ekonomike dhe njëkohësisht, në kontakt të drejtpërdrejtë me njerëzit mund të bëj diçka të dobishme për njerëzit.»



ARSIMIMI EKONOMIK PAS MATURËS

Maturantët dhe maturantët e interesuar në degët e ekonomisë, që kërkojnë një alternativë nga studimet në universitet, mund të zgjedhin një program ekonomik pas maturës. Kjo është ndërtuar në dy faza:

- arsimimi themelor 6-mujor, i cili përfundon me një certifikatë.
- praktika 18-mujore në një ndërmarrje, e cila mundëson hyrjen «e shpejtë» në degën e zgjedhur.

Varësisht nga ndërmarrja ku bëhet praktika, absolventët dhe absolventët e arsimimit ekonomik pas-maturës, gjatë arsimimit shkollor marrin një pagë prej 2000 franga në muaj. Programi ekonomik i arsimimit ekonomik pas-maturës mbështetet nga një shoqatë prej më shumë se 30 ndërmarrjeve, veç tjerash të fushës bankare, sigurimeve ose ndërmarrje patundshmërisht.

Të interesuarit u drejtohen drejtpërdrejtë personave përgjegjës në këto ndërmarrje, të cilat për çdo vit ofrojnë rreth 100 vende për praktikantë.

Shpenzimet e arsimimit shkollor arrijnë deri në 10'000 franga dhe zakonisht barten nga punëdhënësit, me të cilët lidhet kontrata e praktikës.

Si më tutje, pas gjimnazit ose shkollës së mesme speciale?

**Jo çdo karrierë arsimore ecë në mënyrë lineare.
Mund të ndodhë që, menjëherë pas shkollimit të obligueshëm, ju të mos mund të mbaroni një arsimim bazë profesional. Ose ju nuk keni sukses në provimin përfundimtar në përpjekjen e parë. Arsimimi mund të bëhet edhe më vonë.
Në Zvicër ekzistojnë shumë mundësi kalimi nga veprimtaria profesionale në arsimim dhe ngritje të mëtejshme, të cilat ju krijojnë mundësi më të mira në tregun e punës.**

Ky kapitull u dedikohet të huajve dhe të huajave, të cilët në Zvicër punojnë dhe synojnë përmirësimin e mundësive dhe shanseve në tregun e punës, duke e përfunduar më vonë një kualifikim profesional dhe duke dëshmuar aftësitë e tyre profesionale në një formë të caktuar të dëshmuar.

Shfrytëzimi i shanseve dhe i mundësive

Ngritja profesionale për të rriturit

Faqe

- 110 **Ngritja profesionale për të rriturit**
- 110 *Alaittin Kocahal, Turqi, kuzhinier*
«Së pari Atesti Federal i Profesionit pastaj Certifikata Federale e Aftësimi»
- 111 *Luis Neto, Portugali, murator*
«Megjithatë, edhe një zanat»
- 112 *Markus Schmid, inspektor profesional i Entit për Shkolla të Mesme dhe Arsimim Profesional të Kantonit të Cyrihut*
«Trajtimi konkret i ngritjes së mëvonshme»

Ngritja profesionale për të rriturit

Mund të ndodhë që karriera juaj e ngritjes arsimore të mos ecë në mënyrë lineare. Ju jeni i rritur, por nuk keni përfunduar ende asnjë arsimim bazë profesional ose shkollë të arsimimit të përgjithshëm. Andaj, ju si burrë i rritur, ose grua e rritur, dëshironi të kryeni një zanat më vonë.



ALAITTIN KOCAHAL, TURQI
KUZHINIER ME CERTIFIKATË FEDERALE TË AFTËSIMIT

Së pari Atesti Federal i Profesionit pastaj Certifikata Federale e Aftësisimit: «Kur erdha në Zvicër, menjëherë gjeta një punë si ndihmëskuzhinier, sepse kisha përvojë në gastronomi. ...

Pastaj mbeta pa punë. Falë mbështetjes së Qendrës Rajonale të Ndërmjetësisimit për Punë, kam mundur të përfundoj arsimimin bazë profesional si punëtor kuzhine me Atest Federal të Profesionit. Qendra Rajonale e Ndërmjetësisimit më ka ofruar një vend për mësim të zanatit në një institucion për integrim në punë dhe më ka mbështetur financiarisht. Praktika në ndërmarrje si dhe mësimi profesional në shkollë nuk ishin problem. Mirëpo, lëndët e përgjithshme arsimore si, jurisprudenca ishin më të vështira, për shkak të njohurive të mangëta gjuhësore. Kolegët e mi të punës si dhe shefi im më ndihmuan dhe unë bëra kurse shtesë të gjuhës. Si i vetmi i rritur në shkollën profesionale, unë jam mirëpritur ngrohtësisht nga të rinjtë. Me disa kam kontakte edhe sot. Si fëmijë, nuk shkoja me dëshirë në shkollë, ndërsa këtu jam gëzuar për

secilën ditë në shkollë. Situata ime e veçantë kishte edhe anët e veta pozitive: pas diplomimit një mësimdhënës më ofroi një vend pune në ndërmarrjen e vet, në një qendër të pleqve. Unë vërejta shpejt se kam një pozitë më të lartë. Më nuk isha punëtor ndihmës, por këtu kishte diçka më shumë. Përveç kësaj, unë fitoja më shumë. Kjo diplomë profesionale më ka forcuar edhe personalisht. Kam humbur frikën e dështimit dhe e dija se do të mund të ndërroja vendin e punës.

Pas një viti vendosa të mbaroj për profesionin e kuzhinierit me Certifikatë Federale të Aftësisimit, më vonë. Për këtë arsye, dy vjet unë kam përcjellë një kurs të veçantë për të rriturit, dhe kam bërë të njëjtin provim përfundimtar sikurse shegertët e tjerë.»

Megjithatë, edhe një zanat: «Jam rritur në një fshat të vogël në jug të Portugalisë me rreth 100 banorë. Atje kam ndjekur edhe shkollën fillore. ...

Gjashtë vjetët e ardhshme të shkollës i kam bërë në një fshat më të madh. Pas shkollimit të detyrueshëm, unë nuk e dija çka të mësoj. Prandaj unë mbeta në shkollë edhe dy vjet shtesë dhe u fokusova kryesisht në matematikë dhe shkenca natyrore. Pastaj kam bërë një shkollim të drejtimit për nëpunës në një shkollë profesionale – si gjeneratë e parë në Portugali. Në këtë profesion nuk punova kurrë, dhe thënë sinqerisht, kjo punë për mua ishte shumë e bezdisshme. Disa nga kolegët e mi kanë kaluar provimet pranuese në universitet. Për këtë unë nuk ndieja kurrfarë dëshire, sepse dëshiroja të punoja, më në fund të fitoja paratë e mia, të kem banesën time. Edhe pse gjeta një punë, unë nuk fitoja as për së afërmi mjaftueshëm për të bërë një jetë në mënyrë të pavarur.

Më në fund i pavarur

Gjatë kësaj kohe vizitova tezen time në Zvicër. Ajo më pyeti nëse kam dëshirë të

jetoj këtu. Natyrisht! Pas një kohe të shkurtër ajo ma gjeti një punë dhe unë para katër vjetësh erdha në Zvicër. Tash paga ime ishte e mirë dhe unë mund të paguaja një banesë timen dhe të jetoja në mënyrë të pavarur. Mirëpo, unë i fitoja paratë si punëtor ndihmës. Punoja te një kopshtar dhe në fakt kishte shumë gjëra të cilat më interesonin por, kohë për të bërë pyetje dhe për të mësuar gjëra të reja nuk kishte. Unë duhej të punoja, shpejt dhe me efikasitet. Unë kuptova se nëse dëshiroj të qëndroj në Zvicër, pa një kualifikim të pranuar, do të detyrohesha tërë jetën të bëj punën e rëndë të një punëtori ndihmës, të fitoj më pak se të tjerët dhe, ndoshta, të mbetem vazhdimisht pa punë – kjo më ka ndodhur dy herë - kur ndërmarrja kishte pak porosi.

Për këtë arsye vendosa të bëj një arsimim. Natyrisht, jam pak nervoz, kryesisht për shkak të pagës së ulët. Unë ka kohë që jetoj financiarisht i pavarur, kemi një banesë me partneren time. Unë do të kisha mundur të përgatitem edhe për procedurën e kualifikimit për të rritur, në pajtim me Nenin 32 të Rregullores për Arsimimin Profesional, mirëpo është dashur që i vetëm të përpunoj të gjitha njohuritë teorike. Kjo është shumë e vështirë, prandaj kam kërkuar dhe e kam gjetur shumë shpejtë një vend zanati si murator.

«Këtë dua ta arrij edhe unë»

Para zanatit, kam bërë një praktikë në ndërmarrjen time. Kam parë se në kantier vetëm disa nga punëtorët kishin mësuar zanat. Ata bënin punë interesante, ishin kryepunëtorë dhe shefa të kantierit. Për ta puna në kantier nuk ishte fizikisht e rëndë. Këtë dua ta arrij edhe unë. Profesion i muratorit më pëlqen, sepse gjatë punës mund të lëvizësh shumë, të jem vazhdimisht aktiv dhe mund të mësoj shumë.

Unë i gëzohem shkollës profesionale, gëzohem që do të mësoj gjëra të reja, të bëj sërish matematikë, të lexoj planet, të kuptoj se si bëhet një ndërtesë dhe çka është e rëndësishme këtu. Me një zanat, unë do të kisha një bazë të mirë për 40 vitet e ardhshme. Unë e di se po të kthehem në Portugali me një zanat të mësuar në Zvicër, do të isha një mbikëqyrës në ndërtimtarë.»

LUIS NETO, PORTUGALI

VITI 1 | ZANATIT PËR MURATOR

ME CERTIFIKATË FEDERALE TË AFTËSIMIT





MARKUS SCHMID, ZVICËR
INSPEKTOR PROFESIONAL

Trajtimi konkret i ngritjes së mëvonshme: «Si inspektor profesional e me përvojë vazhdimisht të më drejtohen të rritur të interesuar, të cilët edhe pse punojnë kohë të gjatë në profesionin e tyre, ende nuk kanë një kualifikim profesional; ose shëgertë, të cilët provimet përfundimtare nuk i kanë kryer në raundin e parë dhe duhet ose duan t'i përsërisin ato. ...

Për vite të tëra në të njëjtin profesion, por pa diplomë

Natyrisht se edhe si i rritur mund të kërkonte një vend për mësimin e zanatit dhe kështu të kompensoni më vonë arsimimin bazë profesional. Për shumicën e të rriturve, kjo nuk është e mundur përshkak të përgjegjësive që kanë ndaj familjeve të tyre, sepse janë të varur ngapagat e tyre.

Prandaj, në bazë të Nenit 32 të Rregullores për Arsimimin Profesional, mund të bëni arsimimin edhe më vonë. Pjesa praktike e procesit të kualifikimit për ju nuk duhet të ishte problem, nëse ju keni së paku pesë vjet përvojë pune. Pjesa teorike e provimit megjithatë është më e vështirë. Si përgatitje për këtë kualifikim, ju duhet të keni të njëjtat njohuri metodologjike dhe profesionale si nxënësit që mësojnë profesionin. Meqenëse ju nuk jeni përgatitur për procedurën e kualifikimit tri ose katër vjet në shkollën profesionale, ju nuk keni nota të përvojës. Për ju vlen vetëm dita X e provimit.

Për këtë, ju duhet të përgatiteni. Plani arsimor i profesionit tuaj ju tregon saktësisht se çfarë duhet të mësoni. Ju mund t'i fitoni vetë këto njohuri, duke mësuar në mënyrë të pavarur ose duke përcjellur një kurs përgatitor për pjesën e përgjithshme të njohurive. Për të kaluar me sukses procesin e kualifikimit, ju keni nevojë për njohuri të mira gjuhësore, sepse duhet të kuptoni pyetjet, të interpretoni drejtë dhe të jeni në gjendje për t'u përgjigjur me shkrim.

Ngecja në provimin e fundit të zanatit

Në qoftë se ju nuk e kaloni procesin e kualifikimit, provimin përfundimtar të zanatit nuk e kaloni, atëherë kontaktoni inspektorin kompetent profesional ose inspektoren kompetente profesionale. Këta ju organizojnë një mundësi për të shikuar dosjen e provimit. Së bashku me një ekspert kryesor, ose eksperte kryesore, dhe më së miri së bashku me mjeshttrin tuaj, ju mund të verifikoni saktësisht se pse nuk e keni kaluar provimin përfundimtar. Nëse nuk pajtoheni me vlerësimet, ju mund të bëni ankesë.

Edhe në qoftë se mund të kuptoni arsyen se pse nuk e keni kaluar provimin, situata sigurisht se nuk është e lehtë. Nëse jeni të motivuar dhe nëse angazhoheni, atëherë ju do t'ia dilni në përpjekjen e dytë.

Brugë të ndryshme

Pas një procedure të papërfunduar të kualifikimit, ju keni disa mundësi të hapura:

- Ju mësoni edhe një vit shtesë zanatin. Shpesh kjo nuk është e mundur në ndërmarrjen ku jeni, sepse të gjitha vendet për mësim të zanatit tashmë janë të zëna. Për të gjetur shpejt një vend të ri zanati, mund të jetë e vështirë, sepse në verë nuk ka shumë vende të hapura për mësim të zanatit.
- Ju kërkoni një vend prej 80 për qind në profesionin tuaj, për të përsëritur në të njëjtën kohë shkollën profesionale të vitit të kaluar shkollor si përgatitje për provim. Edhe në qoftë se nuk keni vend zanati, kjo ofertë shkollore për ju është falas.
- Ju kërkoni një praktikë në profesionin tuaj. Këtu fitoni më pak, por mund të merreni vesh me ndërmarrjen, që gjatë këtij viti të vijoni arsimimin kohë pas kohe.

Entet kantonale të arsimit profesional ofrojnë përkrahje në këtë situatë, për shembull në formë të stërvitjes profesionale ose edhe duke ju përkrahur që në ndërmarrjen e re të organizohet një definim i situatës në formë të një provimi të ndërmjetmë. Përmes kësaj procedure, ju mund t'i analizoni resurset dhe të metat tuaja dhe të përcaktoni e zbatoni një program të ri arsimimi për përgatitjen e përsëritjes së provimit.»

Marcus Schmid si inspektor profesional i Entit për Shkollën të Mesme dhe Arsimimit Profesional të Kantonit të Cyrihut, është përgjegjës për profesionet në hotelieri dhe në lëmin e industrisë ushqimore.



MUNDËSITË SHUMTA

Shumë programe arsimore në Zvicër, nëpër të cilat zakonisht kalojnë të rinjtë, ekzistojnë edhe për të rriturit. Si në shkollat private ashtu edhe në ato publike, personat e rritur mund të bëjnë maturën speciale ose maturën e gjimnazit (kohëzgjatja 3–4 vjet, shih edhe faqe 80).

Në kushte të caktuara, të rriturit po ashtu mund të bëjnë zanat të shkurtuar dhe kështu, më vonë, të marrin njëdiplomë në një profesion. (kohëzgjatja: zakonisht 1 vit më pak se zanati i rregullt), ose maturën profesionale pas mësimit të profesionit (Kohëzgjatja: 1–2 vjet).

NJOHJA E REZULTATEVE ARSIMORE

Nëse ju keni mbledhur të paktën 5 vjet përvojë në punë, dhe mund të dëshmoni një minimum prej 3 vjet përvojë në profesionin e synuar, atëherë për ju, procedura e validimit (njohjes) është mënyra e duhur për të bërë një kualifikim profesional. Procesi i validimit kërkon që ju të dëshmoni atë që ju tashmë e dini dhe mundeni. Ju i dokumentoni kompetencat profesionale të veprimit në një dosje të validimit. Në përpilimin e dosjes, ju do të keni përkrahje nga profesionistët. Ata e dinë se cilat njohuri teorike ju i keni arritur në profesionin tuaj ose jashtë tij dhe çfarë keni aplikuar në praktikë.

MBËSHTETJA NË KANTON

Ofertat mbështetëse të enteve për arsimim profesional për ngritje të mëvonshme, rregullohen nga kantonet. Ju duhet të informoheni në Entin për Arsimim Profesional në kantonin tuaj, si mund të bëni më së miri një ngritje të mëvonshme ose përsëritjen e provimit përfundimtar të zanatit.

Fjalor

Glossar

Arsimimi bazë profesional	Berufliche Grundbildung
Arsimimi ekonomik pas maturës	Postmaturitäre Wirtschaftsausbildung PWA
Arsimimi i përgjithshëm	Allgemeinbildung
Arsimimi profesional	Berufsbildung
Atesti Federal i Profesionit	Eidgenössisches Berufsattest EBA
Bursat	Stipendien
Certifikata e shkollës së mesme speciale	Fachmittelschulabschluss
Certifikata Federale e Aftësisë	Eidgenössisches Fähigkeitszeugnis EFZ
Dosja e aplikimit	Bewerbungsdossier
Drejtimit e studimeve me diplomë	Diplomstudiengänge
Enti për Ngritje Profesionale	Amt für Berufsbildung
Fusha profesionale	Berufsfeld
Gjimnazi, shkolla e maturës së gjimnazit	Gymnasium, Gymnasiale Maturitätsschule
Intervista (bisedë prezantimi)	Vorstellungsgespräch
Kalimi ndërlidhës	Passerelle
Kërkimi i vendit për mësim të zanatit	Lehrstellensuche
Këshillimorja profesionale	Berufsberatung
Kontrata për zanatin	Lehrvertrag
Kurse jashtë ndërmarrjes	Überbetriebliche Kurse
Kurse mbështetëse	Stützkurse
Matura e gjimnazit	Gymnasiale Maturität
Matura profesionale	Berufsmaturität
Matura Profesionale	Fachmaturität
Mësimi i shkurtuar i zanatit	Verkürzte Lehre
Mësimi i zanatit të dytë	Zweitlehre
Mësimi për arsimimin e përgjithshëm	Allgemeinbildender Unterricht ABU
Ndërmarrja për mësimin e zanatit (profesionit)	Lehrbetrieb
Neni 32 i Ligjit për ngritjen profesionale	Artikel 32 des Berufsbildungsgesetzes
Ngritja e mëtejshme	Weiterbildung
Ngritja profesionale për të rriturit	Berufsabschluss für Erwachsene
Niveli hyrës, kopshti i fëmijëve	Eingangsstufe, Kindergarten
Niveli primar	Primarstufe
Niveli sekondar I	Sekundarstufe I
Niveli sekondar II	Sekundarstufe II
Niveli terciar	Tertiärstufe
Njohja (pranim, validim) e rezultateve arsimore	Validierung von Bildungsleistungen
Ofertat ndërlidhëse	Brückenangebote
Paramësim	Vorlehre
Plani i zgjedhjes së profesionit	Berufswahlfahrplan
Praktika	Praktikum
Praktikë seleksionuese	Selektionspraktikum
Procedura e tejkalimit	Übertrittsverfahren
Procesi i zgjedhjes së Profesionit, përgaditja për zgjedhjen e profesionit	Berufswahlprozess, Berufswahlvorbereitung
Profesionet bazë	Grundberufe
Provimet profesionale me Certifikatë Federale të Aftësisë	Berufsprüfungen mit eidgenössischem Fachausweis BP
Provimi i lartë profesional me diplomë federale	Höhere Fachprüfung mit eidgenössischem Diplom HFP
Provimi përfundimtar i zanatit	Lehrabschlussprüfung LAP
Puna provuese	Schnupperlehre
Qendra Informative për Profesionet	Berufsinformationszentrum BIZ
Refuzimet	Absagen
Shkolla e Lartë Pedagogjike	Pädagogische Hochschule
Shkolla e Lartë Profesionale	Höhere Fachschule HF
Shkolla e Lartë Teknike Federale ETH/EPF	Eidg. Technische Hochschule ETH
Shkolla e Lartë Universitare	Fachhochschule FH
Shkolla e Lartë Universitare për studime në distancë	Fernfachhochschule
Shkolla e mesme komerciale	Handelsmittelschule HMS
Shkolla profesionale	Berufsfachschule
Shkollat e mesme speciale	Fachmittelschule FMS
Shkollat me orar të plotë	Vollzeitschulen
Shkollimi i detyrueshëm	obligatorische Schule
Sistemi i arsimimit në Zvicër	Bildungssystem der Schweiz
Sistemi i shkollimit të lartë	Hochschulsystem
Tarifat e shkollimit	Studiengebühren
Testi i përshtatshmërisë	Eignungstest
Universitet	Universität
Universiteti për studime në distancë	Fernuniversität
Vend për mësimin e zanatit	Lehrstelle

Glossaire

Formation professionnelle initiale, apprentissage
 Formation commerciale pour titulaires de maturité
 Enseignement général
 Formation professionnelle
 Attestation fédérale de formation professionnelle AFP
 Bourse d'études
 Certificat de culture générale
 Certificat fédéral de capacité CFC
 Dossier de candidature
 Diplômes postgrades
 Office de la formation professionnelle
 Champ professionnel
 Ecole de maturité gymnasiale (gymnase, lycée, collège)
 Entretien d'embauche
 Passerelle
 Recherche d'une place d'apprentissage
 Orientation professionnelle
 Contrat d'apprentissage
 Cours interentreprises
 Cours de soutien
 Maturité gymnasiale
 Maturité professionnelle
 Maturité spécialisée
 Apprentissage de durée réduite
 Deuxième apprentissage
 Enseignement de la culture générale
 Entreprise formatrice
 Article 32 de l'Ordonnance sur la formation professionnelle
 Formation continue, perfectionnement
 Certification professionnelle pour adultes
 Premier cycle de l'école primaire, école enfantine
 Ecole primaire
 Secondaire I
 Secondaire II
 Degré tertiaire
 Validation des acquis de l'expérience
 Filières, mesures de transition
 Préapprentissage
 Processus du choix professionnel
 Stage
 Stage de sélection
 Procédure de transition
 Préparation au choix professionnel
 Métiers CFC ou AFP
 Examen professionnel, brevet fédéral BF
 Examen professionnel supérieur, diplôme fédéral DF
 Examen de fin d'apprentissage
 Stage d'orientation
 Centre d'information sur les professions
 Réponses négatives
 Haute école pédagogique HEP
 Ecole supérieure ES
 Ecole polytechnique fédérale EPF
 Haute école spécialisée HES
 Haute école spécialisée à distance
 Ecole de commerce
 Ecole professionnelle
 Ecole de culture générale ECG
 Ecole à plein temps
 Ecole obligatoire
 Système suisse de formation
 Système des hautes écoles
 Taxes d'études
 Test d'aptitudes
 Université
 Université à distance
 Place d'apprentissage

Glossario

Formazione professionale di base, tirocinio
 Formazione economica post-maturità
 Formazione generale
 Formazione professionale
 Certificato federale di formazione pratica CFP
 Borse di studio
 Certificato di scuola specializzata
 Attestato federale di capacità AFC
 Dossier di candidatura
 Formazioni post-diploma
 Divisione della formazione professionale
 Settore professionale
 Liceo, scuola di maturità
 Colloquio di presentazione
 Passerella
 Ricerca di un posto di tirocinio
 Orientamento professionale
 Contratto di tirocinio
 Corsi interaziendali
 Corsi di sostegno
 Maturità liceale
 Maturità professionale
 Maturità specializzata
 Formazione professionale di base ridotta
 Seconda formazione professionale di base
 Insegnamento della cultura generale ICG
 Azienda formatrice
 Art. 32 dell'Ordinanza sulla formazione professionale
 Formazione continua, perfezionamento
 Qualifica professionale per adulti
 Scuola dell'infanzia
 Livello primario, scuola elementare
 Livello secondario I
 Livello secondario II
 Livello terziario
 Validazione degli apprendimenti acquisiti
 Soluzioni transitorie, formazioni transitorie
 Pretirocinio
 Processo di scelta professionale
 Stage
 Stage di selezione
 Procedura di transizione
 Preparazione alla scelta professionale
 Professioni con AFC o CFP
 Esame di professione, attestato professionale federale APF
 Esame professionale superiore EPS, diploma federale
 Esame di fine tirocinio
 Stage d'orientamento
 Centro di informazione sulle professioni
 Risposte negative
 Alta scuola pedagogica ASP
 Scuola specializzata superiore SSS
 Politecnico federale
 Scuola universitaria professionale SUP
 Scuola universitaria professionale a distanza
 Scuola media di commercio
 Scuola professionale
 Scuola specializzata
 Scuola a tempo pieno
 Scuola dell'obbligo
 Sistema educativo svizzero
 Sistema universitario
 Tasse scolastiche
 Test attitudinale
 Università
 Università a distanza
 Posto di tirocinio



Botimi i 4, plotësisht i përpunuar
dhe i zgjeruar, 2016
© 2016 SDBB, Bern.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Botuesi

SDBB/CSFO,
www.sdbb.ch, www.csfo.ch

Udhëheqës projekti dhe redaktor

Roland Egli, Heinz Staufer, SDBB

Koncepti dhe tekstet

Helgard Christen, Steckborn; Roland
Egli, Heinz Staufer, SDBB/CSFO

Përkthimi shqip dhe lekturimi

Hilmi Gashi, Bern;
Sami Kurteshi, Prishtinë

Fotografia

Maurice Grünig, Zürich;
Iris Krebs, Bern;
Frederic Meyer, Zürich;
Reto Klink, Zürich;
Peter Kraft, SDBB

Dizajni grafik

Trix Stäger, Zürich

Përgatitja për shtyp

Roland Müller, SDBB;
Trix Stäger, Zürich;
gdz, Zürich

Shtypshkronja

gdz, Zürich

**Shpërndarja, shërbimi i
konsumatorëve**

SDBB Vertrieb, Industriestrasse 1,
3052 Zollikofen
Tel. 0848 999 001 (gjermanisht),
Tél. 0848 999 002 (frenjisht/italisht),
Fax + 41 (0)31 320 29 38,
vertrieb@sdbb.ch/distribution@csfo.ch/
distribuzione@csfo.ch
www.shop.sdbb.ch/www.shop.csfo.ch

Artikulli-Nr.

L110-3014

Versionet gjuhësore

Ky doracak është botuar
edhe në gjuhë të tjera.
Gjendjen aktuale e gjeni në
www.shop.sdbb.ch, www.shop.csfo.ch.

Albanisch, albanais, albanese

Ne falënderojmë përzemërsisht
të gjithë personat dhe ndërmarrjet
për bashkëpunimin.

Me përkrahjen e Sekretariatit Shtetëror
për Arsim, Hulumtime dhe
Inovacion SBFI.